

1 E martë, 5 dhjetor 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 9.01

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Sekretare  
6 e Gjykatës, ju lutem paraqisni lëndën.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Kjo është  
8 çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim  
9 Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjesi,  
11 të gjithëve. Sot do të vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit të  
12 Prokurorisë 04765. Të gjithë të akuzuarit janë të pranishëm  
13 fizikisht në sallën e gjyqit.

14 Asistente, ju lutem sillni dëshmitarin në sallë.

15 [Dëshmitari vijon dëshminë]

16 DËSHMITARI: Mirëmëngjesi.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjesi,  
18 Dëshmitar.

19 DËSHMITARI: Mirëmëngjesi, të gjithëve.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sot do të  
21 vazhdojmë me dëshminë tuaj. Ju kujtoj t'u jepni përgjigjeni  
22 qartë, me fjali të shkurtra. Nëse nuk e kuptoni një pyetje,  
23 lirisht kërkoni që pyetja të përsëritet, ose thjesht thoni që  
24 nuk e kuptuat dhe do të përpiqem t'ua sqarojmë.

25 Gjithashtu, mos harroni të thoni bazën e njohurisë tuaj

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sadik Halitjaha (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje nga Trupi Gjykses (Vazhdim)

Faqe 2

1 lidhur me faktet dhe me rrethanat për të cilat do t'ju bëjnë  
2 pyetje. Ju kujtoj se jeni ende nën betim për të thënë të  
3 vërtetën sikurse ju e thatë vetë përmes deklaratës solemne.

4 Gjithashtu, flisni pranë mikrofonit dhe prisni pesë  
5 sekonda përpara se t'ju përgjigjeni pyetjes dhe flisni ngadalë  
6 në mënyrë që t'ju kapin edhe përkthyesit.

7 Nëse keni të nevojshme për një pushim, na vini në dijeni  
8 dhe do të bëjmë organizimet e nevojshme.

9 Do vazhdojmë me pyetjet e Gjykatësit Mettraux.

10 DËSHMITARI: SADIK HALITJAHA [Vijon]

11 Pyetje nga Trupi Gjykses: [Vazhdim]

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mirëmëngjes, Dëshmitar.

13 I lutem Sekretares të vendosë në ekran provën materiale  
14 P716.

15 Dëshmitar, a ju kujtohet që ua tregoi z. Emmerson këtë  
16 dokument dhe unë po sërish ua tregova këtë dokument dhe. Ju  
17 kujtohet?

18 PË. Veç pak, një moment, ju lutem. Po.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E pranoni, sikurse e tha  
20 dhe z. Emmerson, se jeni ju autori i këtij dokumenti?

21 PË. Po, po unë.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Më 13 nëntor 2023, që  
23 është e reflektuar në transkript në faqet përkatëse, ju patët  
24 një komunikim me z. Emmerson dhe unë do t'ju bëj disa pyetje.  
25 Z. Emmerson ju pyeti ju për këtë. Ai u përqendrua në pikën 1.

1 Pika 1 e këtij informacioni, paragrafi 1.

2 PË. Po.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe ju thatë:

4 "Se në pikën e dytë, flitet për aksidentin apo vdekjen e  
5 ushtarit në zonën e Nerodimës nga ushtar tjetër që tani është  
6 duke vuajtur dënimin dhe pritet përcaktimi i përgjegjësisë  
7 pranë të njëjtës gjykatë".

8 Z. Emmerson, më pas, vijoi dhe tha.

9 "Z. Halitjaha, nuk ka pasur gjykatë të shkallës së dytë  
10 më 8 shkurt të vitit 1999, apo jo?"

11 Dhe ju u përgjigjët:

12 "Po i ngatërroi gjëra, nuk ka qenë e paqëllimshme, sepse  
13 përpara kësaj, është bërë një kërkesë që është bërë publikisht  
14 Shtabit të Përgjithshëm dhe i është kërkuar që të  
15 themeloheshin gjykatat në mënyrë që të merreshin me aspektet  
16 disiplinore për ushtarët. Sepse kishim ushtarë që i kishin  
17 armët e mbushura dhe gabimisht plagosnin dhe vrisnin personat.  
18 Për mendimin tonë, duhet të krijoheshin gjykatat. Po kjo ishte  
19 menduar në qoftë se lufta do zgjaste një, dy a tri vjet.  
20 Përndryshe nuk kishte nevojë për gjykata".

21 A ju kujtohet ky komunikim me z. Emmerson?

22 PË. Po, i saktë është. Ashtu siç e thoni ju. Vetëm kisha  
23 dashtë nëse bën me shtu një fjali të vogël. Ma shumë është  
24 dhanë si sugjerim edhe si lloj kërcënimi ushtarëve që të mos  
25 ndodhin raste të tilla. Sepse unë vetëm kam dëgju që ka ndodhë

1 diçka në zonën tjetër Nerodimë, pa e ditë kush a personi dhe  
2 ku është personi. Kjo ma tepër ka qenë kushtimisht e potencume  
3 që të frikohen që të mos bëjnë gjena të tilla. E gjithë ajo që  
4 lexuat ju që thatë është e vërtetë.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, nëse e kuptoj unë siç  
6 duhet, ju po thoni se ju kishit merak se mund të ndodhni  
7 ngjarje të tilla dhe, si rezultat, kërkuat që të krijoheshin  
8 gjykata. Kështu duhet ta kuptoj?

9 PË. Shumë e vërtetë është. Me i parandalu gjënat, ky ishte  
10 qëllimi.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pse ishte e rëndësishme që  
12 të krijoheshin gjykata, që të merreshin me këto lloj  
13 situatash?

14 PË. Logjikisht dhe ju mendoni ashtu, se kur ndodhin eksese,  
15 ndodhin gabime, ndodhin faje, duhet të ketë edhe ndëshkime apo  
16 duhet të ketë disiplinim. Disiplinimi dhe rregulli nuk mund të  
17 bëhen pa rregullore, pa ligje, pa gjykata. Ato i kemi kërku,  
18 po shumë larg tyne kemi qenë.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, në shembullin që keni  
20 dhënë ju, nëse një ushtar i UÇK-së vret dikë dhe ju nuk do  
21 kishit gjykata, ju çfarë do bënit në situata të tilla?

22 PË. Më e madhja që kemi mund ta bëjmë do ta demobilizonim, do  
23 t'ia hiqnim armën, uniformën dhe do ta përjashtonim nga UÇK-  
24 ja. S'kemi pasë tjetër masë.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju i thatë z. Emmerson se

1 "ishte bërë kërkesë publike drejtuar Shtabit të Përgjithshëm  
2 ku i ishte kërkuar që të krijoheshin gjykata në mënyrë që të  
3 trajtonin aspekte disiplinore lidhur me ushtarët". Çfarë keni  
4 dashtë të thoni ju me këtë?

5 PË. Krejt atë që e lexuat ju. Asgjë më shumë, as më pak.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, ky është dokumenti që  
7 kemi ne përballë, kjo është kërkesa publike apo ka qenë ndonjë  
8 tjetër?

9 PË. Jo, ka qenë një shkresë tjetër.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe kjo është një letër,  
11 shkresë, që ju ia dërguar Shtabit të Përgjithshëm?

12 PË. Ne e kemi përgatit për Shtabin e Përgjithshëm. Nuk e di a  
13 ka mbërri deri tek shefi i shtabit apo jo. Vështirë ka qenë me  
14 i gjetun në Shtab të Përgjithshëm. I kemi dhënë korrierave.  
15 Kanë shku edhe nuk kanë mbërri deri tek vendi i duhur sepse  
16 shtabi ka qenë në lëvizje shumë. Besoj se i ka mbërri shefit  
17 të shtabit.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe ju ia dërguat shtabit  
19 sepse sipas jush ata ishin autoriteti kompetent që mund të  
20 krijonin gjykatat brenda UÇK-së, kështu?

21 PË. Ne gjithmonë kemi llogarit se shtabi është autoritet i  
22 përgjithshëm dhe gjithmonë kemi pritun që nga lart të na vihen  
23 rregulla, urdhra, rregullore, ligje, vendime, po mjerisht nuk  
24 kanë ardhë.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Sepse ju ishit në nivel

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sadik Halitjaha (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje nga Trupi Gjykues (Vazhdim)

Faqe 6

1 batalioni, brigade apo zone, rrjedhimisht nuk kishit  
2 autoritetin për të krijuar gjykata, korrekt?  
3 PË. Shumë korrekt është. Ne krejt çka kemi mund me bë, kemi  
4 bë nja dy rregullore apo tri, kam harru sa janë, në nivel të  
5 zonës. S'kemi pasë tjetër rregull të rregullimit të disiplinor  
6 për ushtarët.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani duhet t'ju pyes për  
8 një dokument tjetër. I lutem Sekretares të vendosë në ekran  
9 dokument SPOE00232491 deri në SPOE00232492-ET. Me të njëjtin  
10 numër është edhe shqipja.

11 Dëshmitar, do t'ju jap pak kohë të lexoni dokumentin. Kur  
12 të mbaroni faqen e parë, më thoni. Sepse pastaj do t'ju bëj  
13 pyetje dhe për faqen e dytë. Lexojeni dhe thjesht më thoni kur  
14 të keni përfunduar.

15 PË. Dokumentit asgjë si mungon përpos nënshkrimit. Por ku  
16 kanë qenë këto gjykata? Nëse dikun i paska pasë dikush msheft.  
17 Unë kisha me vujt qysh tani pse s'kam ditë që ekziston diçka e  
18 tillë. Dhe nëse ka ekzistuar diçka e tillë, do të ndihesha i  
19 pendum tan jetën pse s'kam arrit ta di me kohë. Nuk besoj se  
20 ka pasë diçka të tillë, se nuk po i njoh këta persona asnjë.  
21 Korpuzi mbiemnin po më kujton diçka, po prapë emrin nuk jam i  
22 sigurtë, Osman Berat Korpuzi. As këta pjesëtarët që e kanë  
23 quajtur veten gjykata apo gjykatë e lartë a e ulët. Nuk kemi  
24 pasë. Nuk kemi pasë asnjë nivel gjykate.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, nuk ka gjykata sepse

1 ju nuk keni pasur dijeni, domethënë, ju nuk keni pasur dijeni  
2 për gjykata, a mund ta themi kështu?

3 PË. Unë nuk kam pasë dijeni. Ma drejt me thënë, përndryshe  
4 indinjohem sot më vjen inati pse s'e kam ditë këtë gjë, nëse  
5 ka pasë.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër,  
7 ju lutem.

8 Lexojeni, Dëshmitar dhe na thoni kur të keni përfunduar.

9 A pajtoheni që në pamje të parë, këtu duket një numër,  
10 7/99 dhe mban datën 2 shkurt 1999. Vjen nga prokurori i  
11 përgjithshëm ushtarak i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe ka  
12 lidhje me kallëzimin penal numër 399, 1 shkurt 1999, paraqitur  
13 nga policia ushtarake e zonës operative të Pashtrikut kundër  
14 Osman Berat Korpuzit nga fshati Shalë. E shihni këtë?

15 PË. Shifet mirë dhe është në rregull. Është konstrukti i  
16 dokumentit shumë mirë. Por, realisht, singërisht e them se unë  
17 nuk kam ditë që ka diçka të tillë. Dhe nuk mendoj, prapë jam i  
18 bindur që nuk ka pasë.

19 Për shkak se këtu thotë se thirret në ligjin, paragrafi  
20 ky, ku e ka marrë atë ligj, në cilët ligjet është thirr? Të  
21 ish thirr në ligjet ndërkombëtare e kisha besu, ligje tjera  
22 s'kena përdorë kërrkush. Ku ka pasë? Nuk e kuptoj. Singërisht  
23 s'e kuptoj. S'e kam pa kurrë këtë dokument. As nuk e kam njohë  
24 këtë ngjarje kurrë.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kthehemi dhe njëherë në

1 faqen e parë, ju lutem.

2 Ky, një aktvendim nga gjykata ushtarake. Këtu të paktën  
3 është kolegji i gjykatës së përgjithshme ushtarake. Ka të  
4 njëjtin numër sikurse dhe dokumenti që pamë pak më përpara dhe  
5 mban datën 11 shkurt 1999 dhe i referohet dokumentit që pamë  
6 para një sekonde. Pajtoheni me këtë?

7 PË. Z. Gjykatës, ju lutem kuptona drejtë. Edhe sot Kosova nuk  
8 ka gjykatë ushtarake. As ka kolegji, as gjykatë, as hetues  
9 ushtarakë edhe sot nuk i ke. Si ka mund t'i ketë atëherë? Unë  
10 jam i habitur. Nuk jam ka e kuptoj.

11 Singerisht e shkruame drejtë, siç e thoni ju. Struktura e  
12 shkrimi është drejtë. Në rregull kish me qenë qështu me qenë.  
13 Po, ku ka qenë ajo, kur kanë qe në ato gjykata ushtarake? As  
14 sot s'kemi në Kosovë edhe sot mbas 25 vjetëve nuk kemi gjykatë  
15 ushtarake.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A pajtoheni, që në pamje  
17 të parë ky dokument tregon që personi po ndiqet penalisht për  
18 dezertim, e saktë?

19 PË. Shumë qartë është e shkruar. Edhe shumë në rregull kish  
20 me qenë po të ishte gjykata e vërtetë, po kush ka emitue  
21 gjykatat unë nuk e kuptoj. Ku është shkru dhe pse është shkru  
22 nuk e kuptoj. Por që s'ka pasë, nuk ka pasë se jam shumë i  
23 bindun edhe sot s'kemi gjykata ushtarake.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të shkojmë në fund  
25 të faqes. Këtu ka dy emra. Një është Shkëlzen Ahmeti, që thotë

1 Kryetari i kolegjit apo i gjykatës dhe Vjollca Mali. I njihni  
2 ndonjë prej këtyre emrave?

3 PË. Këtë emrin e Vjollca Mali e kam pa dhe te një vendim ma  
4 herët kur ma keni tregu dje, vendimi i shefit të shtabit i  
5 Bislam Zyrarit. Kjo si daktilografe, po si emën e kam pa dje.  
6 Nuk e kam ditë kurrë më herët. Këtë nuk po e njoh fare,  
7 Shkëlzen Ahmeti, nuk e njoh. As atëherë, as sot s'e njoh.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E drejtë. Emri i Vjollca  
9 Malit ka qenë në dokumentin e SPOE, një dokument i Prokurorisë  
10 që ju tregova dje.

11 A pajtoheni, që në pamje të parë, ky dokument duket të  
12 jetë një apelim, apel i vendimit edhe ky apel është rrëzuar  
13 sipas përmbajtjes?

14 PË. Sipas gjithë strukturës të shkruar, pasi që jam jurist, e  
15 kuptoj që është në rregull dokumenti si dokumenti. Po kush e  
16 ka bërë këtë, për mua është imagjinar diçka. Nuk di që ka pasë  
17 strukturë apo organ të tillë të quhet gjykatë ushtarake ose  
18 hetuesi ushtarake. As hetues, as gjykatës, as avokat nuk kemi  
19 pasë. Ka qenë një person në Shtabin e Përgjithshëm, Sokol  
20 Dobruna, këshilltar juridik i cili ka dhënë këshilla ose ka  
21 marrë ndoshta edhe vendime. Unë di çka ka bërë. Po s'ka pasë  
22 gjykatë. As ka pasë bazë fizike një shtëpi, me thënë, kjo  
23 shtëpi është gjykatë, domethënë, s'ka pasë as bazë fizike.

24 Do ta kishim mësu. Unë për një vit e gjysëm luftë do ta  
25 dija ku është ajo.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e pranoni që ky është  
2 një shembull i një sistemi juridik me dy nivele? Pra, kemi  
3 vendimin e prokurorisë ushtarake dhe apelin që është bërë  
4 pranë një gjykate ushtarake. A e pranoni këtë?

5 PË. Në bazë të shkruarës ashtu është, z. Gjykatës.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po sikurse ju thatë vetë,  
7 ju nuk keni asnjë dijeni për procese të tilla për institucione  
8 të tilla apo për ligje të tilla. Kjo është dëshmia juaj?

9 PË. E vërtetë është.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ka dhe diçka tjetër për të  
11 cilën desha t'ju pyes që të sigurohemi që e kemi kuptuar tamam  
12 atë që keni thënë.

13 Ju po thoni se ju nuk keni dijeni të ketë pasur ndonjë  
14 burg apo objekt ndalimi në zonën e Pashtrikut në vitin 1998  
15 ose 1999, kështu?

16 PË. Kështu është.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Edhe nëse e kam kuptuar  
18 siç duhet dëshminë tuaj, ju asnjëherë nuk keni dëgjuar që të  
19 jenë mbajtur civilë të ndaluar në zonën tuaj të përgjegjesisë,  
20 pra, në zonën e Budakovës?

21 PË. Jo.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe mesa kuptoj unë, ju  
23 nuk pranoni asnjë sugjerim që ju vetë të keni urdhëruar  
24 arrestimin e civilëve, kështu?

25 PË. Jo, që s'dua të pranoj, po të ishte diçka e vërtetë e

1 tillë, unë do t'ju shkruaja këtu një burg të përjetshëm për  
2 veten time. Derisa jam përpjek me mbrojtun me jetën time  
3 200.000 civilë në zonën operative të Pashtrikut. Punët merren  
4 me urdhra të njerëzve civilë, të njerëzve të pafajshëm, të  
5 njerëzve të paarmatosur, të moshave të caktuara, të cilitdo  
6 minoritet, qofshin ata të komunitetit shqiptarë apo të ndonjë  
7 komuniteti tjetër.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nëse e kuptoj siç duhet,  
9 nuk do të ishte e mundshme se s'ka pasë polici ushtarake që  
10 t'i kërkoje që ta arrestonte dhe nuk kishte ambient ku të  
11 mbaheshin të ndaluar civilët, kështu?

12 PË. Z. Gjykatës, ne nuk kemi pasë as burgje në aspektin fizik  
13 të shtëpiave burg. As kemi pasë struktura për burgun që duhet  
14 të jetë gjykata, duhet të jetë avokatët, prokuroritë, policia,  
15 burgu, roja e burgut. Nuk kemi pasë diçka të tillë. Po nuk ka  
16 pasë as urdhër. Nëse sikush ka dhënë një urdhër të tillë që  
17 duhet të arrestohet një civil apo duhet të maltratohet një  
18 njeri i pafajshëm, ju mos e ndalni me dënim, ju lutem,  
19 maksimalisht kushdo qoftë ai. Kushdo qoftë ai.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe ju asnjëherë nuk keni  
21 mësuar që të ketë pasë ndonjë objekt ndalimi në rrethinat e  
22 Budakovës në 1998 apo në 1999?

23 PË. Kurrë s'ka pasë. Se kam mund me e frekuentue atë pjesë.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju nuk keni dijeni as nuk  
25 keni dëgjuar ndonjëherë për ndonjë qendër ndalimi afër

1 shtëpisë së Lumi Palushit, kështu?

2 PË. Jo, jo, jo. Te Palushët ka pasë ambullantë, ambullantë  
3 mjekësore, shtëpi ndalimi s'ka pasë. Nuk ka pasë.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, Dëshmitar.

5 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Unë nuk kam pyetje.

6 Faleminderit.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
8 çaktivizuar].

9 Në rregull.

10 Z. Pace, a keni ju pyetje që burojnë nga pyetjet e Trupit  
11 Gjykues?

12 Z. PACE: [Përkthim] Jo.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emmerson,  
14 më duket se ju filluat i pari me kundërpjetet, kështu që si  
15 rregull ju bie ju të filloni me pyetjet shtesë.

16 Z. EMMERSON: [Përkthim] Kam vetëm disa aspekte nëse më  
17 lejoni. Njëra prej tyre është duke u përgatitur në të majtën  
18 time, se po nxjerrim numrat e referencës, kështu që mund të  
19 ketë një vonesë shumë të shkurtër.

20 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Emmerson:

21 Z. EMMERSON: [Përkthim]

22 PY. Dëshmitar, desha t'ju bëj disa pyetje të mëtutjeshme  
23 lidhur me aspektet që trajtuan Gjykatësit me ju, të dyja  
24 aspektet për të cilat dua t'ju pyes lidhen me pyetjet që ju  
25 bëri Gjykatësi Barthe, që është në të djathtë.

1 Dje ju bëmë pyetje paradite, pra, Gjykatësi Barthe ju  
2 pyeti për procesin përmes së cilit Qeveria e Përkohshme e  
3 Kosovës bënte emërimet të personave që më parë kishin qenë  
4 pjesë e Shtabit të Përgjithshëm. Ajo ju kujtohet kjo pjesë e  
5 pyetjes?

6 PË. Po, më kujtohet si pyetje.

7 PY. Më konkretisht ju pyeti nëse z. Veseli, kur mori përsipër  
8 detyrën në Qeverinë e Përkohshme të Kosovës, pra, a u  
9 zëvendësua z. Veseli nga dikush tjetër si shef i ZKZ-së, pra,  
10 në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, në Shtabin e Përgjithshëm  
11 të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Dhe po ashtu një pyetje  
12 tjetër -- jam duke parë transkriptin e përkohshëm në faqen 45,  
13 rreshti 16, Gjykatësi Barthe ju pyeti:

14 "Pra, ju nuk mund të thoni nëse z. Veseli e zëvendësuan  
15 apo e shkarkuan nga Shtabi i Përgjithshëm. A është kjo dëshmia  
16 juaj?"

17 Dhe ju u përgjigjët:

18 "Korrekt, kështu. Z. Veseli mund të përgjigjet saktësisht  
19 kur, shefi i shtabit, Agim Çeku. Ai mund të thojë nëse dikush  
20 u emërua atje. Ka fjalë që dikush ishte atje, por nuk e di se  
21 kush mund të ketë qenë ky person".

22 A është kjo dëshmia juaj?

23 PË. Kjo është. Dhe do t'i shtoja atë që unë kam dëgju se  
24 dikush e ka zëvendësu, po unë nuk e di kush dhe nuk kam dash  
25 të manipuloj. S'muj me ditë emrin e personit, për atë thashë

1 shefi i shtabit Agim Çeku mund ta dijë. Nuk mund të manipuloj  
2 kur nuk jam i sigurt në diçka që s'jam i sigurt. Nuk ia di  
3 emnin.

4 PY. E kuptoj. E kuptoj që nuk e dini emrin, por unë u  
5 fokusova tek kjo që duket në transkript ku thoni "kishte fjalë  
6 që dikush e zëvendësoi" dhe ju po e pohoni tani se ju kishit  
7 dëgjuar që dikush u emërua si shef i shërbimit informativ  
8 brenda UÇK-së për të zëvendësuar rolin që pati z. Veseli kur  
9 ky i fundit u bë pjesë e qeverisë së përkohshme, kështu? Këtë  
10 keni dëgjuar?

11 PË. Ka mundësi të jetë ashtu, po unë nuk isha i sigurt derisa  
12 nuk dijsa emrin, nuk dijsa datën, nuk dijsa vendimin me  
13 çfarë vendimi. Dhe nuk mund të manipuloj me supozime vetëm me  
14 mendimin tim. Për ato që i di konkret, i kam thënë konkret.  
15 Gjëna që i kam dëgju dhe nuk kam dash as ti them se u bë e  
16 tepërt këtu në këtë Gjykatë.

17 PY. Kjo është e drejtë. Po.

18 Z. EMMERSON: [Përkthim] A mund të lutem që të shfaqet në  
19 ekran dokumenti DKF0806, është një faqe e vetme. Është edhe  
20 shqipja dhe anglishtja në të njëjtin numër ERN. Duhet të jetë  
21 e qartë po duhet ta zvogëlojmë pak që të shohim dhe titullin,  
22 lëndën.

23 PY. Këtu mund të shohim në cep, lartë, në majtë, thotë që  
24 vjen nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, Shtabi i Përgjithshëm,  
25 shërbimi i ZKZ-së më 4 maj të vitit 1999. E shihni, pra, lartë

1 në krye në të majtë?

2 PË. Po, e shof. E shof.

3 PY. A pajtoheni që kjo i drejtohet, se shohim poshtë në të  
4 djathtë, i drejtohet kryeministrit dhe ministrit të Mbrojtjes,  
5 e shihni këtë?

6 PË. Po. Po, po.

7 PY. Nëse e shohim përmbajtjen, lënda është "Informatë" dhe  
8 thotë:

9 "Drejtoria për zbulim dhe kundërzbulim në bazë të të  
10 dhënave, informatave, të dhënave që posedon, vihen në dijeni  
11 se gjendja në Kosovë së shpejti mund të ndryshojë, pra, mund  
12 ië vijë deri te ndërhyrja e forcave tokësore. Duke u bazuar në  
13 sa u tha më lart lëshojmë këtë:

14 "Informatë

15 "Në fund të kësaj jave në fillim të javës së ardhshme,  
16 Britania e Madhe dërgon një grup luftarak komando dhe forca  
17 speciale të marinës në ujërat territoriale të Shqipërisë.

18 "Pikënisja e tyre është Plymouth.

19 "Transportimi do bëhet me anijen 'OCEAN'

20 "Përmbajtja luftarake është 1000 komando, me ta do të  
21 jenë dhe topxhinjtë.

22 "15 helikopter 'CHINOOK' apo 'SEIKING' janë në anije.

23 "Anija 'OCEAN' do të jetë platformë e veprimit dhe  
24 invazionit të tyre masivë të helikopterëve.

25 "Sulmet e helikopterëve pas miratimit të planit do të

1 veprojnë në prapavijë, në shpinë të armikut.

2 "Anijes 'OCEAN' do t'i bashkëngjitet anija luftarake  
3 'FEARLES' që është posaçërisht e pajisur për zbarkim në buzë  
4 të ujit dhe përdorë mjete të vogla luftarake".

5 Pastaj është bërë një vërejtje me shkrim dore që  
6 fatkeqësisht nuk mund të lexohet, vetëm që mund të lexojmë që  
7 fillon me "Grupi luftarak komando..."

8 Dhe pas kësaj shohim, është shumë e lehtë, shohim dhe në  
9 origjinal emrin, shohim:

10 "Shefi shërbimit ZKZ:

11 "Mensur Kasumi".

12 E shihni këtë, ka dhe nënshkrimin?

13 PË. Po, po. Dhe këtë emrin e njoh. Personin nuk e njoh, po si  
14 emër i njohur është. Nënshkrimin e ka, dokument sqaron  
15 informacionin e saktë. Duhet me kanë kështu, po unë nuk e kam  
16 ditë. Nuk e kam ditë edhe derisa s'e kam ditë nuk mund me e  
17 marrë përsipër.

18 PY. Shumë mirë. Po ju e dinit të paktën nga emri, nga nami që  
19 kishte, e njihnit Mensur Kasumin, apo jo?

20 PË. Po, po. Po. Si emër po.

21 PY. Mund të na thoni diçka më shumë lidhur me të?

22 PË. Nuk e di. Ky ka qenë dikun në zonën e Shalës, më duket,  
23 ushtar. Duhet të jetë i rrethinës të Vushtrisë me origjinë. Po  
24 nuk kam pasë kontakt profesional me të. S'kam pasë kontakt  
25 asnjëherë. Si emën i njohur.

1 PY. Kishit dëgjuar që kishte përvojë para ushtarake me  
2 luftimet në Bosnje?

3 PË. Po, kam dëgju që ka qenë oficer. Oficer po.

4 PY. Sa i takon fokusit të shërbimit të zbulimit në Shtabin e  
5 Përgjithshëm duket qartë nga përmbajtja e kësaj letre se  
6 Mensur Kasumi, që ishte aso kohe në fakt shefi i shërbimit të  
7 zbulimit, u jepte, u përcillte informacione tejet  
8 konfidenciale, informata, pra, ushtarake të cilat i kishte  
9 marrë lidhur me manovra të propozuara ushtarake britanike,  
10 pra, për të mbështetur UÇK-në në përpjekjet që ato bënin  
11 kundër Miloshevic?

12 PË. Unë nuk kam pasë ndonjë dokument në dorë prej tij, as  
13 ndonjë njoftim. As s'e kam njoft para lufte. Nuk e kam njoft  
14 si person para lufte. Fizikisht s'e kam kontakt kurrë. Kam  
15 dëgju për këtë emën. E di që ka qenë oficer. Nuk e kam ditë që  
16 e ka zëvendësu Kadri Veseli, tani po e shoh këtu që është  
17 ashtu.

18 PY. Por konkretisht nga përmbajtja e këtij dokumenti, se e  
19 kuptoj që s'e keni parë asnjëherë.

20 Por duke parë përmbajtjen e këtij dokumenti, del qartë,  
21 apo jo, se është një rol që përfshin ndërlidhjen me burimet e  
22 huaja ushtarake sepse ka njohuri të avancuara sa i takon  
23 dislokimit të forcave britanike në zonat shqiptare? Ndërlidhje  
24 me shërbimet e huaja të zbulimit. Do pajtoheshit ju me këtë?

25 PË. Kështu duket në dokument dhe më vjen mirë nëse këto i ka

1 ditë saktësisht kështu. Ne kemi pritë shumë herë forcat  
2 aleateve, kemi pritë edhe armë me na dorëzu, po as na kanë pru  
3 armë, as kanë ardhë në këmbësorë. Fatbardhësisht me aviona po,  
4 me bombardime.

5 PY. Po bëhet fjalë për një informatë shumë konkrete, apo jo?

6 PË. Po, po. Shifet se është ushtarak.

7 PY. Dhe nga përvoja juaj, qeveritë e përfshira në konflikte  
8 të huaja të armatosura nuk i bëjnë publike informatat e tyre  
9 se ku synojnë që të dislokojnë anijet e luftës paraprakisht  
10 sepse ky përbën një informacion të fshehtë, apo jo?

11 PË. Më habit fakti pse nuk shkruan diskret nalt, nuk shkrun  
12 diskret bile me dy vija të kuqe. U ka dashtë të jetë ashtu, po  
13 si duket e ka dhënë në dorë.

14 PY. E keni fjalën për dokumentin, që dokumenti duhet të  
15 kishte shenjën e konfidencialitetit? Po, po mundet.

16 PË. Po.

17 PY. Shumë mirë. Faleminderit.

18 Z. EMMERSON: [Përkthim] Dua që këtë dokument ta ofroj që  
19 të shënohet për identifikim.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ta shënojmë  
21 po e ofroni?

22 Z. EMMERSON: [Përkthim] Do ta ofrojë më mbrapa si provë.

23 Dokumenti i dytë të cilit dua t'i kthehem, nëse ju lutem  
24 mund të nxjerrim në ekran dokumentin numër DKV0807 deri në  
25 0814. Këto janë faqet.

1 PY. Ndërkohë që del kjo në ekran, nuk do ju bëj pyetje për  
2 dokumentin ende.

3 Z. EMMERSON: [Përkthim] Për Trupin Gjykses, ky është një  
4 dokument që e kanë dhënë autoritet zvicerane dhe është kopje e  
5 pasaportës së z. Veseli. Është një dokument që e kemi nxjerrë  
6 në përgjigje të pyetjeve që kanë bërë Gjykatësit. Shumë mirë.  
7 PY. Atëherë, ju bëri pyetje Gjykatësi Barthe nga mund ta  
8 dinit ju se z. Veseli nuk ndodhej brenda vendit, duke pasur  
9 parasysh se kur ishit në Shtabin e Përgjithshëm ju u larguat  
10 për një periudhë të caktuar gjatë masakrës së Reçakut të 15  
11 janarit. Ju kujtohet?

12 PË. Po.

13 PY. Dhatë dëshmi se ai nuk ndodhej aty gjatë kohës që kohës  
14 që ju ishit atje nga fillimi i dhjetorit deri sa ju e  
15 shoqëruat sërish që të hynte në vend në prill. Ju kujtohet  
16 besoj. Konkretisht ju si të thuash ju bëri pyetje z. Gjykatës  
17 Barthe në bazë të së cilës, pra, pyetje nga mesi i janarit kur  
18 ndodhi masakra e Reçakut dhe ju u larguat nga selia e shtabit  
19 për disa detyra. Ju kujtohet sa ditë ndenjët ju i larguar  
20 gjatë kohës së Reçakut?

21 PË. Minimumi është pesë ditë. S'besoj që kam qenë ma shumë.  
22 Se ka zgjatë beteja e Reçakut katër ditë. Domethënë, unë ditën  
23 e dytë të betejës kam arrit atje, pas masakrës dhe kemi  
24 zhvillu për katër ditë betejën. Pastaj jam kthyer në Shtab të  
25 Përgjithshëm më datën 20 apo 22, nuk isha shumë i sigurtë as

1 më herët, as sot. Kjo ishte.

2 PY. Pak a shumë pra, 15 dhe 19, këtë po thoni? Sepse masakra,  
3 me sa kuptoj, ka ndodhur më datë 15, pra, masakra serbe?

4 PË. Ashtu është.

5 PY. Ju nuk u larguat përpara kësaj date. Ju u larguat pasi e  
6 morët vesh këtë gjë që ndodhi më datë 15?

7 PË. Unë shkova për t'i ndihmu popullatën në Reçak dhe për të  
8 luftuar me forcat serbe për ato katër ditë. S'jam largue. Se  
9 fjala largim edhe ikje në luftë nuk është e mirë. Nuk ka qenë  
10 ashtu. Shkova për të luftuar në Reçak. Më kuptuat?

11 PY. Qartë. Qartë. jo, më interesojnë vetëm datat në fakt me  
12 thënë të drejtën. Pra, ju e latë selinë e Shtabit të  
13 Përgjithshëm në datë 15 dhe qëndruat i larguar deri nga data  
14 19, si të thuash, nga selia.

15 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ju lutem tani të kalojmë tek  
16 faqja e brendshme 0810. Është pjesa e poshtme e faqes. Po kjo  
17 është faqja, në rregull.

18 PY. Pra, shohim këtu se është një vizë dhe një vulë e hyrjes  
19 për z. Veseli për të hyrë në Sllovaki -- jo, ju kërkoj ndjesë,  
20 në Slloveni nga data 13 deri në datën 18 janar. E shihni datën  
21 që është nga fundi i faqes? Është data e hyrjes dhe ka dhe një  
22 datë largimi të shkruar me dorë.

23 PË. Po, e shof. E shof

24 PY. Ju ndihmon kjo që t'i përgjigjeni pyetjes së Gjykatësit  
25 Barthe më me saktësi nëse ka qenë apo jo z. Veseli në Kosovë

1 gjatë këtyre ditëve?

2 PË. Unë e besoj se e kam dhënë përgjigjen saktë edhe të duhur  
3 aq sa kam ditë unë dhe sa di unë. Po ky dokument jep përgjigje  
4 më shumë se ndoshta fjalët sepse e ka datën 13 dhe ka datën  
5 18. Po prapë unë e kisha me thënë diçka tjetër. Veseli ndoshta  
6 prej Sllovenisë ka shku në Shqipëri apo ka shku në Francë, unë  
7 nuk di ku ka shku, po në shtab s'ka qenë. Në Shtab të  
8 Përgjithshëm s'ka qenë. Se kjo datë tregon që ka lëvizë. Po  
9 s'ka qenë edhe mbasandaj s'ka qenë. Dhe pastaj s'ka qenë.

10 PË. Faleminderit.

11 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ju kërkoj që ta shënojmë këtë  
12 dokument për identifikim dhe të dyja dokumentet të ofrohen për  
13 në prova.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
15 kundërshtim nga Prokuroria?

16 Z. PACE: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim për asnjërin  
17 prej dokumenteve.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohen të  
19 dy dokumentet dhe do t'u caktohet numër prove, znj. Sekretare.

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
21 dokumenti i parë, DKV0806, do marri numrin e provës 2D17.

22 Dhe dokumenti i dytë, DKV0807 deri 0814 do të marri  
23 numrin e provës 2D18.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Kehoe,  
25 keni fjalën.

1 Z. KEHOE: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

2 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Kehoe:

3 Z. KEHOE: [Përkthim]

4 PY. Mirëmëngjesi, z. Dëshmitar. Shumë pak pyetje kam të  
5 shkurtra. Jo shumë gjatë. Ju lutem do të prek disa tema të  
6 cilat dolën me Gjykatësit dhe një temë që doli me Prokurorin.

7 S'po ndjek një renditje të caktuar kohore, por në  
8 përgjigjet e disa pyetje të Gjykatësve ju folët për takimin  
9 pranë kufirit me Shqipërinë me ambasadorin z. Holbrooke. Ju  
10 kujtohet?

11 PË. Po, e shpjegova atë takim që ka qenë në Junik në qershor  
12 1998 kur është taku në selinë e UÇK-së në Junik me Hajdin  
13 Abazin, Lum Haxhiu. Dhe shpjegova që në atë moment ka verifiku  
14 dhe ka pa konkretisht ushtri të armatosur me emblema, me  
15 uniformë, me armë dhe ka konstatu se ka një ushtri çlirimtare,  
16 jo siç na quanin serbët përpara organizatë civile fetare  
17 terroriste ku e di unë, domethënë, është heqë ai linçimi  
18 mëhershëm nga vetë Holbrooke.

19 PY. Tani për të sqaruar, diçka për të cilën folët  
20 shkurtimisht, kazerma e Junikut ishte e furnizuar mirë ngaqë  
21 ishte pranë kufirit me Shqipërinë me uniforma, armë , e kështu  
22 me radhë?

23 PË. Po, ata e kanë pasë ma lehtë dhe ma të mundshme të  
24 uniformohen, të bajnë armë nga Shqipëria e shumë më afër,  
25 terreni ka qenë më i mirë edhe kanë arritun që të kompletohen.

1 PY. Kërkoj ndjesë për ndërprerjen. Pra, ky takim në Junik siç  
2 na thatë u zhvillua në qershor të 1998, apo jo, saktë?

3 PË. Po. Kështu është.

4 PY. Dëshmia juaj këtu nuk se gjatë gjithë pjesës tjetër të  
5 UÇK-së ato ishin të uniformuar e të armatosur mirë njësoj si  
6 në qershorin e 1998, apo jo?

7 PË. Nuk kanë qenë të gjitha pjesët e UÇK-së njësoj, nuk kanë  
8 qenë të armatosur të gjithë njësoj. Kemi pasë mangësi të  
9 armëve, mangësi të uniformave. Po ishte fjala për vendin dhe  
10 ngjarjen e caktuar.

11 PY. Ju kuptoj, zotëri. Në këtë moment, pa hyrë me hollësi,  
12 pra, ju na thatë, na treguat që hytë në periudhën, etapën e  
13 formimit të batalionit tuaj në Budakovë dhe të zonës operative  
14 të Pashtrikut, një zonë, siç njihet kështu, në fakt, nga fundi  
15 i 1998 nga fillimi i 1999 është kriju, apo jo?

16 PË. Zonat janë kriju, të gjitha, nga fundi i 1998 fillimi i  
17 1999, sidomos në janar të 1999. Deri atëherë kanë qenë të  
18 pakompletume. Deri ka fundi i 1998 kanë qenë në nivele  
19 batalionesh, janë shndërru në nivele brigadash dhe kështu që  
20 kur janë bë tri e më shumë brigada kanë themeluar zonën.

21 Diku nënzona janë kanë sepse s'i kanë pasë më shumë se  
22 tri brigada. Te ne ka qenë e mundshme me qenë zona sepse kemi  
23 pasë në fillim pesë brigada e deri në fund kemi pasë shtatë  
24 brigada.

25 PY. Të kalojmë tani tek krijimi i zonës operative të

1 Pashtrikut. Folëm, për shembull, që komandant Drini erdhi në  
2 dhjetor të 1998 dhe pastaj qëndroi si shef, pra, si komandant  
3 i zonës operative deri në muajt e parë të 1999, kështu?

4 PË. Po, ashtu është.

5 PY. Përpara tij, përpara se të largohej ai për në Shqipëri më  
6 saktë, para se të nisej prenë Shqipëri apo për kufirin me  
7 Shqipërinë, ai caktoi z. Qadraku si shef të zbulimit, apo jo?

8 PË. Jo. Nga ana e kundërt. Para se me hy prej Shqipërie në  
9 Kosovë. Atje janë marrë vesh, para se me ardhë në Kosovë, jo  
10 para se me shku se s'ka dalë mbasandaj. Nuk ka shku mbasandaj  
11 për Shqipëri.

12 PY. Po. Ju kërkoj ndjesë. Ju kërkoj ndjesë. Por Drini, në  
13 fakt, ishte personi që e caktoi Qadrakun dhe e solli si shef  
14 zbulimi?

15 PË. Po, me vendim e ka pajisur mbasi ka ardhë mbrenda,  
16 domethënë, në janar.

17 PY. Ju kuptoj. Nuk keni parë ndonjë dokument ku ky vendim i  
18 Drinit për të caktuar Qadrakun në këtë post, pra, më saktë,  
19 nuk keni parë një dokumentacion të Shtabit të Përgjithshëm që  
20 ta aprovonte këtë vendim të Drinit?

21 PË. Nuk e kam pa, po e kam ditë se ka qenë shumë publike ajo  
22 punë për neve të zonës. Sepse G2 ka qenë me rëndësi, G1  
23 administrata, personeli. G2 ka qenë shumë i rëndësishëm dhe u  
24 ditë para G1 edhe para G-ve tjera është emëruar G2. I pari  
25 është emëruar Qadraku. Nuk kemi pasë tjerë të emërum. Për

1 Qadrakun e dinë të gjithë se më i pari ka qenë.

2 PY. U caktua si shefi i G2 nga Drini?

3 PË. G2. Në nivel të zonës G2.

4 PY. Do të prek nja dy tema edhe do të kaloj në një gjë  
5 tjetër. Ju bëri pyetje Gjykatësi Mettraux për Blerim Kuqin.

6 Dhe dokumenti që ju tregoi më duket Gjykatësi Mettraux është  
7 numri SPOE00248507.

8 Z. KEHOE: [Përkthim] Jo, më falni, është më duket se  
9 numri SPOE00232264. Kërkoj ndjesë. Ju kërkoj që ta nxirrni në  
10 ekran, ju lutem.

11 PY. Ky është një dokument për të cilin keni dëshmuar se nuk e  
12 keni parë kurrë më parë sa i takon Blerim Kuqit. Ju lutem  
13 kalojmë në faqen e dytë, në paragrafin e sipërm, ju lutem,  
14 shohim pjesën ku në anglisht është diku tre rreshta më poshtë,  
15 më duket katër rreshta më shqip. Ku thuhet se:

16 "Më 11 shtator të vitit 1998 ..."

17 Nuk e di a e shihni, z. Dëshmitar, që është:

18 "... 11 shtator 1999, pas ofensivës së armikut në ZO të  
19 Pashtrikut, ai" domethënë, Blerim Kuqi, "bëri shpërndarjen e  
20 Brigadës 123 ku ishte dhe komandant dhe bashkë me një numër të  
21 ushtarëve, pa lejen e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, ikën  
22 ... në territorin e Shqipërisë e me këtë veprim ndikuan  
23 seriozisht tek ushtarët me rënien e moralit ushtarak të tyre,  
24 duke hedhur armët dhe municionin, duke përhapur frikë,  
25 çrregullim dhe hutim te ushtarët".

1 Duke lënë mënjanë këtë dokument, faktikisht z. Dëshmitar,  
2 fakti qëndron që Blerim Kuqi e dezertoi pozitën e gjendur  
3 përballë sulmit serb në shtator të vitit 1998, apo nuk është  
4 kështu?

5 PË. Është reale, ashtu siç e thoni përpos datës. Data nuk  
6 mund të jetë 11 shtator. Po ofensiva e madhe serbe ka qenë më  
7 22 gusht, 23, 24, 25. Në gusht ka qenë kjo ofensivë. Në këtë  
8 ofensivë, ata kanë dezertuar qatë që përmendët. 11 shtatori më  
9 duket është vonë. Nuk di ku ka qëndru deri më 11 shtator.

10 Unë sa e di në gusht, ma së largu 24 gusht, ai nuk ka  
11 qenë më në Kosovë. U kanë dashtë ta dijë, ai ka qenë komandant  
12 brigade. Unë kam qenë komandant batalioni. Bile porosia e  
13 fundit e tij më ka qenë: Kujdes për civilët. Na kanë mbetë pa  
14 mbrojtje. Nëse mundesh me ndërkombëtarët dikun me Kryqin e  
15 Kuq. Mbase din gjuhë të huaja, ti shpjegon se janë në rrezik  
16 mujn me u masakru. Dhe unë nuk e kam dëgju më kurrë  
17 radiolidhjen e tina, domethënë, prej 24 gushtit. Data 11  
18 shtator është e shtyrë. Edhe pse a dokumenti dokument, unë e  
19 di kështu.

20 PY. Dezertimi, pra, nëse mund ta them, ka ndodhur nga data 22  
21 deri më datë 24 gusht, kështu?

22 PË. Kështu është. Kështu është.

23 PY. Me këtë dezertim të tijin, pra, anëtarët e Brigadës 130,  
24 gjithashtu kanë ik në Shqipëri me atë - më falni - Brigadës  
25 123 kanë ikur bashkë të në Shqipëri, pra, pa leje, kështu?

- 1 PË. Komplet stafi i Brigadës 123 kanë ik bashkë, për në  
2 Shqipëri kanë shku.
- 3 PY. Dhe kanë dezertu e kanë ikur në Shqipëri?
- 4 PË. Ca janë shkëput nga lufta, këta nuk mund të quhen ndryshe  
5 dezertorë. Edhe pse ka qenë ushtri çlirimtare, vullnetare, me  
6 vullnet kemi hy po s'kena pasë të drejtë ta lëshojmë kur dojmë  
7 ne. Ikja në pabesi është dezertim, ushtarakisht kështu  
8 kuptohet.
- 9 PY. Të ndryshojë temë paksa dhe dua të flas për një listë për  
10 të cilën ju bëri pyetje Prokuroria dhe besoj edhe Gjykatësi  
11 Mettraux.
- 12 Z. KEHOE: [Përkthim] Është me numër P711MFI. Pra, e  
13 shënuar për identifikim. Është lista e individëve të cilëve ju  
14 referua Gjykatësi Mettraux. Ju lutem ta nxjerrim në ekran.
- 15 PY. Ju kujtohet që keni diskutuar për këtë dokument gjatë  
16 dëshmisë tuaj si përpara Trupit Gjykues ashtu edhe me  
17 Gjykatësin Mettraux? Ju kujtohet?
- 18 PË. Më duket se e kam pa dje këtë letër. Më herët nuk e kam  
19 pa asnjëherë.
- 20 PY. Besoj se ua ka treguar edhe Prokuroria këtë dokument, apo  
21 jo, përpara dëshmisë këtu, apo jo?
- 22 PË. Mund të jetë e mundshme, po unë e kam harru. Po e mbaj  
23 mend që dje ma kanë, e kam pa në ekran.
- 24 PY. Ky dokument, Dëshmitar, pra, kur po e diskutonim me ZPS-  
25 në këtë dokument, a ju thanë ndonjëherë ata ju se ky dokument

1 vinte nga autoritet serbe? Ua kanë thënë këtë?

2 PË. Jo, jo. Nuk e kam pa më herët. S'besoj që e kam pa këtë  
3 dokument.

4 PY. Ajo që po ju pyes unë, domethënë, ajo ku dua të fokusohem  
5 unë është të kuptojmë nga ka ardhur dokumenti. Prokuroria a ju  
6 ka thënë që ata e kishin kuptuar se ky dokument ishte marrë  
7 prej autoriteteve serbe? A ua thanë këtë përpara se t'ju bënin  
8 pyetje?

9 E thënë troç, a ju tha Prokuroria ky dokumenti vjen nga  
10 serbët?

11 PË. Jo, z. Avokat. S'e kam pa këtë dokument edhe nuk e di as  
12 nuk e ka dedikimin kujt ju ka dorëzu, as nuk e ka datën kur  
13 është pranë dhe nuk mund të flasë asnjë emën këtu nuk po e  
14 njoh.

15 PY. Në rregull. E lemë emrin mënjane. Ndonjë përfaqësues i  
16 Prokurorisë kur ua tregoi këtë dokument, a ju tha ky dokument  
17 vjen prej autoriteteve serbe? Ua thanë ndonjëherë këtë?

18 PË. Unë e thashë edhe më parë, që nuk më është tregu ky  
19 dokument. Nëse e kam pa dje e kam pa, ma herët s'e kam pa këtë  
20 dokument.

21 PY. Mirë, vazhdojmë. Do ju tregoj një dokument që ua ka  
22 treguar Prokuroria, 1D71 është dokumenti.

23 Tani, ky është një dokument -- presim që të dalë. Ky  
24 është një dokument që ua ka treguar Prokuroria dhe ju keni  
25 thënë se ju nuk mendoni se ky vjen, domethënë, nga Shënimi

1 Përgatitor i 10 nëntorit dhe Shënimi Përgatitor i paragrafit  
2 12, në Shënimin Përgatitor numër 2. Pra, në këto dokumente ju  
3 keni thënë që nuk mendoj që është një urdhër i vlefshëm sepse  
4 urdhri vjen nga Shtabi i Përgjithshëm dhe nuk mund të  
5 nënshkruhet nga komandant Drini. Ju nuk besoni se ka pasë një  
6 mbledhje të Shtabit të Përgjithshëm më 5 janar siç thuhet në  
7 këtë dokument sepse ai ishte në J1 tek Shtabi i Përgjithshëm  
8 në atë kohë.

9 A ju kujtohet që ia thatë këtë Prokurorisë?

10 PË. Po, kështu i kam thënëun sepse jam bazuar, ky dokument nuk  
11 e ka strukturën e dokumentit të Shtabit të Përgjithshëm dhe  
12 nënshkrimi në emën të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka  
13 nënshkrue Ekrem Rexha për Ekremin, për Ekremin, veç emri i  
14 Ekrem Rexhës është. Për Ekremin ka nënshkrue Sulejman  
15 Kollqaku. Sulejman Kollqaku ka qenë zëvendëskomandant i zonës  
16 operative të Pashtrikut në këtë kohë. Është reale. Akoma ka  
17 qenë edhe pak ditë, më vonë ka ik. Po ky dokument nuk është i  
18 përpiluar nga Shtabi i Përgjithshëm.

19 Z. KEHOE: [Përkthim] Gjykatës, nuk jam i sigurt --

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk je i  
21 sigurt për çfarë?

22 Z. KEHOE: [Përkthim] Për përkthyesin, çfarë personi  
23 përmendi?

24 PY. Dëshmitar, thatë ndonjë gjë lidhur me pozitën e z.  
25 Kollqaku? Sepse përkthyesi nuk e kuptoi, nuk e kapi këtë gjë.

1 Ju kërkojmë ndjesë për këtë.

2 PË. Po. Këtu është në fund të faqes emri dhe mbiemri Ekrem  
3 Rexha, komandant Drini. Ndërsa e nënshkruar për Ekrem Rexhën  
4 është nga Sulejman Kollqaku. Sulejman Kollqaku ka qenë  
5 zëvendëskomandant i zonës operative të Pashtrikut në atë kohë.  
6 Nuk kishte të drejtë të nënshkruante për Shtabin e  
7 Përgjithshëm, as për Ekrem Rexhën.

8 PY. Paragrafi flet, paragrafi paraparak thotë për një mbledhje  
9 të Shtabit të Përgjithshëm më 5 shkurt të 1999. E shihni këtu  
10 ku flitet për këtë mbledhje?

11 PË. Po, e kam pa. Dhe e kam thanë dhe më herët, nuk ka pasë  
12 ndonjë mbledhje, unë kam qenë në Shtab të Përgjithshëm. Nëse  
13 është mbajt në një vend tjetër, unë nuk kam mund ta kam në  
14 kontroll krejt zonën, normal, po në Shtabi të Përgjithshëm s'u  
15 mbajt mbledhje. Edhe nuk jam në dijeni që ka pasë mbledhje atë  
16 datë.

17 PY. Prokuroria ju tregoi një dokument që ka numrin  
18 SPOE00226468 dhe 69.

19 Z. KEHOE: [Përkthim] Ju lutem të vendoset në ekran.

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Edhe njëherë numrin, ju  
21 lutem?

22 Z. KEHOE: [Përkthim] SPOE00226468. Është dokument që e ka  
23 përdorë Prokuroria. E kanë pasë dhe në listën e vet të  
24 prezantimeve dhe e kanë përdorur, pra, nuk ka qenë fillimisht  
25 në listën e tyre të materialeve dhe e vendosën më pas.

1 Z. PACE: [Përkthim] Nëse ju ndihmoj, dokumenti i parë që  
2 i tregova dëshmitarit në këtë kontekst -- nuk e di nëse është  
3 një dokument që kërkon z. Kehoe, po dokumenti është  
4 SPOE002267677 dhe më pas shkohet tek 68.

5 Z. KEHOE: [Përkthim] Unë thjesht po lexoj numrin që kanë  
6 dhënë. Po numrat shpesh dhe i ngatërrojmë, Gjykatës.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë  
8 fokusohemi tek numri që na dha z. Pace. A bëhet fjalë për këtë  
9 dokument?

10 DËSHMITARI: I njëjti dokument, z. Avokat. Pse përlangoni.  
11 I njëjti dokument i marrun me shkrim.

12 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, po.

13 PY. Këto janë disa shënime dhe një rend dite. Shohim  
14 raportin. Shihni emra në raport?

15 PË. Po, po.

16 PY. Nëse ky është një raport i një mbledhjeje i 5 janarit dhe  
17 ju, me sa kuptoj unë, jeni tek J1 në këtë kohë, pra, më 5  
18 janar ju jeni tek J1. Ju nuk jeni fare i pranishëm këtu, nuk  
19 jeni i ftuar këtu, apo jo?

20 PË. Normalisht u kanë dashtë të më ftojnë se atëherë nuk ka  
21 qenë Adem Grabovci, kam qenë vetë. Kam qenë unë. Po unë nuk e  
22 di për këtë mbledhje a është mbajt në ndonjë objekt tjetër  
23 sepse ka pasë edhe objekte përcjellëse. Në Shtab të  
24 Përgjithshëm nuk jam në dijeni që është mbajt kjo mbledhje.  
25 Dhe unë nuk kam marrë pjesë.

1 PY. Po. Adem Grabovci në këtë pikë ka ikur, apo jo?

2 PË. Ka qenë i largum, nuk them që ka ik, nuk di ku ka shku.

3 PY. Okej. Ka qenë i largum. E kuptoj. Po në këtë listë  
4 s'përmendet Hashim Thaçi fare, apo jo?

5 PË. Jo, nuk përmendet.

6 PY. Dhe kjo është pika ku besoj, për këtë keni dhënë dëshmi,  
7 nga nëntori deri në mars, për këtë keni dhënë dëshmi dhe  
8 Hashim Thaçi ka qenë fytyra ose paraqitja ose përfaqësuesi i  
9 diplomacisë për UÇK-në nëpër botë, apo jo?

10 PË. Ka kontaktuar dhe nëpër territoret e luftës sa di unë me  
11 Hill ka kontakt. Ka kontakt me shumë të tjerë, Tina  
12 Kaidanova e tjerë diplomatë që kanë ardhë me kontaktue dhe në  
13 zonë teme janë kontaktue në Dragobil e në vende të ndryshme.

14 PY. Po gjatë periudhës, pra, flasim nëntor deri në mars, ai  
15 nuk është fare në vend, është jashtë vendit dhe takohej me  
16 përfaqësues ndërkombëtar, udhëheqës ndërkombëtarë, apo jo?

17 PË. Sidomos nga shkuarje për Rambuje, atje ka qenë jashtë  
18 vendit. Domethënë, kur është bë më 8 shkurt a kur është bë  
19 nisja, nuk e di, s'jam i sigurtë, po nuk ka qenë më një  
20 Kosovë. Edhe më përpara s'e kam pa. Gjatë kohës që kam qenë në  
21 shtab nuk e kam pa.

22 PY. Pra, gjatë gjithë kohës --

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Kehoe,  
24 pyetjet tuaja duhet të burojnë nga pyetjet e Gjykatësve. Tani  
25 keni dalë nga ky kuadër.

1 Z. KEHOE: [Përkthim] Gjykatës, në fakt ajo që unë kisha  
2 thënë paraprakisht, unë doja që të bëja pyetje veçanërisht për  
3 këtë dokument.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po tani ju e  
5 vendosët dhe e përcaktuat që ai s'ka qenë i pranishëm atje.  
6 Kështu që s'ka më nevojë.

7 Z. KEHOE: [Përkthim] Në rregull, Gjykatës.

8 PY. Dëshmitar, pra, ju asnjëherë nuk e keni parë Hashim  
9 Thaçin në Shtabin e Përgjithshëm, apo jo?

10 PË. Ju kam thënë se e kam pa një herë në Budakovë dhe një  
11 herë rastësisht e kam taku, nuk më kujtohet data, në oborr të  
12 shtabit te çesmja, te kroni. Nga larg distanca, më larg se me  
13 juve. Dy herë e kam pa krejt gjatë luftës.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ky është  
15 material është trajtuar më përpara.

16 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës. Po bëhet  
17 fjalë për pranverën dhe verën e 1998, Dëshmitar, jo më vonë  
18 gjatë 1998 apo 1999, apo jo?

19 PË. 1998. 1998.

20 PY. Faleminderit.

21 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk kam më pyetje.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

23 Z. Roberts.

24 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit. Kam nja pesë a  
25 dhjetë minuta.

1 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Roberts:

2 Z. ROBERTS: [Përkthim]

3 PY. Mirëmëngjes, Dëshmitar. Dhe unë kam disa pyetje shtesë që  
4 burojnë nga pyetjet që ju bëri Gjykatësi Barthe dhe paradite  
5 dhe unë do citoj transkriptin që ta kuptojmë më lehtë.

6 Bëhet fjalë për faqen 10409 të transkriptit dhe këtu  
7 flitet për faktin që z. Selimi është zëvendësuar në Shtabin e  
8 Përgjithshëm. Dhe ju jeni përgjigjur:

9 "Unë jam i bindur që dikush e ka zëvendësuar atje, po unë  
10 nuk e di kush ka qenë ky person. Sepse nuk e kam këtë  
11 informatë".

12 Pastaj u diskutua për cilin Selim e kishit fjalën dhe ju  
13 e sqaruat:

14 "Me sa di unë Rexhep Selimi ka qenë ministër i rendit  
15 publik në Qeverinë e përkohshme dhe unë nuk e di a e ka  
16 zëvendësu njeri në Shtabin e Përgjithshëm apo ia lanë vendin  
17 vakant".

18 A ju kujtohet dëshmia që dhatë dhe?

19 PË. S'kam as çka ti shtoj, as çka t'i heqi. Kështu është.

20 PY. Nëse unë do thoja që Shaban Shala e ka zëvendësuar si  
21 inspektor të përgjithshëm, do ju ndihmonte kjo, do ju  
22 rifreskonte kjo kujtesën?

23 PË. E di që Shabanin në TMK ka qenë. Në atë kohë ka mund të  
24 jetë dhe në UÇK, po nuk e kam ditë kush është. Në TMK po.

25 Shaban Shala ka qenë. Në UÇK nuk e kam ditë. Kam thënë që s'e

1 di.

2 PY. Në rregull. Një pyetje në lidhje me këtë dhe kjo prapë  
3 vjen nga një përgjigje që i dhatë Gjykatësit Barthe. Kjo ka  
4 lidhje me disa nga vizitat e z. Selimi në zonën operative të  
5 Pashtrikut. Besoj se përgjigja juaj ishte kjo dhe është e  
6 reflektuar në faqen 10406 të transkriptit:

7 "Gjykatësi Barthe: Ju thatë që ju jeni, është mendimi  
8 juaj se ai, z. Selimi, bënte vizita rutinë dhe grumbullonte  
9 informata për situatën në përgjithësi. Pyetja ime është nga e  
10 dini ju këtë sepse ai nuk ka qenë atje. ju e keni takuar vetëm  
11 njëherë?"

12 Ju jeni përgjigjur:

13 "Që nuk kam parë asnjë dokument, apo ndonjë raport ku të  
14 vërtetohej se ai kryente inspektive. Prandaj unë dola në  
15 përfundimin dhe ky është mendimi im, është perceptimi im, që  
16 vizitat e tij ishin thjesht vizita rutinë".

17 A ju kujtohen këto pyetje-përgjigje të djeshme?

18 PË. Më kujtohet edhe pyetja edhe përgjigja dhe ashtu është.  
19 Perceptimi im, mendimi im del se në mënyrë spontane i ka bë  
20 ato dhe ka pyet çfarë e kem gjendjen, si e kem gjendjen.  
21 Normal, çdonjëri prej neve dhe komandantët edhe eprorët të  
22 njëjtën gjë kishin me bë.

23 PY. Që të jemi të qartë, fjala tek "vizitat rutinë". Ju, në  
24 fakt, e korrigjuat më pas thatë "spontane" se kur thua rutinë  
25 ju s'e kishit fjalën për vizita të rregullta? Se ju vetëm një

1 herë e keni parë në zonën e Pashtrikut.

2 PË. Sigurisht ma e drejtë kish me qenë spontane. Unë e kam  
3 thënë rutinë, është e vërtetë që e kam thënë rutinë, tuj mëndu  
4 që jam tue thënë spontane. Po s'e di sa e ka relevancë ajo  
5 puna rutinë a spontane. Po nuk kam pa dokument që ai ka marrë  
6 dikën në pyetje, ia ka pyet me shkrim me marrë raport për  
7 gjendjet, me inspektu diçka, siç e bëjnë inspektorët.

8 PY. Lidhur me këtë pikë, ai nuk u prezantua asnjëherë si  
9 inspektor i përgjithshëm, besoj se këtë e konfirmuat dje dhe e  
10 keni konfirmuar po ashtu para dy javësh kur folëm lidhur me  
11 këtë pikë. Kështu? Mund të përgjigjeni thjesht me "po" ose  
12 "jo"?

13 PË. Ashtu është. Atë e kam njoft në bazë të vëllaut të atij,  
14 Ramadan Selimi dhe unë e kam njoft si Rexhep Selimi, jo si  
15 inspektor.

16 PY. Më falni, më falni që ju ndërpreva, po duam që t'i bëjmë  
17 sa më shpejt. Pra, ai asnjëherë nuk u prezantua si inspektor i  
18 përgjithshëm, çka do të thotë që kjo përputhet me faktin që ai  
19 nuk e kishte më atë pozitë në atë kohë që i bie prilli dhe  
20 maji i 1998.

21 Z. PACE: [Përkthim] Kjo nuk është pyetje për dëshmitarin.  
22 Kjo është argument, kjo ngelet për debat.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po është edhe  
24 spekuluese sepse pyetja nuk është formuluar në mënyrë të  
25 përshtatshme.

1 DËSHMITARI: Për mue, për mue nuk është prezantue.

2 Z. ROBERTS: [Përkthim] Tërhiqem.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar.

4 Dëshmitar, pyetja u rrëzua, u tërhoq, më falni.

5 Z. ROBERTS: [Përkthim] Kjo ishte pyetja ime e fundit.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

7 Alagendra.

8 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Nuk kemi pyetje për

9 dëshmitarin, po ne kemi një dokument që duam të pranohet si

10 provë. Është një dokument që ia kemi treguar dëshmitarit më 16

11 nëntor.

12 Referenca është SPOE0026714 dhe 715. Janë paraqitur

13 dëshmitarit më 16 nëntor. Dhe referenca në transkript është

14 10341-10342.

15 Z. PACE: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime për këtë. Besoj

16 se këto janë faqet që janë marrë nga dokumenti SPOE00226697.

17 Nuk kam asnjë kundërshtim për faqet që janë shfaqur

18 dëshmitarit. Dhe meqë po flasim për këtë kam edhe unë një

19 dokument që dua të pranohet si provë.

20 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Faqet konkrete që unë kërkoj

21 të pranoni janë faqen 226714, 226715.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të dyja këto

23 faqe pranohen. Dhe do të marrin numrin e provës materiale.

24 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Këto faqe do të marrin

25 numrin e provës materiale 4D14.



1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

2 Bëjmë 15 minuta pushim dhe përgatitemi për dëshmitarin e  
3 radhës. Besoj se është gati. Në rregull.

4 Bëjmë 15 minuta pushim. Faleminderit.

5 --- Seanca ndërpritet në orën 10.17

6 --- Seanca rifillon në orën 10.33

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të  
8 vazhdojmë tani me dëshminë e Dëshmitarit të Prokurorisë  
9 W02116.

10 Të akuzuarit ende janë të pranishëm në sallën e gjyqit.  
11 Jemi në seancë publike.

12 Asistente, ju lutem sillnin dëshmitaren në sallë.

13 [Dëshmitarja hyn në sallën e gjyqit]

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjesi,  
15 Dëshmitare.

16 Asistentja e Gjykatës do t'ju japë tekstin e deklaratës  
17 solemne të cilën duhet ta merrni në bazë të rregullës 141(2).  
18 Ju lutem shiheni dokument dhe lexojeni me zë të lartë.

19 DËSHMITARJA: [Përkthim] E ndërgjegjshëm për rëndësinë e  
20 dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj  
21 solemnisht se do të them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe  
22 asgjë tjetër përveçse të vërtetën dhe nuk mbaj asgjë për të  
23 cilën kam dijeni.

24 DËSHMITARJA: SANDRA MITCHELL

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të

1 uleni.

2 Dëshmitare, sot do të fillojmë me dëshminë tuaj që  
3 mendohet se do të zgjasë rreth dy, tre ditë.

4 Sikurse e dini, fillimisht pyetjet do t'jua bëjë  
5 Prokuroria. Pasi të përfundojnë, kanë të drejtën ekipet e  
6 Mbrojtjes t'ju bëjnë pyetje sikurse dhe Gjyqtarët e Panelit  
7 mund të kenë pyetje për ju.

8 Prokuroria parashikon tre orë e gjysmë për pyetjet.  
9 Mbrojtja ka parashikuar 11 orë. Sa i takon këtyre  
10 parashikimeve u inkurajoj të gjitha palët që të shfrytëzojnë  
11 sa më mirë kohën që është caktuar. Trupi Gjykues mund të  
12 lejojë pyetje shtesë nëse përmbushen kushtet përkatëse.

13 Dëshmitare, përpiquni t'u jepni përgjigje qartë, me fjali  
14 të shkurtra. Nëse nuk e kuptoni pyetjen, lirisht kërkoni që  
15 pyetja të përsëritet ose thjesht thoni që nuk e kuptoni dhe  
16 ata do ta sqarojnë për ju.

17 Po ashtu, na thoni bazën e njohurisë tuaj lidhur me  
18 faktet dhe me rrethanat për të cilat do t'ju bëjnë pyete.

19 Në qoftë se ZPS-ja do ju kërkon të flisni në lidhje me  
20 korrigjimet që keni bërë në deklaratat tuaja, ju kujtohet që  
21 të thoni me zë të lartë për procesverbal që deklarata juaj me  
22 shkrim, përfshirë me korrigjimet që keni bërë së fundmi,  
23 pasqyron saktësisht deklaratën tuaj.

24 Ju lutem flisni pranë mikrofonit dhe prisni pesë sekonda  
25 përpara se të jepni përgjigje si dhe flisni ngadalë në mënyrë

1 që t'ju ndjekim dhe përkthyesit.

2 Dëshmitare, ditëve që do të jepni dëshmi në sallën e  
3 gjyqit, nuk duhet që të diskutoni me askënd përmbajtjen e  
4 dëshmisë suaj jashtë kësaj salle deri në momentin që keni  
5 përfunduar tërësisht me dëshminë tuaj. Nëse ndokush ju bën  
6 pyetje jashtë Gjykatës lidhur me këtë dëshmi, ju lutem na vini  
7 menjëherë në dijeni.

8 Ju lutem mos flisni më në qoftë se ngre dorën ose ju  
9 kërkoj unë që të pushoni së foluri sepse kjo nënkupton që  
10 duhet t'ju jap një udhëzim.

11 Nëse keni të nevojshme për pushime, ju lutem na thoni dhe  
12 do të bëjmë organizimet e nevojshme.

13 I kuptoni të gjitha këto?

14 DËSHMITARJA: [Përkthim] Po.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

16 Do të fillojmë me Prokurorin që është ulur në të majtën tuaj.

17 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Faleminderit.

18 Pyetje nga znj. Mayer:

19 [Dëshmitarja përgjigjet përmes përkthimit]

20 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

21 PY. Mirëmëngjes, Dëshmitare. Ne jemi takuar më përpara, po  
22 unë do të prezantohem dhe njëherë. Unë jam Deborah Mayer dhe  
23 unë do t'ju bëj pyetje në emër të Prokurorisë.

24 Ju lutem a mund që na thoni emrin dhe mbiemrin për  
25 procesverbal?

1 PË. Sandra Lynn Mitchell.

2 PY. Dhe datëlindja juaj?

3 PË. 2 maj 1962.

4 PY. Kombësia juaj?

5 PË. Amerikane.

6 PY. Duhet t'ju pyes shkurtimisht nëse mund t'i tregoni Trupit

7 Gjykues për arsimin tuaj edhe profesionin tuaj. Fillojmë

8 fillimisht me arsimin tuaj, shkurtimisht.

9 PË. Kam përfunduar studimet në administrim biznesi dhe

10 kontabilitet dhe kam edhe doktoraturë për juridik. Fillimisht

11 kam qenë, kam ushtruar të drejtën penale edhe po ashtu kam

12 punuar në gjykatën supreme në shtetin të Oklahomës. Më pas kam

13 ushtruar të drejtën për shpalljen e falimentit kryesisht për

14 likuidimet dhe riorganizimet. Më pas e fillova karrierën në

15 nivel ndërkombëtar në Bullgari, aty isha pjesë e Dhomës së

16 Juristëve të Avokatëve të Amerikës. Më pas kalova në Bosnje në

17 fund të viteve 1990 dhe fillova punë në të drejtat e njeriut

18 për zgjedhjet. Dhe më pas punova për OSBE-në në Poloni dhe më

19 pas në Kosovë.

20 PY. Jam e interesuar për kohën që keni qëndruar në Kosovë. Na

21 tregoni si filloi puna juaj në Kosovë, përfshirë edhe pak para

22 hyrjes në Kosovë, njëherë si filluat, si u lidhët me Kosovën?

23 PË. Unë po punoja si këshilltare për shtetin e së drejtës për

24 zyrat për përfaqësinë e OSBE-së për Nismën Demokratike edhe të

25 Drejtat e Njeriut në Varshavë, në Poloni. Kjo bëhet fjalë në

1 vitin 1998, fillimi i 1998. Gjatë verës, OSBE-ja filloi  
2 diskutimet për të nisur një operacion paqeruajtës apo  
3 armëpushimi në Kosovë, më çuan në zyrat e Vjenës, OSBE-ja në  
4 Vjenë, pra, në mënyrë që të përgatisja komponentin e të  
5 drejtave të njeriut të këtij misioni.

6 PY. Shkurtimisht a mund të na thoni çfarë detyrash kishit  
7 konkretisht në Vjenë kur po përgatisnit pjesën e të drejtave  
8 të njeriut të këtij misioni, pra, programin për të drejtat e  
9 njeriut?

10 PË. U fokusua tek mandati që na ishte dhënë, që fillimisht  
11 ishte të dokumentohej çfarë u ndodhte civilëve në Kosovë. Këtu  
12 duhej përcaktuar se cilat ligje ndërkombëtare dhe vendase mund  
13 të merrnim parasysh dhe çfarë detyrash fillestare do të kishte  
14 ky departament, çfarë personeli do të kishte, çfarë lloji apo  
15 çfarë profesioneesh do të nevojiteshin për këtë zyrë.

16 PY. A erdhi një moment pas fazës së zhvillimit të programit  
17 kur ju fizikisht shkuat në Kosovë?

18 PË. Po, më dislokuan në Kosovë, kam qenë në pjesën e fillimit  
19 të këtij operacioni për të ndihmuar në terren me personelin se  
20 po merrnim personel të ri dhe të merresha me mbarëvajtjen e  
21 departamentit, aktivitetet e përditshme, dokumentacionet.

22 PY. A kishte ndonjë emër misioni ku keni qenë ju? Ju thatë që  
23 ishte pjesë e OSBE-së, a kishte ndonjë komponent konkret për  
24 të cilin punonit?

25 PË. Po ishte Misioni Verifikator i Kosovës me akronimin MVK.

1 PY. Dhe ju përmendët që fokusi juaj ishte tek të drejtat e  
2 njeriut. A ishte një nënkomponent ky i komponentit të MVK-së?  
3 PË. Operacioni MVK ishte në kuadër të një marrëveshjeje mes  
4 OSBE-së dhe qeverisë jugosllave apo serbe. Dhe mandati i tyre,  
5 mandati ishte të monitoronin armëpushimin mes Ushtrisë  
6 Çlirimtare të Kosovës, pra, UÇK-së edhe forcave jugosllave dhe  
7 serbe, si dhe të inkorporonin apo të përmbushnin disa detyra  
8 të tjera të OSBE-së për të gjithat shtetet anëtare, siç është  
9 dhe monitorimi i të drejtave të njeriut.

10 PY. Pra, misioni i MVK-së përveç të drejtave të njeriut a  
11 kishte ndonjë drejtori a u ngrit ndonjë drejtori konkrete aty  
12 për t'u fokusuar vetëm tek çështjet e të drejtave të njeriut?

13 PË. Po. Fillimisht një sektor i vogël, por në momentin e  
14 evakuimit kishim arritur deri në kishim 75 punonjës.

15 PY. Dua të mbetemi në fillimin tuaj. Përafërsisht kur shkua  
16 nga Vjena në Kosovë dhe filluat të formonit ekipin tuaj në  
17 Kosovë në kuadër, pra, nën ombrellën e MVK-së?

18 PË. Në Vjenë isha gjatë verës, besoj se u dërgova në Kosovë  
19 në fund të tetorit, nëntor. E harrova pjesën, më falni e  
20 harrova çfarë pyetje më bëtë

21 PY. Jo, periudha kohore. Po dua të më thoni, t'i tregoni  
22 Trupit Gjykses, nëse mundeni, ku shkua fillimisht atje sa  
23 persona ishin me ju dhe cilat ishin hapat e parë që ndërmoret  
24 me mbërritjen tuaj në Kosovë?

25 PË. MVK-ja kishte filluar me misionet e mbikëqyrjes

1 diplomatike, çka do të thotë se kishte staf në terren që  
2 punonte në zona të caktuara. Ne morëm disa prej këtyre  
3 punonjësve. Nëse më kujtohet saktë, mora tetë apo nëntë nga  
4 ata punonjës. Dhe më pas filluam të merrnim persona të  
5 kontraktuar nga shtetet anëtare të OSBE-së. Dhe sa herë që  
6 ishte e mundshme, i pyesnim personave të na tregonin çfarë  
7 interesi kishin të drejta e njeriut, çfarë përvojash kishin në  
8 këtë fushë. Shumë vinin nga fusha e policisë, më konkretisht  
9 polic në pension që i kishim aftësitë që t'i kryenin hetime të  
10 këtij lloji.

11 PY. Pra, kur shkuat fillimisht në terren në fund të tetorit,  
12 në fillim të nëntorit dhe filluat të merrnit këta observuesit,  
13 vëzhguesit që ishin tashmë atje po dhe filluat të merrnit  
14 punonjës të rinj, ju në atë kohë çfarë pozite kishit?

15 PË. Unë fillimisht isha drejtoreshë e të drejtave të njeriut,  
16 i raportoja një diplomati gjerman Bernd Borchardt edhe  
17 ambasadorit William Walker. Unë kisha për detyrë të  
18 sigurohesha që kishim marrë punonjësit e duhur, se kishin  
19 akomodimin, se i kuptonin detyrat e tyre. I prezantoja në  
20 vendet që i dislokonin. Dhe të kontaktonim në varësi të  
21 ngjarjeve lidhur me ato që ndodhnin në zonat e tyre të  
22 përgjegjësisë, mblidhnim dokumentacionin dhe jepnim komente.

23 PY. Ju përmendët ambasadorin William Walker. Çfarë pozite  
24 kishte ai në atë kohë?

25 PË. Ai ishte kreu i Misionit Verifikator të Kosovës.

1 PY. Ju përmendët si pjesë e punës suaj se i raportoniit -- ju  
2 përmendët dy persona, por që një prej tyre ka qenë ambasador  
3 Walker. Ju atij i raportoniit drejtpërdrejt lidhur me aspekte  
4 të caktuara?

5 PË. Bernd Borchardt ishte shumë i thjeshtë, të punoje me të  
6 ishte krejt normale t'i raportoje atij apo ambasadorit Walker,  
7 kushdo që ishte i lirë në ato momente.

8 PY. Flasim për rolin dhe për ekipin tuaj, ju përmendët disa  
9 nga detyrat që keni bërë, po dua ta shtjellojmë pak më shumë.  
10 Kur u krijua fillimisht puna juaj apo të drejtuari juaj ju  
11 thatë që ishte fillimisht për detyrë monitorimi i një  
12 armëpushimi. A mund të ma përshkruani vizionin e drejtorisë së  
13 të drejtave të njeriut çfarë pune konkrete kishte grupi juaj?

14 PË. Kur shkuva në Kosovë ishte ende konflikti i armatosur.  
15 Kishte pushtim ushtarak. Kishte tanke serbe, kishte prani  
16 shumë të madhe ushtarake në Prishtinë, snajpera, shumë ushtarë  
17 që mbanin armët me atë dritën e kuqe dhe kjo ishte krejt e  
18 zakonshme në të gjithë territorin, ishte e pranishme në të  
19 gjithë territorin. Roli ynë ishte të monitoronim kushtet dhe  
20 trajtimin e civilëve në mënyrë që të fokusoheshim kryesisht në  
21 përgjegjësitë e qeverisë serbe dhe jugosllave në atë kohë si  
22 shtete anëtare të OSBE-s.

23 Qartazi kishin krijuar një tension shumë të rënë sa i  
24 takon të drejtave të njeriut në atë zonë. Ne e monitoronim  
25 edhe sjelljen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kryesisht

1 lidhur me personat që ishin zhdukur, qasjen në territorin e  
2 tyre dhe tek të ndaluarit.

3 PY. Ju përmendët fillimisht, kur folët për personelin, ju  
4 thatë i caktonit, u jepnit role të ndryshme. Dhe jo vetëm që  
5 garantohehit që të merrnin çdo gjë që i nevojitej, tip  
6 akomodimi dhe gjëra të këtij lloji, por gjithashtu mbikëqyrnit  
7 punën e tyre.

8 A mund të na përshkruani shkurtimisht çfarë strukture  
9 kishte drejtoria e të drejtave të njeriut? Edhe çfarë  
10 përgjegjësish kishte secili prej këtyre? Çfarë përgjegjësie,  
11 po në vija të përgjithshme, kishte secili prej këtyre  
12 punonjësve?

13 PË. Isha unë. Ishte zëvendësdrejtori, ndonjëherë e quanim  
14 edhe koordinator terreni. Kishte pesë zyra rajonale në ato  
15 kohë. Doni që t'ua them me emër?

16 PY. Po.

17 PË. Kishim një në Prishtinë, Mitrovicë, në Pejë, në Gjilan  
18 dhe në Prizren. Këto ishin zyrat më të mëdha rajonale që  
19 ndonjëherë kishin nga qindra punonjës. Kishin edhe specialist  
20 të të drejtave të njeriut të nivelit të lartë.

21 Disa të tjerë, disa nga fushat rajonale kishin dhe fusha  
22 terreni. Për shembull, në Prizren, kishte shumë prani në  
23 Rahovec, që do të thotë që kishte edhe personel në terren të  
24 shpërndarë.

25 PY. Nën mbikëqyrjen e këtyre specialistëve të lartë të të

1 drejtave të njeriut që ju sapo përshkruat, çfarë pune bëhej në  
2 përditshmëri? Çfarë bënte në terren një punonjës i të drejtave  
3 të njeriut?

4 PË. Puna fokusohet në qasje tek të ndaluarit. Personat që  
5 ishin ndaluar nga forcat serbe. Anëtarë të familjes që ishin  
6 të tronditur, që kërkonin personat që ishin zhdukur apo që i  
7 kishte marrë policia. Bënim dhe një monitorim të gjykimeve në  
8 atë kohë. Kishte shumë, unë po them në thonjëza, kishte shumë  
9 raste "terrorizmi" që gjykonin autoritet serbe në gjykatat  
10 lokale.

11 Shihnim a kishte kujdes spitalor, a kishin të drejtë për  
12 polici, për gjyqësor, shërbimet publike, këto ishin shërbimet  
13 që në atë kohë i drejtonin serbët edhe shqiptarët e kishin  
14 shumë të vështirë qasjen në këto shërbime. Këto kanë qenë  
15 aktivitete të përditshmerisë. Shihnim autobuzat, pikat e  
16 kontrollit, çdo lloj gjëje që kishte me lëvizjet.

17 PY. Si pjesë e kësaj, ju thatë që bënit raportim. A kishte  
18 ndonjë mënyrë tipike si e dokumentonte ekipi juaj aktivitetet  
19 që bënin, pra, si raportoni?

20 PË. Zyrat rajonale çdo ditë çonin një raport situacional në  
21 selinë në Prishtinë. Aty ishte dhe një pjesë që i dedikohej të  
22 drejtave të njeriut. Ndonjëherë bëhej ndonjë raport i thelluar  
23 për të drejtat e njeriut, në qoftë se kishte ndodhur një  
24 incident i rëndë, në qoftë se kishte ndodhur ndonjë vrasje,  
25 pra, merrnim dhe raporte të këtij lloji. Dhe në fund të javës,

1 kishim raportin javor dhe më pas këto raporte i mblidhnim të  
2 gjitha bashkë dhe na jepnin mundësinë të bënim një analizë më  
3 të thellë për të kuptuar se çfarë po ndodhte në një rajon të  
4 caktuar pos edhe në të gjithë vendin.

5 PY. Krahas komunikimeve me shkrim që mbanit, që mbante  
6 terreni me zyrat e tjera dhe me selinë, a mbanit takime dhe,  
7 nëse po, a mund të na përshkruani në vija të përgjithshme si i  
8 kishit strukturat e takimeve tuaja?

9 PË. Po, unë ose zëvendësja ime, Susanne Ringgaard, shkonim në  
10 vend. Se Kosova është vend i vogël. Mund të shkonim dhe çdo  
11 ditë në vende të caktuara, në një qendër rajonale apo në  
12 ndonjë nga zyrat e terrenit për të ndjekur një raport të  
13 caktuar apo për t'i dhënë ndihmë drejtorit rajonal në takimet  
14 që kishin me autoritet vendore në një zonë të caktuar lidhur  
15 me diçka konkrete që mund të kishte ndodhur.

16 Gjithashtu takonim përfaqësuesit e zyrave lokale të OSBE-  
17 së, po përpiqemi t'u shpjegonim çfarë bënim, të zhvillojmë  
18 procedura më të mira, sepse misioni ishte ende duke u  
19 zhvilluar.

20 PY. A mbanit dhe takimet në zinxhirin komandues, mund të  
21 themi, në mënyrë që të përcillej informacioni deri tek  
22 ambasadori Walker me atë që ndodhë në terren?

23 PË. Po. Bëhej një instruktazh, instruktim, instruktazh  
24 mëngjesi apo një mbledhje mëngjesi që kryhej me stafin e  
25 nivelit të lartë dhe ambasadori Walker apo kushdo që ishte

1 përgjegjës në atëkohë dhe flitej për çfarë kishte ndodhur 224  
2 orët e fundit, ambasadori ishte i interesuar të dinte çfarë  
3 pritshmëri kishte për ditën tjetër, për 24 orët e ardhshme,  
4 çfarë përparësish kishim. Pra ishin takime operative. Zgjasnin  
5 rreth 35 minuta, 45 minuta, diçka e këtij lloji.

6 Prandaj kishte ndonjëherë takime rastësore, të papritura,  
7 i bënim raport personave në Vjenë. Kishim shumë takime përmes  
8 telefonit, po kishim takime me OJQ dhe organizatat e tjera në  
9 fushën e të drejtave të njeriut. Po ashtu takoheshim me  
10 përfaqësuesit lokal në terren, me Kryqin e Kuq, me përfaqësues  
11 të OKB-së dhe të gjitha këto bëheshim me qëllimin e shkëmbimit  
12 të informacionit.

13 PY. Përmendët dhe grupet e tjera përveç MVK-së dhe OSBE-së. A  
14 ndanit informacion për personat që nuk ishin në vend apo që  
15 nuk ishin pjesë e organizatës tuaj, a e ndanit raportet tuaja  
16 me shkrim me këta? Këto raportet situacionale apo raportet  
17 javorë apo ditorë a i ndanit ato a i nxirrtnit këto raporte  
18 përveç brenda ekipit të MVK-së në vend?

19 PË. Përpara evakuimit, besoj se e vetmja palë me të cilin e  
20 ndante departamenti im informacionin ishte TPNJ-ja. Gjykatësi  
21 Arbour ka qenë atëherë personi i caktuar që kërkonte të kishte  
22 informata dhe e kishte shumë të vështirë, me atë shkëmbim  
23 informacion.

24 Pjesë të tjera të misionit tonë mbase ndanin informacion  
25 me forcat e NATO-s që në atë kohë ishin të vendosura në

1 Maqedoni apo me misionet diplomatike në kryeqytetet e tyre.

2 PY. A ndanit informacione brenda OSBE-së për personat që nuk  
3 ishin në Kosovë?

4 PË. Vetë OSBE-ja është një agjenci ndërqeveritare, pra,  
5 raportet që vinin nga MVK-ja më pas ndaheshin. Besoj atëherë  
6 kanë qenë 54 shtete anëtare dhe besoj se ndaheshin me këto  
7 shtete anëtare. Mbase ka pasur edhe organizata të tjera  
8 ndërkombëtare që merrnin informacione në formën e këtij  
9 raporti, për shembull, si Kryqi i Kuq Ndërkombëtar apo  
10 organizatat e OKB-së edhe kështu me radhë, për të kuptuar dhe  
11 këto jepeshin nga selia, nga zyrat qendrore.

12 PY. Ju thatë që një nga punët tuaja ishte e fokusuar tek të  
13 ndaluarit apo tek personat që ishin shpallur të zhdukur. Dua  
14 të flasim pak për këtë.

15 Fillimisht, nga e merrnit vesh ju, qoftë ju personalisht  
16 apo ekipi juaj, nga e mësonit ju që ishin mbajtur të ndaluar  
17 persona apo që ishin të zhdukur?

18 PË. Kjo ka qenë një problem shumë i madh për popullatën në  
19 gjithë Kosovën në atë kohë. Prandaj përfaqësuesit lokalë  
20 politikë na thonin. Vetë anëtarët e familjes vinin në zyrat  
21 tona dhe raportnin që ishte zhdukur një anëtar i familjes.  
22 Ishin shumë të shqetësuar sepse i përcillnin nga një  
23 organizatë ndërkombëtare te tjetra. Edhe ndonjëherë dhe kur  
24 shkonim në fshat e dëgjonim nga përfaqësuesit e fshatit që  
25 persona të caktuar janë mbajtur të ndaluar ose janë tashmë të

1 zhdukur. Në atëkohë vinte shumë informacion drejtpërdrejt nga  
2 popullata civile.

3 PY. Kur thoni "të zhdukur" apo "të ndaluar", ju si e keni  
4 kuptuar aso kohe, çfarë raportesh merrnit ju? Ku mendohej se  
5 ishin këta persona kur thoni "të zhdukur", nëse mundeni na  
6 jepni ndonjë shembull konkret të atyre që dëgjonit që më pas  
7 ju dilnit në përfundimin që këta persona ose ishin mbajtur të  
8 ndaluar ose ishin të zhdukur.

9 PË. Po i ndaj në dy kategori. Një kategori janë shqiptarë të  
10 Kosovës, ishin shqiptarë të Kosovës, që hapin një ditë derën,  
11 shkonte një oficer polic serb, donte informacion, merrte një  
12 nga anëtarët e familjes e çonte në stacionin e policisë dhe ka  
13 të ngjarë që ky person as të mos të shihej më gjallë. Dhe  
14 krijohej përshtypja fillimisht se ky person ishte i mbajtur i  
15 ndaluar ose nga policia serbe, pra, nga policia serbe.

16 Por kishte dhe raste kur kishte luftime në një zonë të  
17 caktuar dhe një person nuk kthehej më në shtëpi. Dhe në këtë  
18 rast këto persona klasifikoheshin si persona të zhdukur.

19 Më pas, dolën dhe raste, po jo në tetor, nëntor, po më  
20 vonë, disa muaj pasi kishim shkuar atje, disa javë, personat  
21 mbaheshin të ndaluar nga UÇK-ja. Kemi dëgjuar nga policia  
22 serbe se kishte oficerë të policisë serbe që ata besonin se  
23 ishin mbajtur të ndaluar apo ishin nën arrestin e UÇK-së.

24 PY. Dua të fokusohem në pjesën e fundit kur thatë që filluat  
25 të merrnit vesh se kishte dhe të ndaluar apo persona që i

1 kishte marrë UÇK-ja. Së pari, përdornit ndonjë terminologji  
2 tjetër për UÇK-në ju, a kishte akronim apo emër tjetër UÇK-ja?  
3 PË. Unë do t'i përdor herë kështu, herë ashtu, po ka pasur.  
4 Akronim është UÇK-ja, akronimi që njihja unë është UÇK-ja.

5 PY. Ju thatë se disa muaj pasi kishit mbërritur atje filluat  
6 të dëgjoni se mund të kishte dhe të ndaluar prej UÇK-së e na  
7 dhatë shembullin e policisë serbe që vinte dhe ju kontaktonte  
8 lidhur me këtë. A keni marrë ndonjëherë raporte apo informata  
9 nga vetë banorët, jo nga policia apo ushtria jugosllave, vetë  
10 nga populli keni marrë informata lidhur me persona të ndaluar  
11 që UÇK-ja kishte ndaluar këta individë?

12 PË. Po. Sidomos në ato zona ku ishte operacionale UÇK-ja dhe  
13 kishte një perimetër, çka do të thotë e kishin siguruar tokën  
14 dhe territorin dhe duhej të kaloje përmes pikave të kontrollit  
15 për të hyrë në këtë territor. Ne i quanim zona ku nuk  
16 penetronin dot forcat serbe, kështu e njihnim ne, përveçse kur  
17 bënin sulme të drejtpërdrejta. Po këto ishin zona të siguruara  
18 nga UÇK-ja.

19 Dhe ata kryenin dhe punën e policimit në këto zona,  
20 përpiqeshin të krijonin një gjysmë shërbimi qeveritar, *quasi*  
21 qeveritar. Sa i takon punës së policisë që kryenin ata, ata  
22 arrestonin kriminelët, por dhe arrestonin personat që ata i  
23 konsideronin si kolaboracionistë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.  
25 Prokurore, duhet të bëjmë pushimin e paradites këtu.

1 Dëshmitare, kemi një pushim tani për gjysmë ore. Do të  
2 kthehemi këtu për 30 minuta. Ndërkohë që sekretarja do t'ju  
3 nxjerrë nga salla e gjyqit.

4 Ju lutem, nuk duhet të flisni me askënd sa i takon  
5 dëshmisë tuaj përpara Trupit Gjykues.

6 DËSHMITARI: [Përkthim] Po, patjetër.

7 [Dëshmitarja përfundon dëshminë]

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë  
9 pushim deri në orën 11.30

10 --- Pauza fillon në orën 11.01

11 --- Seanca rifillon në orën 11.30

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

13 Asistente e Seancës, ju lutemi sillni dëshmitaren në sallë.

14 [Dëshmitarja vijon dëshminë]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,  
16 dëshmitare, do të vazhdojmë me pyetjet nga Prokuroria.

17 Znj. Prokurore, fjala për ju.

18 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

19 PY. Dëshmitare, kur morëm pushimin, sapo përfunduar së foluri  
20 për të ndaluarit nga UÇK-ja. Thatë përpara pushimit, dhe një  
21 prej shembujve që na dhatë përpara se sa të bënim pushimin, që  
22 mund të ndodhte që një individ të shkonte në dyert e tyre t'i  
23 merrte në stacionin e policisë dhe t'i ndalonin.

24 A keni pasur raporte në rastet kur UÇK-ja, ka qenë  
25 individi ose personat që kanë shkuar për të marrë personat e

1 tjerë dhe për t'i ndaluar ato?

2 PË. Po.

3 PY. A mund të na jepni një shembull të një raporti që mund të  
4 kishit ju dhe që ku do pasqyrohej një raportim i tillë?

5 PË. Zakonisht kjo ndodhte në zonat të cilat kontrolloheshin  
6 nga UÇK-ja, ku nuk kishte aty autoritete serbe. Për shembull,  
7 kishte raste kur ne merrnim informacion nga anëtarët e  
8 familjeve, që një person për shembull ose disa persona të  
9 cilët ishin të veshur me uniforma të zeza me sigmën e UÇK-së,  
10 i trokisnin në derë dhe merrnin babain ose vëllain e tyre për  
11 një bisedë dhe ata shkonin bashkë me UÇK-në dhe merreshin në  
12 pyetje prej tyre.

13 PY. Kjo biseda informale, ndodhte zakonisht, domethënë këtë  
14 thonin zakonisht UÇK-ja kur shkonte për të marrë dikë?

15 PË. Bisedë informale është një shprehje që përdoret zakonisht  
16 në Ballkan kur policia ose autoritetet përkatëse shkojnë për  
17 të bërë pyetje ndaj dikujt dhe për t'i dërguar në stacion  
18 policie, përgjithësisht kjo, domethënë, është shprehja që  
19 përdoret.

20 PY. A keni marrë gjithashtu raporte ku një person i caktuar  
21 mund të merrte një letërthirrje ose një njoftim me shkrim ku i  
22 kërkohet që të shkonin dhe paraqiteshin përpara UÇK-së në  
23 mënyrë të tillë që t'i përgjigjej pyetjeve të mundshme prej  
24 saj?

25 PË. Ndonjëherë, po. Më pak zakonisht, por ndonjëherë edhe

1 mund të ndodhte.

2 PY. Në këto raste, a mund t'i tregoni Trupit Gjykues në qoftë  
3 se ka pasur raste kur keni marrë raporte nga të ndaluarit dhe  
4 më pas keni mësuar se ata ishin liruar?

5 PË. Po, po. Pa diskutim. Ky ishte një ndër gjërat që ne  
6 mundoheshim që të bënim si me autoritetet serbe, edhe me UÇK-  
7 në. Pra, që të kuptonim pak më tepër se pse ndaloheshin  
8 njerëzit dhe pse merreshin ata në pyetje, apo çfarë u ndodhte  
9 atyre.

10 Kështu që në përgjigje të pyetjes tuaj, po, merrnim  
11 raporte si nga autoritetet serbe ku si rezultat i negociatave  
12 të suksesshme liroheshin personat, zakonisht oficerët e  
13 policisë, por gjithashtu edhe nga anëtarët e familjes. Edhe  
14 ata vinin dhe na thonin që njerëzit që ishin ndaluar mund të  
15 ishin liruar dhe që ishin kthyer në shtëpi.

16 PY. Po OSBE-ja, me aq sa dini ju, a ka qenë ndonjëherë e  
17 përfshirë në lirimin e të ndaluarve?

18 PË. OSBE-ja zakonisht ishte e përfshirë në negociata lidhur  
19 me lirimin e oficerëve serbe edhe me forcat ushtarake serbe.  
20 Mund të jemi përfshirë gjithashtu edhe në disa prej lirimeve  
21 të civilëve, por kryesisht kemi qenë të përfshirë në lirimin e  
22 personave që lidheshin me MUP-in ose ushtrinë jugosllave.

23 PY. Përsëri, nuk e kam për ju personalisht vetëm, por thjesht  
24 dua t'ju pyes në qoftë se e dini apo jo nëse OSBE-ja ka qenë e  
25 përfshirë në lirimin e individëve, mundësisht përfshirë edhe

1 civilët.

2 PË. Po. Jo unë domosdoshmërisht, por anëtarët e zyrave  
3 rajonale pa diskutim që janë të përfshirë në procese të tilla.

4 PY. Sapo ju pyeta në qoftë se jeni në dijeni të individëve që  
5 janë ndaluar dhe më pas janë liruar. A keni qenë në dijeni kur  
6 individët janë ndaluar dhe nuk janë parë më asnjëherë?

7 Domethënë, me aq sa ju kanë raportuar anëtarët e familjeve,  
8 domethënë, a ka ndodhur raste kur personat janë marrë dhe nuk  
9 janë parë më kurrë?

10 PË. Po, fatkeqësisht, po. Megjithatë, madhësia ka qenë e  
11 ndryshme. Domethënë, numri i personave të cilët janë ndaluar  
12 nga autoritetet serbe ishin nga shumë më të mëdha se shifrat  
13 e personave që janë ndaluar nga UÇK-ja.

14 PY. Na e shpjegoni pak më tepër sa i takon madhësisë së  
15 fenomenit. Na e shpjegoni pak më tepër dhe pastaj do t'ju bëj  
16 një pyetje tjetër.

17 PË. Po, gjatë okupacionit serb ka pasur shumë serbë ose forca  
18 të sigurisë të Serbisë në Kosovë që është një vend i vogël në  
19 terma relativë, dhe autoritetet serbe kanë pasë përgjithësisht  
20 tendencën që të mbanin të ndalonin të rinjtë në veçanti të  
21 cilët mund të ishin anëtarë potencialë të UÇK-së, ose ushtarë  
22 potencialë të UÇK-së. Disa prej të ndaluarve i kanë dërguar në  
23 Serbi dhe sa i takon shifrave nuk është se i dimë tamam këto  
24 shifra. Jemi mbështetur në burime të tjera për shembull në KKN  
25 për të ditur këto shifra, por ishin në mijëra -- në qindra,

1 mos me thënë në mijëra. Pra, përgjithësisht këto ishin persona  
2 të cilët dërgoheshin në godina të veçanta, domethënë, në  
3 stacione policie ose në burgje në struktura të cilat ishin pak  
4 më shumë të orientuara nga natyra e godinave të ndalimit,  
5 pavarësisht se çfarë mund të ishin konkretisht.

6 PY. Për të kuptuar dallimin e ndalimeve nga të dyja palët,  
7 dua që të përqendrohemi pak te ndalimet e UÇK-së. Ju na folët  
8 pak sa për njerëzit që merreshin, për shembull, na dhatë  
9 shembullin, sa për ilustrim po e them këtë shembull, ju thatë  
10 që shfaqeshin persona që ishin të veshur me uniforma të zeza  
11 me sigmë të UÇK-së dhe i merrnin anëtarët e familjes.

12 A ju kujtohet në qoftë se keni raportuar raste të tilla  
13 ku individët janë marrë nga UÇK-ja nga vende publike, apo  
14 ndodhte që gjithmonë të shkohej dhe të merrej individi në  
15 shtëpi?

16 PË. Jo, ne e kemi parë UÇK-në ta bëjë këtë gjë domethënë të  
17 marrë persona nga varrimi pas vrasjeve të Reçakut, kurdo që  
18 ata e shikonin që kishin autoritet për të bërë si policë, pra  
19 silleshin si policë edhe i ndalonin njerëzit.

20 PY. Përmendët Reçakun, a mund të na thoni ju lutem në qoftë  
21 se ka ndodhur ndonjë gjë në janar 1999, në Reçak që pati  
22 ndikim mbi punën tuaj sa i takon të ndaluarve nga UÇK-ja?

23 PË. Nga mesi i janarit, ne kemi pasur numrin, domethënë, më  
24 të lartë të stafit që ardhur domethënë pas pushimeve, u kthye  
25 pjesa më e madhe e stafit. Ndërkohë që ekzistonte frika e

1 ofensivës serbe nga autoritetet serbe që kishte rritur  
2 tensionin në zonë.

3 Një prej teknikave të përdorura nga UÇK-ja ishte që të  
4 zinte në pritë një patrullë serbe dhe të tërhiqej më pas. Dhe  
5 serbët më pas hakmerreshin dhe zakonisht hakmerreshin në zonat  
6 ose në fshatrat që ishin rreth e qark vendit ku ishin zënë  
7 pritë. Pra, nuk ishte e thënë që domosdoshmërisht të kishin  
8 ushtarë të UÇK-së si kundërpërgjigje të shpagimit të tyre ose  
9 të hakmarrjes së tyre.

10 Në rastin e Reçakut, mbas një ngjarje të tillë UÇK-ja  
11 kishte marrë një zonë të madhe në rrugën e furnizimit ndërmjet  
12 Serbisë dhe Kosovës ku serbët lëviznin trupat e tyre dhe kjo u  
13 konsiderua si shumë provokative.

14 Kështu që ne morëm raporte, pati sulme të autoriteteve  
15 serbe, nuk e mbaj mend tamam raportin, por një natë përpara se  
16 sa të ndodhnin vrasjet në Reçak, ne filluam të merrnim raporte  
17 për të shtëna të shumta zjarri në afërsi të Reçakut kishte  
18 verifikues të MVK-së që ishin të pranishëm. Atje u gjetën  
19 shumë trupa të vdekur rreth 40, mbi 40 trupa të vdekur. Burra,  
20 mendoj që ka qenë ndërmjet tyre dhe një grua dhe një fëmijë,  
21 domethënë, kishte shumë persona të vdekur. Shumë prej tyre  
22 kishin të shtëna me armë në kokë. Ishin fshatarë të zakonshëm,  
23 nuk është se ishin me uniforma të UÇK-së. Ndërkohë që me shumë  
24 anëtarë të familjes nga të të vdekurve, me të cilët biseduam,  
25 e konfirmuam faktin që ata nuk ishin pjesëtarë të UÇK-së. Pra,

1 kjo është shfaqur gjithashtu dhe në raportet të MVK-së dhe  
2 ambasadori Walker ka qenë shumë i ashpër. Kjo ka qenë masakra  
3 më e keqe ndoshta që çoi në intensifikimin e tensioneve.

4 Çoi në zemërim, sigurisht, jo vetëm nga autoritetet  
5 serbe, por edhe nga autoritetet e UÇK-së. Dhe për faktin që  
6 ata gjithsesi domethënë donin që të krijonin prita pavarësisht  
7 nga fakti që mund të kishte shpagim nga forcat serbe sepse ky  
8 ishte një model që ishte përsëritur dhe në të shkuarën.

9 PY. Kjo ngjarje, a e bëri MVK-në që të përqendrohej më tepër  
10 tek gjetja e vendit ku mbaheshin të ndaluarit dhe në pasjen e  
11 qasjes tek ta?

12 PË. Mendoj se çfarë bëri Reçaku ishte që pati një ndryshim  
13 paradigme në MVK. Domethënë, këta persona nuk është se ishin  
14 të përfshirë në çështje të të drejtave të njeriut. Domethënë  
15 ata që nuk e dinin, veçanërisht, se çfarë përfaqësonin  
16 çështjet e të drejtave të njeriut, filluan që të  
17 ndërgjegjësoheshin sepse bëhej fjalë për një masakër të  
18 përmasave që ne nuk e kishim parë më përpara. Kështu  
19 padiskutim kjo çoi në monitorimet të cilat u kryen si nga ana  
20 e UÇK-së, por sigurisht dhe nga ana e autoriteteve serbe.

21 PY. Duke kuptuar që u intensifikua vëmendja nga të dyja  
22 palët, për momentin dua që të përqendrohëm edhe një herë tek  
23 vizitat që mund të keni bërë tek të ndaluarit e mbajtur nga  
24 UÇK-ja. A ka ndodhur në ndonjë pikë të caktuar kohe gjatë  
25 janarit, shkurtit të 1999, kur ju personalisht keni qenë e

1 përfshirë në përpjekje për të shkuar dhe për të vizituar  
2 vendet ku mbaheshin të ndaluar persona nga UÇK-ja?  
3 PË. Po, ka pasur disa demarkime ose protesta në zona në  
4 afërsi të Prishtinës nga familjet serbe për të ditur se ku  
5 ishin personat e zhdukur të familjarëve të tyre, sepse ka  
6 pasur disa persona serbë të zhdukur. Ambasadori Walker ishte  
7 shumë i shqetësuar mbi atë që perceptonim ne, sepse ky ishte  
8 perceptimi ynë që kishim më shumë njerëz në terren dhe kishte  
9 më shumë informacion, dhe përshtypja që na u krijua neve ishte  
10 që kishte më shumë persona të ndaluar. Nuk e di në qoftë se  
11 kjo është e vërtetë apo jo, por këtë perceptim, këtë ide  
12 krijuam ne.

13 Ne gjatë gjithë kohës pra, mundoheshim që të kishim  
14 vëmendje sa i takon të ndaluarve serbë. Mendoj që Kryqi i Kuq  
15 Ndërkombëtar ishte i suksesshëm në këtë kuadër sa i takon  
16 çështjeve që kanë të bëjnë shtet me shtet, por sa i takon UÇK-  
17 së kjo ishte shumë më e vështirë, sepse ata që merreshin ose,  
18 për shembull, oficerët ndërlidhës me UÇK-në filluan që të  
19 kërkonin qasje në vendet e ndalimit.

20 Për shembull, më kujtohet një vend ndalimi në veçanti. Ka  
21 shënime lidhur me këtë dhe ka të bëjë nga, me fillimin e  
22 shkurtit ose mesin e shkurtit të 1998.

23 PY. Përpara sesa të kalojmë këtu, ju sapo përmendët oficerët  
24 ndërlidhës. A mund t'i tregoni Trupit Gjykses se kush ishin  
25 këta persona dhe, kur thoni që ata po mundoheshin të kishin

1 gasje, çfarë doni të thoni konkretisht me këtë?

2 PË. MVK-ja ishte një operacion thuajse ushtarak, kuazi-  
3 ushtarak, për armëpushim. Domethënë, ne kishim shumë persona  
4 që kishin përvojë ushtarake në MVK. Kishim shumë brigadierë të  
5 përgjithshëm të cilët ishin përgjegjës për qendrat rajonale.  
6 Ndërkohë që secila prej këtyre qendrave rajonale kishte ish-  
7 oficerë ushtarakë që më pas u caktuan si ndërlidhës për UÇK-  
8 në, domethënë si oficerë ndërlidhës për UÇK-në apo për MUP-in  
9 dhe për ushtrinë jugosllave.

10 Këta persona ndërlidhës krijonin një raport me homologët  
11 e tyre. Këto do ishin dy individë të veçantë, ishin dy apo tre  
12 individë të veçantë të cilët ishin në bashkëbisedim të  
13 vazhdueshëm për të ditur se çfarë po ndodhte. Këta oficerë  
14 ndërlidhës ishin kryesisht në rrugë ose si lloj bashkëpunimi  
15 ndërmjet, le të themi, për të marrë informacion për ushtrinë  
16 jugosllave ose për UÇK-në.

17 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Ju lutem, të nderuar Gjykatës,  
18 në qoftë se mund të sqarojmë diçka që ka të bëjë me faqen 56,  
19 rreshtin 17. Kam përshtypjen që dëshmitarja e kishte fjalën  
20 për 1998, jo për 1999.

21 DËSHMITARJA: [Përkthim] Po, në fakt.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,  
23 znj. O'Reilly.

24 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

25 PY. Duke u përqendruar te pjesa që ju thatë që ju kujtohet

1 një vizitë ku keni qenë vetë personalisht e pranishme në  
2 shkurt. A ju kujtohet se sa herë keni bërë vizita në vendet e  
3 ndalimit të UÇK-së në periudhën janar, shkurt 1999?

4 PË. Nuk kanë qenë shumë herë. Më kujtohet ky rasti që e  
5 përmenda pak më herët dhe, për sa i takon vizitave të tjera,  
6 për të qenë e sigurtë më kujtohen në mënyrë të paqartë.

7 PY. E kuptoj që nuk ju kujtohen hollësitë, por a ju kujtohet  
8 në qoftë se keni qenë pesë, gjashtë herë gjithsej?

9 PË. Mund të ketë qenë aq.

10 PY. Përderisa ju kujtohet rasti i vizitës në shkurt në  
11 veçanti, le të flasim për këtë rast. A mund t'i përshkruani  
12 Trupit Gjykues se si u organizua kjo vizitë, në qoftë se kjo  
13 vizitë ndoqi këtë modelin që ju e përshkruat përmes oficerët  
14 ndërlidhës apo në qoftë se është bërë ndonjë mënyrë tjetër?

15 PË. Ne morëm raporte nga terreni për një ndërtesë ndalimi në  
16 një zonë të caktuar përgjegjësie të MVK-së. Pasi u konsultuam  
17 me oficerët e të drejtave të njeriut, dhe me stafin përkatës,  
18 zakonisht bëhej, merrej vendimi që të ushtrohej presion mbi  
19 UÇK-në në mënyrë të tillë që të lejohej qasja në një vend  
20 ndalimi. Presioni bëhej nga oficeri ndërlidhës në nivelin  
21 homolog të tyre të palës tjetër dhe, sa i takon zinxhirit të  
22 komandës, mund të ketë qenë një kapiten, për shembull, duke  
23 marrë parasysh që në nivelin rajonal ishin këto që ne i quajmë  
24 si brigadierë të përgjithshëm, kështu që kam përshtypjen që  
25 homologu në UÇK mund të ishte një komandant zone.

1 Pra, në raste të tilla bëhej shkëmbimi i informacionit,  
2 jepeshin emrat, domethënë kush do të ishin personat që do të  
3 shkonin për të vizituar vendin e ndalimit, në rastin në fjalë  
4 unë, Susanne Ringgaard, shoferi. Ndoshta një oficer,  
5 përkthyesi, dhe zakonisht do ishte me ne dhe një përkthyes,  
6 zakonisht mund të ndodhte që shoferi të shërbente dhe si  
7 përkthyes. Në raste të tilla jepeshin koordinatat e vendit,  
8 koha kur do të bëhej vizita.

9 PY. Nëse e kuptoj drejt, ju nuk do ishit domosdoshmërisht  
10 personi që kontaktonit me UÇK-në, do ishte një prej këtyre  
11 oficerëve ndërlidhës që do diskutonte apo do ndërlidheshe me  
12 UÇK-në dhe do diskutonte çështjet përkatëse, ose do të  
13 ushtronte presion për të pasur qasje. Dhe ky personi  
14 ndërlidhës pastaj do ju jepte ju hollësi për sa i takonte  
15 takimit, kështu ishte?

16 PË. Po, e saktë.

17 PY. Ju lutem, vazhdoni më tej. Pra na thatë që kush ishte  
18 pjesëtar i kësaj vizite. Bëhej fjalë për një grup të vogël  
19 personash nga ana juaj. Na kujtoni dhe një herë ju lutem kush  
20 ishte Susanne Ringgaard?

21 PË. Susanne ishte zëvendësja ime në atë kohë.

22 PY. Pra, ishit ju të dyja, shoferi që zakonisht ishte dhe  
23 përkthyesi, por në qoftë se nuk ishte përkthyesi ishte dhe  
24 shoferi dhe përkthyesi dhe dikush që ishte oficer sigurie, apo  
25 jo?

1 PË. Po. Zakonisht udhëtonim me dy automjete. Zakonisht vizita  
2 të tilla organizoheshin gjatë natës. Në makinën e dytë  
3 zakonisht ishin personat e ndërlidhjes së UÇK-së, një telefon  
4 celular satelitor dhe person sigurie.

5 PY. A mund të na thoni se pse vizita të tilla i bënte një  
6 oficer i të drejtave njerëzore? Domethënë në rastin në fjalë  
7 pse ju personalisht që kishit atë pozicion që kishit, dhe  
8 zëvendësja juaj, merrnit pjesë në një vizitë të tillë?

9 PË. Një ndër gjërat delikate ku flitet për operacionet e të  
10 drejtave të njeriut, kur fillon dhe të ushtrosh pra presion  
11 kjo mund të çojë në prishjen e marrëdhënieve. Kjo është pikë  
12 delikate, kështu që ajo çfarë bënim ishte që kishim këto  
13 marrëdhëniet ose punët e përditshme me UÇK-në, për shembull,  
14 çështje të qasjes ose të lëvizjeve paraprake, kështu që për të  
15 mos ndërprerë këtë marrëdhënie ne zakonisht dërgonim persona  
16 nga shtabi, nga zyra jonë qendrore për të marrë pjesë në  
17 takime të nivelit të lartë në mënyrë të tillë që personi të  
18 mos ishte aq shumë i madh, se të nesërmen duhej të pije kafe  
19 me një person të tillë.

20 Dhe për këtë arsye, nga zyra qendrore kishte njerëz që  
21 shkonin atje. Dhe jo vetëm kaq, por edhe për të dhënë edhe  
22 sinjalin se sa e rëndësishme ishte kjo çështje. Për shembull,  
23 mbështetur në udhëzimet e ambasadorit Walker kjo ishte diçka  
24 me peshë, ishte e rëndësishme, për të dhënë një mesazh pra  
25 bënim përbërjen e tillë të grupit.

1 PY. Pra, ju thatë që ju dhanë koordinatat, ju thatë që në  
2 këtë rast, në këtë vizitë ishte janar, shkurt ishte errësirë  
3 jashtë. A mund të na thoni çfarë ju kujtohet lidhur me  
4 temperaturën jashtë?

5 PË. Gjatë dimrit në Kosovë është shumë ftohtë. E mbaj mend që  
6 ishte ftohtë. Ishte lagështirë. Nuk kishte energji elektrike,  
7 shikoje vetëm ato shtëpitë të cilat kishin ndriçim përmes  
8 gjeneratorit. Kishte trafik shumë të kufizuar, shumë pak  
9 makina që lëviznin, dhe serbët ishin ata që kryesisht kishin  
10 kontroll mbi territorin, dhe të udhëtoje gjatë natës nga një  
11 zonë tek tjetra ishte e rrezikshme. Dhe zakonisht gjatë kësaj  
12 periudhe, domethënë gjatë natës, serbët binin në pritë.

13 Në përgjigje të pyetjes, ishte një natë e ftohtë e  
14 lagësht në rastin e kësaj vizite konkrete.

15 PY. Teksa flasim për lëvizjet edhe udhëtimet, automjetet ose  
16 makinat e MVK-së, a kishin ndonjë shenjë dalluese, a njiheshin  
17 nga dikush që mund t'i shikonte me sy të lirë?

18 PË. Kur MVK-ja mbërriti në Kosovë, në tetor, në mes të  
19 tetorit, në fund të tetorit, të, pra kishin një lloj standard  
20 makine, të bardhë, një Peugeot të bardhë dhe të gjithë e dinin  
21 se me çfarë automjesh ne udhëtonim. Fatkeqësisht ishin të  
22 njëjtat si me automjetet e policisë serbe. Kështu që  
23 verifikuesit tanë fillestarë pra, për shkak të pasjes së  
24 automjeteve të ngjashëm me forcat serbe, filluan që të  
25 qëlloheshin shpesh, dhe për këtë arsye u vendos që të gjitha

1 automjetet të kishin një ngjyrë fluoreshente me ngjyrë  
2 portokalli dhe u lyen të gjitha me ngjyrë portokalli që të  
3 ishin lehtësisht të identifikueshme.  
4 PY. Në këto dy makina që po shkonit në vendin e vizitës, me  
5 këta persona që i identifikuat, dhe thatë që ju zakonisht ju  
6 jepeshin koordinatat dhe verifikoheshit kur shkonit në vend. A  
7 mund të na e përshkruani se si mbërritët në vendin ku do të  
8 ndodhte vizita?

9 PË. Po, zakonisht bëhej punë përgatitore jo domosdoshmërisht  
10 nga ekipi im, por nga ekipi ndërlidhës. Ata merrnin në telefon  
11 paraprakisht, i kujtonin UÇK-së që po shkonim, që ky ishte një  
12 takim për të cilin ishin pajtuar palët, verifikoheshin emrat e  
13 delegacionit, zakonisht jepeshin edhe targat e makinës. Mbase  
14 kjo jepej, këto informacione jepeshin, një orë ose dy orë  
15 përpara se të bëhej vizita.

16 Sikurse e thashë dhe më përpara, zakonisht shkonim me dy  
17 makina. Gjatë periudhave ku bëheshin vizitat, trafiku ishte i  
18 kufizuar në rrugë. Këto ishin vende që kontrolloheshin nga  
19 UÇK-ja, pra UÇK-ja kontrollonte se çfarë ndodhte në zonë dhe  
20 zakonisht kishte një perimetër që siguronte që të mund të  
21 tërhiqeshin në qoftë se do të ishte e nevojshme.

22 Ne ndalonim në pikën e parë të kontrollit të UÇK-së,  
23 jepnim të gjithë informacionin e nevojshëm, të tillë, si për  
24 shembull, emrat, arsyet se pse ishim aty, e të tjerë.

25 Zakonisht personat në pikën e kontrollit bënë një telefonatë

1 në zinxhirin e komandës për të verifikuar nëse informacioni  
2 ishte i saktë apo jo. Zakonisht ata e dinin që ne do shkonim,  
3 kështu që nuk është se ishte çudi apo habi për ta që po  
4 shkonim, por e kishin si për procedurë që të merrnin  
5 informacionin nga zinxhiri i komandës.

6 Pasi kalonim më pas këtë pikën e kontrollit të parë, ne  
7 shkonim tek vendi i komandës, kudo që të ishte zyra e  
8 komandantit. Zakonisht shkonim atje, bënim një bisedë, pinim  
9 një çaj ose një kafe. Diskutonim arsyen se pse ishin atje,  
10 çfarë synimi kishim. Çfarë qëllimi kishim, edhe zakonisht ne  
11 modelin e vizitave tona e kishim të tilla si Kryqi i Kuq  
12 Ndërkombëtar, që kërkonim që të na ofrohej privatësi, që të  
13 ndaluarit të kishin mundësi që të na, që të na jepnin  
14 korrespondencën që ata dëshironin që t'jua dërgonim anëtarëve  
15 të familjes, që dëshironim të bisedonim me ta për shëndetin  
16 dhe për situatën e përgjithshme të tyre apo për shqetësime të  
17 tjera që mund të kishin.

18 Dhe ne më pas dërgoheshim në vendin ku gjendej ky  
19 lokacioni ose vendi i ndalimit, dhe zakonisht vendi i ndalimit  
20 ishte një shtëpi.

21 PY. Përpara sesa të kalojmë tek shtëpia, ju përmendët që  
22 kalonit pikën e parë të kontrollit të UÇK-së. A kishte më  
23 tepër se sa një pikë kontrolli përpara se sa të shkonit në  
24 takimin e parë tuajin me një prej individëve që kishte bërë të  
25 mundur organizimin për vizitën?

1 PË. Zakonisht pra pas, pra, kishte një perimetër sigurie.

2 Duke qenë që kjo ishte qendra e komandës, kështu që ne duhej

3 që të tregonim fletët tona të identifikimit ose kredencialet

4 tona në mënyrë të tillë që të futeshim në shtëpi.

5 PY. Ju na thatë se çfarë historiku keni, por a është e drejtë

6 që të themi që ju nuk keni përvojë ushtarake?

7 PË. Po.

8 PY. Megjithatë, ju keni punuar me shumë persona të cilët

9 kishin përvojë ushtarake apo jo?

10 PË. Unë më përpara kisha pasur pesë vite përvojë në Sarajevë,

11 në Bosnje, ku jam marrë shumë atje me forcën zbatuese atje.

12 Jam marrë gjithashtu edhe me punë për të drejtat e njeriut,

13 edhe me punë zgjedhore. Kështu që, me fjalë të tjera, kishim

14 ca përvojë me forcat e NATO-s. Kështu u mësova, u përshtata me

15 gjuhën, me zhargonin, me sjelljen ushtarake, me pritshmëritë

16 që duhet të kisha unë si koleg i tyre e kështu me radhë.

17 PY. Pra, ju a mund t'i përshkruani Trupit Gjykues se çfarë

18 vinit re juve për sa i takon perimetrin të sigurisë, duke

19 marrë parasysh faktin që ju nuk keni përvojë ushtarake?

20 PË. Për të qenë e drejtë, që prej Kosovës unë jam marrë shumë

21 në konflikte të ndryshme ushtarake, kështu që është e vështirë

22 për mua për të bërë dallimin se çfarë dija në 1998 dhe çfarë

23 di sot. Megjithatë, perimetri ishte i tillë që ti mund të

24 shikoje ushtarët që ata kishin një lloj mbrojtjeje, nuk është

25 se kishin mure mbrojtëse. Megjithatë, mund të kishte për

1 shembull, automjete ose makina në këtë perimetrin e sigurisë  
2 për të ndaluar persona ose automjete të tjera për t'u futur  
3 aty. Ose ndoshta mund të kishte dhe fuçi prej çeliku që mund  
4 të ishin në vende të tilla për të mos lejuar depërtimin e  
5 forcave apo personave të tjerë.

6 Pjesa më e madhe e armëve ishin AK-47 ose, për shembull,  
7 ti mund të shikoje këto pikat e kuqe që e kishin fjalën, e  
8 kishin gishtin në armë dhe ti mund të shikoje për shembull në  
9 qoftë se këto pikat e kuqe, domethënë, në qoftë se do të ishin  
10 në drejtim të tokës ose në drejtim të ndonjërit, ti do të  
11 shikoje, kështu që do ta kuptoje që ky do ishte perimetri i  
12 sigurisë.

13 PY. Domethënë, ishte një rreth i këtyre pikave me lazer,  
14 pikave të kuqe?

15 PË. Po.

16 PY. Pasi kaluat në pikën e kontrollit, në këtë vizitën për të  
17 cilën po flisni, a ju kujtohet që shkuat direkt në shtëpinë e  
18 ndalimit apo nëse patët një takim përpara se të shkonit në  
19 shtëpinë e ndalimit?

20 PË. Mendoj që së pari ndalua në shtëpinë e komandantit, se  
21 besoj që ky ka qenë protokolli i zakonshëm. Dhe siç e thashë  
22 dhe më përpara, thashë që zakonisht ne thonim se cila ishte  
23 qëllimi, cili ishte qëllimi i vizitës, çfarë pritshmërie  
24 kishim, dhe pastaj kalonim dhe shkonim në një tjetër fshat.

25 PY. A ju kujtohet dita e këtij takimi në shkurt të vitit

1 1999, dita, data e saktë?

2 PË. Jo.

3 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Do t'i kërkoj Gjykatës që të  
4 vendosin në ekran provën me numër P00116. Nuk ka version në  
5 shqip të këtij dokumenti.

6 PY. Nëse shikoni tani në ekranin që keni përpara, në pjesën e  
7 sipërme të dokumentit --

8 Z. KEHOE: [Përkthim] Kërkoj ndjesë që po ju ndërpres,  
9 mendoj që ky është dokumenti me numër 1D7, ndoshta? Kemi një  
10 numër të dyfishtë?

11 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Mendoj që është një dokument  
12 tjetër ky që po thoni ju, z. Kehoe, dhe atë do t'ia tregoj  
13 dëshmitares.

14 Z. KEHOE: [Përkthim] Më falni atëherë që ju ndërpreva.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

16 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nëse mund ta zmadhojmë pjesën e  
17 sipërme të dokumentit, në mënyrë që dëshmitarja ta ketë më të  
18 lehtë për ta lexuar.

19 PY. Së pari, ky është një dokument i OSBE-së i njësisë për të  
20 drejtat e njeriut, kështu?

21 PË. Po.

22 PY. E shikoni nga titulli se është procesverbali i një takimi  
23 të datës 18 shkurt 1999 me komandantin e zonës dhe shefin e  
24 policisë ushtarake të UÇK-së në Llapashticë, në lidhje me  
25 vizitat në objektet e ndalimit. Mund ta lexoni paragrafin e

1 parë për ta rifreskuar kujtesën lidhur me takimin. A është ky  
2 takimi për të cilin po flisni?

3 PË. Po. Ka dy data. Njëra datë është 25 shkurt 2016. Në atë  
4 kohë përdornim datat automatike kalendarike, por e di që, me  
5 sa më kujtohet, takimi vetë u mbajt më datën 18 shkurt 1999.

6 PY. Faleminderit për sqarimin. Ky lloj dokumenti, a shkruhej,  
7 përpilohej në të njëjtën kohë kur bëhej dhe ngjarja, takimi në  
8 këtë rast?

9 PË. Merreshin në kohën e takimit shënime dhe pastaj, atë natë  
10 kur ktheheshin në shtëpi apo në zyrë, apo të nesërmen,  
11 përpilohej raporti.

12 PY. Në dokument thuhet se të pranishëm jeni ju dhe zëvendësja  
13 juaj. Gjithashtu përmendet komandanti i zonës "Remi", dhe  
14 shefi i policisë ushtarake "Fati", ku janë emrat e shënum me  
15 thonjëza. A ju kujtohen këta individë?

16 PË. Më kujtohen në bazë të këtij dokumenti, por kështu nuk do  
17 t'i kisha të njohur.

18 PY. A mund të na thoni diçka se çfarë ju kujtohet në lidhje  
19 me këta dy persona nga ky takim?

20 PË. Më kujtohet që Remi ishte emri i një komandanti zone. Ne  
21 kur kishim takimet me njerëz dëgjonim ata duke iu referuar  
22 komandantëve me nofkat e tyre, jo domosdoshmërisht me emrat e  
23 tyre të vërtetë. Mendoj që emrin Remi e kisha dëgjuar shpesh  
24 sepse kishte disa çështje në zonën e Podujevës.

25 PY. Po Fati?

1 PË. Më pak kam dëgjuar këtë emër.

2 PY. Nëse ju kujtohet, a ishte kjo e vetmja herë që keni pasë  
3 takim me Fatin apo thjesht nuk ju kujtohet emri?

4 PË. Jo, me të vërtetë nuk më kujtohet.

5 PY. Në lidhje me këto takime, dhe në qoftë se mund të shkojmë  
6 pak më poshtë në dokument, ku është edhe përmbledhja, a ju  
7 kujtohet biseda se çfarë diskutuat me komandantin e zonës  
8 Remin, dhe me shefin e policisë ushtarake, Fatin, kur shkuat  
9 në këtë takim?

10 PË. Sigurisht që kemi diskutuar procesin, procedurën për t'u  
11 kuptuar se çfarë autoritetesh ishin në funksion. Ky ishte një  
12 organizim i tyre që administronte atë vend. Thjesht u përpoqëm  
13 që të kuptonim në qoftë se kishin ligje që i ndiqnin, në qoftë  
14 se kishin Gjykatës, në qoftë se të ndaluarit gëzonin të drejta  
15 të caktuara, si kujdeseshin për të ndaluarit, se çfarë planesh  
16 kishin me të ndaluarit. Domethënë diskutime të përgjithshme në  
17 lidhje me ata të ndaluar. Domethënë biseda kufizohej brenda  
18 këtyre temave.

19 PY. Po qëllimi kryesor i këtyre takimeve a ishte për të pasur  
20 qasje tek të ndaluarit apo edhe për të biseduar me komandantët  
21 e zonave të UÇK-së apo udhëheqjen vendore?

22 PË. Objektiva kryesore ishte që të kishim qasje tek të  
23 ndaluarit.

24 PY. Dhe pas takimit që dokumentohet në këtë raport me  
25 komandantin e zonës dhe me shefin e policisë ushtarake, a u

1 miratua leje për të vizituar të ndaluarit?

2 PË. Po.

3 PY. Përpara se ta heqim dokumentin, është diku nga kreu i  
4 faqes, paragrafi që fillon me fjalët "gjatë takimit të parë".

5 Diku në mes të atij paragrafi përmendet një shkurtesë "ZC", a  
6 është kjo shkurtesë për "komandant zone"?

7 PË. Po.

8 PY. Dhe vazhdon citimi "Komandant i zonës na informoi se do  
9 të kishim qasje tek të ndaluarit, të gjithë shqiptarë, që  
10 mbaheshin për vjedhje, plaçkitje, dhe për 'bashkëpunim me  
11 armikun'."

12 A mund të na shpjegoni se si e kuptonit ju këtë  
13 "bashkëpunim" me forcat e armikut, në bazë të këtij citimi?

14 Z. KEHOE: [Përkthim] A mund të na japë bazën për këtë  
15 pyetje?

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të  
17 përgjigjeni. Rrëzohet kundërshtimi.

18 DËSHMITARJA: [Përkthim] Brenda citimit "bashkëpunim"  
19 ishte një term që përdorej gjerësisht. Mund të kishte kuptimin  
20 e një shqiptari që kishte pirë një birrë me një serb, mund të  
21 kishte kuptimin e personi që kishte shkuar në stacion të  
22 policisë të Serbisë për të pyetur lidhur me vendndodhjen e  
23 ndonjë personi apo për të raportuar një krim.

24 Pra, kuptimi i këtij termi ishte shumë i gjerë dhe  
25 përfshinte çdo kontakt ndëretnik midis shqiptarëve dhe

1 serbëve, veçanërisht nëse serbët perceptoheshin se ishin pjesë  
2 e policisë apo të forcave të ushtrisë. Ishte e njëjta gjë edhe  
3 nga ana e MUP-it. Sa për analogji, ata çdo shqiptar e shikonin  
4 si terrorist, për çdo krim dhe çdo krim e quanin terrorizëm.  
5 Unë për mendimin tim, mendoj që kuptimin e ngushtë  
6 bashkëpunimi do të thotë punë dorë për dorë e afërt për të  
7 arritë një objektiv të njëjtë.

8 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

9 PY. Pasi iu miratua qasje tek këta tetë të ndaluar, a mbetët  
10 në atë zyrë apo shkuat në ndonjë vend tjetër?

11 PË. Mendoj që shkuam në një vend tjetër.

12 PY. A mund t'ju përshkruani Trupit Gjykues se çfarë ju  
13 kujtohet në lidhje me atë vend tjetër? Domethënë pasi  
14 mbërritët aty. A mund të na e përshkruani?

15 PË. Më kujtohet që ishte një shtëpi më vete, e izoluar,  
16 domethënë nuk ishte ngjitur me ndonjë shtëpi tjetër. Ecëm, u  
17 ngjitëm shkallëve, u futëm në një farë korridori. Dhe dikund  
18 nga ana e majtë mendoj që ishte zyra e komandantit, ishte një  
19 dhomë e ndenjes, por përdorej si zyrë e komandantit.

20 PY. Thatë që ishte errët. Sa mund të shihnit nga ai vend ku  
21 ishit?

22 PË. Po zakonisht përsëri ishin ushtarë që e ruanin atë  
23 vendin, bënë roje, nuk kishte vetura që qarkullonin rreth  
24 atij vendi, e di që ishte shumë qetë, ishte natë e ftohtë dhe  
25 kishte lagështi. Kjo më kujtohet për sa i përket ambientit.

1 PY. A ju shoqërunë gjatë vizitës ndërlidhësit e UÇK-së që  
2 ishin me ju?

3 PË. Jo.

4 PY. Domethënë ju çuan te kjo dhomë. Kur arritët aty, a ju  
5 çuan brenda në shtëpi për të parë shtëpinë?

6 PË. Jo, hymë brenda. Duket që ishte shtëpi, kishte shkallë  
7 dhe kishte korridore të vogla.

8 PY. Dhe përveç kësaj dhome, a ju çuan dhe në ndonjë dhomë  
9 tjetër?

10 PË. Jo, nuk më kujtohet ajo.

11 PY. Dhe si ndodhi që u takuat me këta tetë të ndaluar?

12 PË. Procedura ishte kjo, uleshim, pritnim, hapej dera, dhe  
13 ushtari e sillte një të paraburgosur dhe ai pastaj ulej në një  
14 karrige përballë nesh. Ne do uleshim në divan. Dhe pastaj  
15 ushtari dilte prej dhome.

16 PY. A jeni takuar me më shumë të paraburgosur gjatë të  
17 njëjtës kohë?

18 PË. Me sa më kujtohet i kemi takuar një nga një.

19 PY. Dhe kur i sillni në dhomë, a ishin të lidhur në ndonjë  
20 farë mënyre?

21 PË. Nuk më kujtohet se ishin të lidhur në ndonjë mënyrë kur i  
22 sillnin në dhomë.

23 PY. A ju kujtohet që nëse gjatë kësaj vizite keni parë të  
24 ndaluar apo të themi nëpër korridoret apo këto dhoma që i keni  
25 pa ndonjë të ndaluar që mund të ketë qenë i lidhur?

1 PË. Më kujtohet që kam parë një person me diçka në kokë. Me  
2 fytyrën e mbuluar me diçka.

3 PY. Dhe çfarë ndodhi pasi i sillnin në dhomë të ndaluarit? A  
4 bisedonit me atë në qoftë se patët mundësi për të biseduar?

5 PË. Më la përshtypje se sa të sjellshëm ishin të ndaluarit.  
6 Ishin mjaft të tërhequr, disi, sikur me frikë. Ishin të veshur  
7 me veshje civile, ishin fshatarë të thjeshtë. Nuk më kujtohet  
8 të kem parë dikënd që dukej pak ma ndryshe se të tjerët. Dhe  
9 më kujtohet që iu përgjigjën të gjitha pyetjeve që kishim. Nuk  
10 patën ankesa, dhe nuk na dhanë kurrfarë porosish për familjet  
11 e tyre.

12 PY. Dhe si ju la përshtypje kjo që nuk kishin mesazhe për  
13 familjet e tyre?

14 PË. Ne menduam që ndoshta dikush i kishte instruktuar, ju  
15 kishte treguar se si duhej të silleshin me ne.

16 PY. Ju gjithashtu përmendët që në KVM vinin njerëz për t'u  
17 ankuar, anëtarë të familjeve që kërkonin anëtarët e zhdukur të  
18 familjeve të tyre, apo të ndaluar?

19 PË. Disa nga të ndaluarit na treguan se anëtarët e familjeve  
20 të tyre e dinin se ku ndodheshin, se familjet e tyre ishin  
21 informuar nga UÇK-ja e atij fshati për faktin që ndodheshin  
22 aty dhe ndoshta njerëzit në fshat e dinin familjen konkrete që  
23 ishte pjesë e këtij procesi.

24 PY. Na thatë që i patët këto biseda, këto biseda u kryen  
25 nëpërmjet ndonjë përkthyesi?

1 PË. Po. Mendoj që të vetmit që flisnin anglisht në atë kohë  
2 ishin të rinjtë që e kishin mësuar gjuhën nga televizori, nga  
3 filmat. Por takoheshim edhe me të rritur nëpër fshatra të  
4 cilët nuk flisnin shumë mirë në anglisht, nuk mund të  
5 zhvillonin një bisedë në anglisht.

6 PY. Na thatë që u përgjigjën të gjitha pyetjet që u bëtë, dhe  
7 se kishit përshtypjen që ishin disi përputhës në përgjigjet e  
8 tyre, a është kështu?

9 PË. Po.

10 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Të vendosim në ekran 1D00007. Ky  
11 dokument ka edhe versionin në shqip.

12 PY. Shikojeni këtë dokument, është pranuar si provë me numrin  
13 1D00007, në krye të dokumentit kemi shenjën e OSBE-së, MVK-së,  
14 Njësia për të Drejtat e Njeriut, dhe kemi datën e njëjtë, 18  
15 shkurt 1999, është domethënë e njëjta datë që na përshkruat.

16 Dhe këtu, në fillim të dokumentit përshkruhet mënyra se  
17 si janë kryer intervistat dhe pastaj paraqitet informacion  
18 shtesë. Lexoni këtë pjesë dhe unë do t'ju bëj disa pyetje në  
19 lidhje me këtë.

20 A i shikoni këto emrat në numrat 1, 2, 3, dhe pastaj ndër  
21 ato emra jepen përshkrime, a janë këto shënime nga bisedat  
22 individuale që keni pasë me këta të ndaluar?

23 PË. Po, e saktë.

24 PY. Dhe për shembull tek numri 2, thuhet se personi kishte  
25 marrë një "s" nga UÇK-ja dhe se akuzohet për bashkëpunim me

1 armikun. Fjalja e parë thuhet se është "kishte ardhë vetë në  
2 Llapashticë, mbasi kishte marrë një 's' prej UÇK-së".

3 Desha t'ju pyes në qoftë se ishit në dijeni apo kishit  
4 informacion nëse persona merrnin ndonjë farë njoftimi apo  
5 ndonjë farë raporti? A keni dijeni për situata të tilla?

6 PË. Mendoj që merrnin një farë si thirrje që thirrej në një  
7 autoritet të zgjedhur, përzgjedhur.

8 PY. Dhe më pas thuhet:

9 "Akuzohet për bashkëpunim me armikun".

10 A ishte kjo baza për ndalimin e këtij personi me sa ju  
11 kujtohet nga takimi?

12 PË. Po.

13 PY. Kur këta individë të ndaluar u sollën aty për t'u takuar  
14 me ju, a ju kujtohet diçka në lidhje me mënyrën si dukeshin  
15 fizikisht përveç sjelljes që na e përshkrutë? A patë shenja të  
16 ndonjë keqtrajtimit, të dukshme?

17 PË. Në qoftë se kemi pa shenja të tilla, kjo sigurisht që do  
18 shikohej në raport në qoftë se, për shembull, dikush kiponte  
19 ose kishte shenja gjaku apo mavijosje, kjo do të shënohej në  
20 dokument. Ishte siç ju thashë mjaft ftohtë, dhe të gjithë  
21 ishin me pallto, të veshur trashë.

22 PY. Dhe ju nuk mund të shikonit se çfarë kishin brenda në  
23 trup?

24 PË. Po, ashtu është.

25 PY. Për këto vizita, a lajmërohej paraprakisht UÇK-ja?

1 PË. Po.

2 PY. A vendoste UÇK-ja se me cilin do të takoheshit apo ju i  
3 përzgjidhnit vetë të ndaluarit që do t'i takonit?

4 PË. Ne nuk kishim dijeni se me cilin do të takoheshim.

5 PY. Ju nuk kishit dijeni në qoftë se u takutë me të gjithë të  
6 ndaluarit aty, apo vetëm me një pjesë të tyre? A është kështu?

7 PË. Po.

8 PY. Dhe a e dini se sa anëtarë të UÇK-së apo ushtarë ishin,  
9 apo njerëz të tjerë, ishin aty në vend, ju dhanë informacion?

10 PË. Jo.

11 PY. A e dini, apo keni ndonjë mendim në lidhje me atë nëse  
12 UÇK-ja do të sillte që ju t'i takonit edhe njerëz me lëndime  
13 të dukshme në trup?

14 Z. KEHOE: [Përkthim] Kundërshtim, është sugjestionuese  
15 pyetja.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet  
17 kundërshtimi.

18 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

19 PY. A ju solli UÇK-ja dikënd që kishte lëndime të dukshme?

20 PË. Jo.

21 PY. Pas këtyre takimeve -- më falni, a ju kujtohet se sa  
22 zgjasnin këto takime individuale me të ndaluarit?

23 PË. Jo shumë. Dikund rreth 20 minuta.

24 PY. A ju treguan se ku flinin këta apo ku hanin këta të  
25 ndaluar, a ju tregunë ato vende?

1 PË. Jo.

2 PY. Dhe nga ky dokument, raport që kemi në ekran, duket se të  
3 ndaluarit që i takuat kishin me ditë e deri në muaj që  
4 qëndronin në atë vend, dikund deri në katër muaj. A ju tregoi  
5 UÇK-ja apo ju dha ndonjë indikacion se kur do t'i lironte këta  
6 të ndaluarit?

7 PË. Jo.

8 PY. Në kuadër të vizitave dhe diskutimeve, bisedave me UÇK-  
9 në, a ju është dhënë ndonjë indikacion në lidhje me ndonjë  
10 proces kundër këtyre, apo akuze, kundër këtyre të ndaluarve?

11 PË. Mendoj që po. Në takimin me komandantin apo me shefin e  
12 policisë, nuk më kujtohet se me cilin, ata përshkruanin  
13 procesin që i ngjante shumë procesit jugosllav në atë kohë.  
14 Domethënë, pritej njëherë për një gjykatës hetues. Përmendën  
15 që ka njëfarë kodi të drejtësisë, njëfarë kodi ushtarak që po  
16 e përdornin.

17 Ne kërkonim që të kishim kopje të kodeve të tilla,  
18 ligjeve të tilla, dhe mendoj që nuk na u dha një kopje.

19 PY. A ju kujtohet të ju jetë treguar ndonjë shembull i ndonjë  
20 akuze apo njëfarë dosje lidhur me ndonjë prej këtyre të  
21 akuzuarve?

22 PË. Më kujtohet që i kam pa -- nuk më kujtohet që kam pa  
23 dosje [Sipas përkthimit]. UÇK-ja u përpoq që të na tregonte se  
24 kishte njëfarë procesi që ndiqej. Na treguan dosjet. Më  
25 kujtohet që ju ngjanin dosjeve që i kishim parë edhe në

1 stacionet e policisë.

2 Unë vetë nuk e flas shqipen, kështu që nuk e kam kuptu  
3 përmbajtjen e tyre. Por, thjesht për nga dukja këto dosje  
4 përmbanin fletë-thirrje, shenja të gishtave, dhe dokumente të  
5 tjera, kështu që do ta kisha quaj të dosje.

6 PY. Po a u përmend sistemi i drejtësisë, apo gjykimi në  
7 lidhje me këta individë?

8 PË. Po.

9 PY. Dhe çfarë ju tha UÇK-ja lidhur me këtë?

10 Z. KEHOE: [Përkthim] A mund të na jepet baza për këtë  
11 lloj pyetje?

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po,  
13 Prokurore, ju lutem pyeteni dëshmitaren se kush ia dha këtë  
14 informacion?

15 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës.

16 PY. Dëshmitare, gjatë takimeve me komandantin e zonës dhe me  
17 shefin e policisë ushtarake dhe pasi ju treguan këto dosje, a  
18 ua përshkruajti UÇK-ja sistemin e drejtësisë që ishte në  
19 funksion?

20 Z. KEHOE: [Përkthim] Kush prej UÇK-së? Nuk duhet të jepet  
21 një pyetje e përgjithshme.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,  
23 pyeteni dëshmitaren më konkretisht.

24 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

25 PY. A ju kujtohet konkretisht në qoftë se komandanti i zonës,

1 në këtë rast komandant Remi dhe Fati, shefi i policisë  
2 ushtarake, a ju përmendi një gjë të tillë gjatë këtij takimi?  
3 PË. Unë mendoj që gjatë takimit me Remin dhe Fatin u përmend,  
4 dhe kjo është shënuar në dokumentin që ma keni treguar, ne u  
5 përpoqëm që të merrnim vesh, merrnim më shumë informacion në  
6 lidhje me këtë proces, dhe ata përmendën që po prisnin  
7 gjykatësin.

8 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Mund ta vendosim përsëri këtë  
9 dokument në ekran me leje të Gjykatës, është numri P00116.

10 DËSHMITARJA: [Përkthim] Po, ky është dokumenti që e  
11 përmenda.

12 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

13 PY. Shkoni tek paragrafi i dytë që fillon "gjatë takimit të  
14 parë..." dhe thuhet:

15 "Komandanti i zonës nuk ishte shumë i informuar për  
16 hollësitë e procedurës ligjore..."

17 Dhe pastaj është shkurtesa "MPC". A është kjo për shefin  
18 e policisë ushtarake?

19 PË. Po.

20 PY. Dhe në fund të faqes së parë thuhet, se keni shkuar tek  
21 zyra e shefit të policisë ushtarake dhe aty keni shënuar  
22 informacion në lidhje me shpjegimin që jua ka dhënë Fati në  
23 lidhje me autoritetin e UÇK-së, rregulloren ushtarake të UÇK-  
24 së dhe të drejtën e UÇK-së për t'i mbajtur njerëzit në ndalim  
25 deri, në pritje të gjykimit?

1 PË. Po.

2 PY. Dhe ju kërkuat që t'ju jepnin një kopje të këtij kodi  
3 ushtarak, apo jo? A ju dhanë?

4 PË. Jo.

5 PY. Ju thatë që një nga të ndaluarit është mbajtur për katër  
6 muaj, kështu që i bie më shumë se dy a tri muajt që ju kishin  
7 thënë zakonisht?

8 PË. Po.

9 PY. Kur takoheshit me këta persona të ndaluar, ju keni  
10 përshkruar ekipin tuaj, stafin tuaj, a e kishit ndonjë tjetër  
11 nga ekipi juaj në dhomë me ta, apo ishte ti vetëm, znj.  
12 Ringgaard, shoferi, përkthyesi?

13 PË. Zakonisht, përgjigjesha unë, Susanne, një përkthyes. Ne  
14 zakonisht prisnim jashtë, nuk mbaj mend të kem qenë ndonjëherë  
15 brenda.

16 PY. Po sa i takon UÇK-së, pikë së pari njëherë, a deshët ju  
17 të takoheshit privatisht me këta të ndaluar?

18 PË. Po, po. Deshëm të takoheshim privatisht që të flisnin  
19 lirshëm. Se nuk mund të flasësh lirisht kur është i pranishëm  
20 dhe personi që të mban në dhomë.

21 PY. A ju lejohej të takoheshit me ata në një ambient që mund  
22 t'ju thuhej që ishte privat?

23 PË. Jo, jo. Ndonjëherë vinin, sillnin një çaj, merrnin dosje.

24 PY. Pra, kishte momente që ishit vetëm në dhomë, ama s'mund  
25 të ishit të sigurt që s'do të hynte dikush dhe askush nuk ju

1 paralajmëronte kur hynte dikush.

2 Z. KEHOE: [Përkthim] Kundërshtoj. Është sugjestionuese.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.

4 Vazhdoni.

5 DËSHMITARJA: [Përkthim] Po, korrekt.

6 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

7 PY. Pasi takoheshit me këta të ndaluar individualisht, ju  
8 kujtohet si ishte situata kur largoheshit? Më pas takoheshit  
9 edhe një herë me komandantin e zonës apo shefin e policisë  
10 ushtarake, apo takimi juaj përfundonte me të ndaluarin?

11 PË. Mund t'ju jepnim dorën mbase kur largoheshim, por nuk  
12 mbanim, nuk bënim ndonjë takim pas këtyre takimeve me të  
13 ndaluarit. Nuk më kujtohet diçka e tillë.

14 PY. Tani, kur jeni ulur këtu, nuk ju kujtohen detajet  
15 konkrete të këtyre vizitave të tjera që ju përmendët? Ose, a  
16 ju kujtohet a përputheshin zakonisht këto vizitat me ato që na  
17 përshkruat, me 18 shkurtin e 1999?

18 Z. KEHOE: [Përkthim] E kundërshtoj, dëshmitarja tha që  
19 nuk i kujtohet.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

21 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

22 PY. Mirë, po e riformuloj pyetjen ndryshe. A ju kujtohet  
23 natyra e përgjithshme e vizitave të tjera që thoni se keni  
24 bërë në muajt janar dhe shkurt të 1999 në objektet e ndalimit  
25 të UÇK-së?

1 PË. Nuk më kujtohet të kem pasë ndonjë vizitë shumë të  
2 ndryshme nga ajo që përmenda. Asgjë e jashtëzakonshme.  
3 Asnjëherë nuk kemi hyrë brenda ambientit të burgut. Këto ishin  
4 në fshatra.

5 PY. E kuptoj. Pasi bënit takimin, pasi bëtë takimin me  
6 komandantin e zonës më 18 shkurt, me Remin, pra, dhe me shefin  
7 e policisë ushtarake, Fatin, a ka pasur momente të tjera pas  
8 kësaj periudhe kohore, pra fokusohem në periudhën mes janarit  
9 dhe marsit të 1999, pra a ka ndodhur që të keni biseduar me  
10 autoritetet e UÇK-së sa i takon ndalimit të personave?

11 PË. Nuk më kujtohet konkretisht, por mund ta them që ishte  
12 praktikë që kur isha personalisht e përfshirë në takime me  
13 UÇK-në përpara evakuimit, zakonisht kjo bëhej në prani të  
14 drejtorëve të tjerë rajonalë. Unë fokusohesha në aspektin e të  
15 drejtave të njeriut ku përfshihej edhe ndalimi. Unë  
16 këmbëngulja për këtë kodin e luftës, kodin ushtarak të  
17 sjelljes, edhe doja që të më jepnin informacione dhe të më  
18 garantonin që po ndiqnin një proces të rregullt ligjor.

19 PY. Sa i takon këtij procesi të rregullt ligjor, ju thatë pak  
20 më herët se ju mbikëqyrnit gjykimet që kryenin autoritetet  
21 serbe. A patët ndonjëherë qasje të ngjashme për të vëzhguar  
22 gjykimet e kryera prej autoriteteve të UÇK-së?

23 PË. Jo.

24 PY. Po a kërkuat që të kishit ndonjëherë qasje?

25 PË. Pa dyshim.

1 PY. A e dini a ka pasë ndonjëherë gjykime të tilla?

2 PË. Jo, me sa kam unë dijeni. Unë nuk kam dijeni të jenë  
3 mbajtur ndonjë gjykim konkret.

4 PY. Fakti që nuk kryheshin gjykime, a përputhet me atë që ju  
5 tha Fati, në takimin që keni pasë me të?

6 PË. Jo. Ata thanë se po bënin, po mbanin gjykime. Por "ne",  
7 pra unë, ekipi im, MVK-ja, asnjëherë nuk pamë ndonjë raport ku  
8 të thuhej që dikush i MVK-së ka qenë i pranishëm në ndonjë  
9 gjykim.

10 PY. A jeni takuar ndonjëherë me komandantë të tjerë të  
11 zonave, a keni takuar ndonjë komandat tjetër zone që të  
12 kujtohet me emër?

13 PË. Më kujtohet që kam takuar Ramushin në zonën e Prizrenit.

14 PY. A ju kujtohet mbiemri i Ramushit?

15 PË. Ramush Haradinaj. Ju kërkoj ndjesë se ndoshta nuk e  
16 shqiptova siç duhet.

17 PY. A ju kujtohet ndonjë komandant tjetër zone? Apo komandant  
18 tjetër i UÇK-së edhe pse mos të ketë qenë komandant zone, por  
19 ndonjë person nga UÇK-ja që ju kujtohet ta keni takuar?

20 PË. Jo, jo. asnjë konkret.

21 PY. A ju kujtohet, a keni takuar ndonjë që njihej si  
22 komandant Drini?

23 PË. Ah po, këtë emër e njoh.

24 PY. Sipas jush çfarë pozite kishte komandant Drini, si e  
25 kishit kuptuar?

1 PË. Besoj se Drini ishte një nga komandantët e zonës. Më  
2 duket se kanë qenë shtatë a tetë komandantë zone në atë kohë  
3 me të cilët komunikonte MVK-ja dhe zonat ishin të ndara në  
4 mënyrë gjeografike.

5 PY. Kur thoni në atë periudhë specifike, për kë periudhë e  
6 keni fjalën?

7 PË. E kam fjalën për periudhën e mes dhjetorit apo fundi i  
8 dhjetorit, deri në momentin e evakuimit në mars, në mes të  
9 marsit.

10 PY. Pra, dhjetori 1998 dhe marsi i 1999?

11 PË. Po, korrekt.

12 PY. Në këtë periudhë kohore, a ju kujtohet të keni biseduar  
13 me ndonjë nga këta komandantët që sapo përmendëm, qoftë ky  
14 Ramush Haradinaj, komandant Drini, apo ndonjë bisedë të  
15 mëtutjeshme me komandant Remin lidhur me ndalimin e individëve  
16 dhe trajtimin e këtyre individëve nga ana e UÇK-së?

17 PË. Nëse bëhej ndonjë takim konkret, ne zakonisht mbanim  
18 shënime për këto takime, kështu që nuk më kujtohet ndonjë  
19 takim konkret siç e krahasoj tani me këtë takim që përmenda  
20 më herët në këtë vizitën në këtë ambientin e ndalimit.

21 PY. A ju kujtohet që keni dhënë një deklaratë të mëhershme  
22 kur keni dhënë me hollësi, ku keni dhënë hollësi, diskutimin  
23 që keni pasë me komandantët e zonës për të drejtat e njeriut?

24 PË. Më kujtohet që kam folë me z. Ramush për çështjet e të  
25 drejtave të njeriut. Prizreni ka qenë një zonë tepër, tepër

1 aktive, shefi i zyrës rajonale në Prizren ishte një gjeneral  
2 brigadier kanadez me fokus në të drejtat e njeriut, dhe kishte  
3 marrëdhënie shumë të mira pune me Ramushin. Besoj që emri i  
4 tij do të dalë më shpesh se emrat e tjerë.

5 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] A mund të na jepni një periudhë  
6 më konkrete për këtë? E di që thatë dhjetor deri në mars, por  
7 na jepni diçka më konkrete brenda kësaj periudhe se do të  
8 ishte shumë e dobishme për ne.

9 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

10 PY. A mund ta jepni një periudhë më konkrete brenda periudhës  
11 së dhjetorit dhe marsit të 1999?

12 PË. Për Ramushin, biseda ka filluar menjëherë me Ramushin, sa  
13 u takon të ndaluarve, edhe të zhdukurve, për shkak të  
14 Rahovecit, dhe atë që ndodhi në Rahovec në verën e 1998. Më  
15 pas u bë një shkëputje katër pesë javë për shkak të pushimeve,  
16 më pak raportim bëhej gjatë kësaj periudhe, se kishte më pak  
17 punonjës në terren dhe pastaj e rifillonim punën edhe një herë  
18 në fillim të janarit deri nga gjysma e parë e marsit, në vijim  
19 të dështimit të marrëveshjes së Rambujesë.

20 Misioni u fokusua në çështje më të mëdha gjeopolitike që  
21 po ndodhnin në ato -- kështu që, nëse do të më duhet të jap  
22 një periudhë më konkrete, do mbaj mend që ka qenë në Reçak dhe  
23 mbas mars, 15 mars 1998.

24 PY. Pra, i bie të ketë qenë janari dhe marsi i 1999?

25 PË. Po, ju kërktoj ndjesë, në vitin 1999. Por kishte diskutime

1 në vazhdimësi, sidomos në zonën e Prizrenit, sidomos me hyrjen  
2 e MVK-së në zonë, sepse numër i personave të zhdukur për shkak  
3 të konfliktit të vitit 1998 para MVK-së ishte i  
4 konsiderueshëm.

5 PY. Të fokusohemi në këto bisedat që keni pasur. A ju  
6 kujtohet që ju personalisht të keni shprehur shqetësime lidhur  
7 me faktin që UÇK mbante të ndaluar persona?

8 PË. Sa herë që na jepej shansi me Ramushin dhe me komandantët  
9 e zonave, i ngrija, i trajtoja këto probleme. Sidomos me  
10 Ramushin në zonën e Prizrenit. Përpara janarit, pas janarit,  
11 pas Reçakut. Fokusi ishte çështja e të ndaluarve për  
12 ambasadorin Walker, më pas për çdo komandant zone trajtoja,  
13 por nuk më kujtohen hollësitë tani.

14 PY. E kuptoj që nuk ju kujtohen datat apo periudha konkrete  
15 të këtyre bisedave, por kur ju i paraqisnit këto shqetësime,  
16 çfarë përgjigjesh merrnit për pretendimet, lidhur me  
17 pretendimin e ndalimit dhe të keqtrajtimit?

18 Z. KEHOE: [Përkthim] Me gjithë respektin, me kë? Me kë,  
19 për kë bëhet fjalë? Përgjigjet vinin nga kush, me kë janë  
20 mbajtë këto biseda?

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,  
22 përpiquni të identifikoni personat për kë po flet dëshmitarja.

23 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Patjetër. Unë besoj se ajo ka  
24 identifikuar Ramushin deri tani, dhe ka dhënë dhe një periudhë  
25 konkrete dymujore.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kur flet për  
2 një rast, ju lutem, merrni edhe emrin.

3 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Në rregull.

4 PY. A mund të na thoni, sidomos me Ramushin për shembull, kur  
5 trajtonit këtë në periudhën e janarit deri në marsin e 1999, a  
6 ju kujtohet të keni shprehur fillimisht shqetësime për  
7 çështjet e të drejtave të njeriut, e më gjegjësisht për  
8 ndalimin e personave nga ana e UÇK-së?

9 PË. Mes janarit dhe marsit të 1999, kam marrë pjesë në takime  
10 me Ramushin. Ka të ngjarë që këto të jenë bërë në praninë e  
11 Michel Maisonneuve, që ka qenë gjeneral brigadier i MVK-së  
12 përgjegjës për zonën e Prizrenit. Gjenerali Maisonneuve ishte  
13 shumë i përfshirë në çështjet e të drejtave të njeriut, dhe në  
14 takimet me Ramushin e gjente mundësinë që të ngriheshin  
15 shqetësime të tilla dhe unë i ngrija shqetësimin për këto  
16 objektet e ndalimit. Nëse kishim një person konkret, mund t'i  
17 kem dhënë edhe emrin e personit, në varësi të familjes, nuk  
18 ishte e pazakontë të ndodhte diçka e tillë.

19 PY. Në takimet me Ramushin, si përgjigjej ai kur e ngrinit  
20 këtë problem?

21 PË. UÇK-ja nuk e mohonte faktin që kishte ambiente ndalimi.  
22 Këtë e shihnin si përgjegjësi të tyre, si rol i policisë në  
23 zonat ku autoritetet serbe nuk mund të hynin, nuk mund të  
24 futeshin, në mënyrë që të siguronin rendin publik për  
25 popullatën vendase. Pra, e pranonin faktin që kishin ambiente

1 ndalimi për kriminelët dhe sikurse ju thashë edhe për  
2 kolaboracionistët.  
3 PY. Dhe, ju kujtohet çfarë përgjigje ju ka dhënë ai, ndonëse  
4 nuk e ka mohuar faktin që ekzistonin ambientet e ndalimit? Por  
5 a ju kujtohet të jetë diskutuar çështja e rrëmbimeve apo  
6 persona, fakti që persona nga UÇK-ja merrni persona dhe më pas  
7 këta persona dhe mund të zhdukeshin?  
8 PË. Me e përdorë këtë gjuhë me UÇK-në nuk ishte e thjeshtë,  
9 kështu që ne e shmangnim këtë lloj gjuhe me ta. Kjo ishte një  
10 gjuhë që përdorej nga popullata për autoritetet serbe. Ne  
11 ishim tepër të kujdesshëm që të mos e akuzonim UÇK-në për të  
12 njëjtat gjëra duke përdorur të njëjtat formulime.

13 Sa u takon personave të zhdukur sigurisht që është  
14 trajtuar si çështje. Besoj se përgjigjet që kemi marrë nga  
15 Ramushi përputhen me këtë që thashë, jo ka një proces të  
16 rregullt ligjor. Ishte shumë e rëndësishme që UÇK-ja të shihej  
17 si një organizatë që sipas tyre në atë që ata e konceptonin si  
18 e drejta ndërkombëtare dhe që kishte procese për të ndaluarit.

19 Dhe Ramushi ka përshkruar këtë proces që është shumë i  
20 ngjashëm me këtë që është reflektuar dhe në këtë shënim.

21 PY. A ju kujtohet të jeni takuar me ndonjë person me emrin  
22 Shukri Buja?

23 PË. Më thotë diçka ky emër, është i njohur.

24 PY. A ju kujtohet ta keni takuar ndonjëherë këtë person?

25 PË. Jo, nuk më kujtohet.

1 PY. A keni dhënë në një deklaratë të mëparshme ku edhe e keni  
2 përshkruar një takim me këtë person dhe nëse e shikoni këtë do  
3 ju ndihmojë të kujtoheni?

4 PË. Patjetër.

5 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Atëherë, lutem që të shfaqet në  
6 ekran 076826, deri në 076840, në versionin e gjuhës angleze.  
7 Me të njëjtat numra, por me AT në fund, është edhe shqipja.  
8 Dhe më konkretisht të shkojmë te faqja 076830, paragrafi 16.

9 PY. Ju lutem shihni dokumentin, shiheni të gjithë faqen, por  
10 fillojmë me paragrafin 14, këtu flitet për takimet që keni  
11 pasur, dhe përfundoni me paragrafin 16. Dhe më thoni kur të  
12 keni përfunduar.

13 A ju ndihmon kjo të kujtoheni nëse jeni takuar me një  
14 person me emrin Shukri Buja?

15 PË. Kam takuar një person me emrin Shukri Buja, por nuk më  
16 kujtohet më. Nuk di më asgjë përveç kësaj që është shkruar  
17 këtu.

18 PY. A ju kujtohet nëse ky person ka qenë i UÇK-së, a ka pasë  
19 ndonjë pozitë në UÇK?

20 PË. Bazuar në këtë paragrafin që kam formuluar, i takon që ka  
21 qenë anëtar i UÇK-së. Po, në Podujevë.

22 PY. Flasim sërish për takimet tuaja. Ju na treguat për  
23 takimet e janarit dhe marsit të 1999, me Ramushin, dhe për  
24 faktin që keni trajtuar me atë çështjen e të drejtave të  
25 njeriut apo shqetësimet që kishte MVK-ja.

1 E kuptoj që keni përdorur një gjuhë neutrale, por a ju  
2 kujtohet që ta keni trajtuar konkretisht, jo vetëm ekzistencën  
3 e të ndaluarve apo ambienteve të ndalimit, por që të keni  
4 trajtuar edhe arrestimin e individëve në UÇK-në dhe raportet  
5 apo, raportet që merrnit, se persona me uniforma të UÇK-së  
6 arrestojnë persona? Do e trajtonit ju këtë?

7 Z. KEHOE: [Përkthim] Ju lutem, a është e mundur që kjo  
8 pyetje të ndahet në disa nënpyetje?

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, e rrëzoj.  
10 Vazhdoni.

11 Dëshmitare, mund t'i përgjigjeni pyetjes.

12 DËSHMITARJA: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, se nuk e mbaj  
13 mend pyetjen më.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë,  
15 mbase paska pasë të drejtë z. Kehoe.

16 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Në rregull.

17 PY. Të flasim për bisedat që keni pasur me Ramushin në  
18 periudhën janar dhe mars të 1999. E kemi parasysh çfarë thatë  
19 para një çasti që ishit shumë të kujdesshëm për gjuhën që  
20 përdornit dhe nuk deshët të përdornit asgjë që mund ta  
21 acaronte situatën. Tani pyetja ime është kjo, a ju kujtohet të  
22 keni trajtuar çështjen e këtyre raporteve që merrnit ju se  
23 kishte persona me uniforma të UÇK-së, që arrestonin apo  
24 merrnin persona?

25 PË. Po, kjo ishte diçka që MVK-ja e ndiqte si rutinë. Nëse

1 ndonjë nga oficerët e terrenit, apo të rajonit, merрте  
2 informata dhe zakonisht informacionet merreshin nga një anëtar  
3 i familjes që shkonte trokiste në zyrë, apo nga një udhëheqës  
4 lokal, që kontaktonte zyrën dhe thoshte që dikush është  
5 arrestuar apo është marrë nga UÇK-ja, atëherë oficerët  
6 ndërlihdës e kishin detyrë që të interesoheshin për këtë  
7 çështje.

8 PY. A ju kujtohet çfarë përgjigje ju ka dhënë Ramushi nëse  
9 vërtet kanë qenë akte të UÇK-së këto apo jo?

10 PË. Zakonisht nuk mohoj. Nëse ndalonin dikë, zakonisht  
11 thonin, "Po, po, e kemi ndaluar" për x arsye, krim,  
12 bashkëpunim, ose mund të thonin që "Nuk e kemi idenë për çfarë  
13 po flisni".

14 PY. Mirë, në qoftë se, në rastin kur e pranoin që ka  
15 ndodhur, që ishte një mundësi, a ka ndodhur, a ka ndodhur  
16 ndonjëherë ndonjë rast që e kanë mohuar dhe ju kanë thënë që,  
17 "Shiko ka qenë dikush tjetër, nuk e ka bërë UÇK-ja"?

18 PË. Po, po.

19 PY. A mund t'ia shpjegoni këtë Trupit Gjykses, çfarë rastesh  
20 kanë qenë këto?

21 PË. Kanë --

22 Z. KEHOE: [Përkthim] A mund të na jepni dhe periudhën  
23 kohore për këtë?

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet. Ju  
25 lutem, kërkoni periudhën kohore.

1 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

2 PY. Flas për të njëjtën periudhë kohore. Janar deri në mars  
3 të 1999. Deri në momentin që do jap një periudhë tjetër, keni  
4 parasysh që gjithmonë po i referohem kësaj periudhe kohore.  
5 Kështu që, do ju lutesha të gjitha përgjigjet të lidhen me  
6 këtë periudhë kohore.

7 PË. Po, njerëzit ndonjëherë zhdukeshin, mund t'i kishte marrë  
8 MUP-i, mbase autoritetet e tjera serbe mund t'i merrnin.

9 PY. Po flisnim për bisedat me Ramushin, për UÇK-në tani, se  
10 kam domosdoshmërisht fjalën, s'besoj se Ramushi përgjigjej për  
11 MUP-in apo autoritetet serbe.

12 PË. Po në qoftë se nuk e kishin ata, dhe kërkoje një shqiptar  
13 të Kosovës, ishte e zakonshme që të thonin, "I kanë serbët,  
14 pyesni serbët". Dhe kështu ishte, dhe ne shkonim. Unë shkoja  
15 rregullisht, takohesha rregullisht me autoritetet serbe për të  
16 ndaluarit. Takohesha rregullisht me KNK-në të verifikoja a  
17 ishin apo i vizitonin dhe ata, i verifikonin informacionin me  
18 njëri tjetrin. Aspekte të kësaj natyre. Por që e ndiqnim këtë  
19 në vijimësi.

20 PY. Kur folët me Ramushit, kur flisnit me Ramushin në këtë  
21 periudhën janar-mars 1999, ju kërkonit vetëm shqiptarë të  
22 Kosovës apo interesoheshit edhe serbë të Kosovës, apo persona  
23 të tjerë që ishin deklaruar si të zhdukur pranë MVK-së, apo  
24 bëhej fjalë vetëm për shqiptarë të Kosovës?

25 PË. Zakonisht ishin shqiptarë të Kosovës apo policë të MUP-

1 it, policë serbë. Këta ishin me profil më të lartë, sidomos  
2 policia serbe ishte një prioritet i lartë për misionin, që të  
3 ulnin gjakrat të mos përshkallëzohej më keq situata në rastet  
4 kur ndalohej apo kapej një polic nga UÇK-ja.

5 PY. A ju kujtohet në këtë periudhë kohore, janar, mars 1999,  
6 që t'ju keni thënë që ka persona që mbajnë uniforma të UÇK-së,  
7 por këta nuk kanë qenë të UÇK-së? Kushdo mund ta blejë një  
8 uniformë të UÇK-së. Nuk është UÇK-ja, edhe ndonëse raportohej  
9 se kishte persona që mbanin emblemat e UÇK-së. A ju kujtohet  
10 të jetë dhënë ndonjëherë ky si shpjegim, pra kur UÇK-ja  
11 thoshte s'jemi ne të përfshirë?

12 PË. Dhe mund të jetë thënë, por më kujtohet që ky justifikim  
13 ishte shumë herë më i përhapur pas fushatës së NATO-s, jo  
14 përpara. Dhe pas rifutjes në territor. Jo para fushatës së  
15 NATO-s, nuk më kujtohet të jetë thënë diçka e tillë.

16 PY. Do flasim dhe për këtë pak më vonë, por që të jetë i  
17 qartë Trupi Gjykses kur flisni për periudhën kohore, për këtë  
18 shpjegimin, kur thatë më pas, a mund të na thoni konkretisht  
19 kur u largua MVK-ja për shkak të NATO-s, të fushatës së NATO-  
20 s, dhe kur u rikthyen?

21 PË. Besoj se ne u tërhoqëm rreth 20 marsit 1999. Dhe besoj se  
22 marrëveshja për armëpushim, për përfundimin e luftimeve ka  
23 ndodhur rreth 10 qershorit. Unë personalisht jam rikthyer në  
24 Kosovë si pjesë e ekipit të OKB-së, më duket se jam rikthyer  
25 në Kosovë rreth datës 12 ose 13 qershor 1999.

1 PY. Pra ky shpjegimi që sapo folëm ne, është një shpjegim që  
2 ju kujtohet ta keni dëgjuar më shumë pas qershorit të 1999,  
3 kështu?

4 PË. Kështu.

5 PY. Tani të fokusohemi tek bisedat, folët pak për bisedat me  
6 Ramushin. Të flasim për të njëjtën periudhë kohore, tani. A ju  
7 kujtohet të keni pasur biseda për persona të ndaluar apo të  
8 zhdukur me komandant Drinin, po në të njëjtën periudhë kohore,  
9 pra, janar, mars 1999?

10 PË. Dhe mund të ketë ndodhur. Nuk më kujtohet ndonjë rast  
11 konkret. Ramushi ishte më i aksesueshëm si person për MVK-në,  
12 më e lehtë për t'u kontaktuar, jo vetëm për shkak të  
13 pozicionit gjeografik ku ndodhej ai, por edhe sepse personeli  
14 kishte marrëdhënie të mira me të dhe ai përgjigjej në telefon.

15 PY. Ju e përmendët pak më herët protokollin që kishit për  
16 kontaktet. Po ju, ndonjëherë e kontaktonit drejtpërdrejt  
17 Ramushin, apo e bënit përmes oficerëve ndërlidhës apo  
18 punonjësve të tjerë të MVK-së për të kontaktuar Ramushin?

19 PË. Nuk më kujtohet të kem kontaktuar ndonjëherë  
20 drejtpërdrejt komandantët e zonave. Këtë e bëja përmes  
21 oficerëve ndërlidhës, respektoja protokollin e brendshëm të  
22 MVK-së. Nëse donim që të realizohej diçka vetëm në këtë formë  
23 mund të realizohej.

24 PY. Bisedat, nga bisedat me Ramushin, ju kujtohet në çfarë  
25 gjuhe keni folur?

1 PË. Shumë pak në anglisht, por kryesisht bëheshin përmes  
2 përkthyesit.

3 PY. Po pse?

4 PË. Doja të sigurohesha që ajo që po thoja po përcillej dhe  
5 që t'i jepej mundësia që vërtet ta kuptonte. Dhe për ata që e  
6 kanë anglishten gjuhën e dytë, sidomos kur flet për aspektin  
7 teknik, është mirë të të jepet mundësia që të bëhet përmes  
8 përkthimit që të kesh mundësi edhe të reflektosh kështu që,  
9 gjithmonë kisha përkthyes atje. Shumë rrallë nuk kisha  
10 përkthyes. E njëjta gjë edhe kur ndodhja me autoritetet serbe,  
11 dhe shumë prej tyre flisnin anglisht, por prapë ne i bënim  
12 bisedat me përkthyes.

13 PY. E njëjta gjë dhe me komandantët e tjerë të zonave, për  
14 shembull me komandant Remin dhe me komandant Drinin? Flasim  
15 gjithmonë për gjuhën.

16 PË. Po, po. Ishte protokolli standard që të kishim përkthyes.  
17 Me raste shumë përjashtimore, mbase ndonjëherë me gazetarët,  
18 apo anëtarë të LDK-së, apo në pozicione më të larta që kishin  
19 vërtet anglishte shumë të mirë, dhe këmbëngulnin që ta kishim  
20 bisedën në anglisht, këta bënin përjashtim.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

22 Prokurore, erdhi ora për pushimin.

23 Dëshmitare, tani është momenti i pushimit të drekës. Do  
24 të bëjmë pushim një orë e gjysmë, do të rikthehemi në sallën e  
25 gjyqit në orën 14.30.

1 Asistentja do t'ju shoqërojë jashtë sallës. Ju lutem, mos  
2 bisedoni me askënd për këtë çështje.

3 DËSHMITARJA: [Përkthim] Patjetër.

4 [Dëshmitarja përfundon dëshminë]

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Seanca  
6 rifillon në orën 14.30.

7 --- Pauza e drekës fillon në orën 12.59

8 --- Seanca rifillon në orën 14.30

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Trupi Gjykses  
10 do jap një urdhër me gojë sa i takon pranimin të provës  
11 materiale P711, që është shënuar për një identifikim më datë  
12 13 nëntor. Është një dokument i cili përmban një listë emrash  
13 të shkruar me dorë të personave të dyshuar dhe  
14 bashkëpunëtorëve të dyshuar dhe ka një nënshkrim dhe vitin  
15 1998.

16 Trupi Gjykses kujton që ZPS-ja ia tregoi këtë dokument  
17 Dëshmitarit 04765 gjatë dëshmisë së tij më datë 13 nëntor.  
18 Mbrojtja e z. Thaçi kundërshtoi pranimin e tij. Dokumenti u  
19 diskutua përsëri me dëshmitarin gjatë pyetjeve që iu drejtuan  
20 nga Trupi Gjykses.

21 Megjithëse dëshmitari nuk pati mundësi që të tregonte në  
22 qoftë se nënshkrimi i përkiste një personi konkret, ai pati  
23 mundësi që të komentonte nënshkrimin dhe përmbajtjen e listës  
24 dhe përmendi dhe shumë emra të dhëna në to.

25 Fakti që dokumenti ka ardhur apo jo nga autoritetet serbe

1 nuk ka rëndësi për çështje të pranueshmërisë së materialit.

2 Trupi Gjykses është i bindur që kërkesat e rregullës  
3 138(1) janë përmbushur. Masa në të cilën dëshmitari ishte në  
4 gjendje që të tregonte autenticitetin e listës dhe përmbajtjen  
5 e komenteve ose konfirmimit të tij për sa i takon të vërtetës  
6 dhe saktësisë së emrave të përbërë në të, nuk kanë peshë për  
7 sa i takon pranimit në provë të këtij materiali.

8 Duke marrë parasysh parashtrimet në nenin 40(6) (h) të  
9 Ligjit, dokumenti ERN U001-7854 deri në U001-7858 dhe versioni  
10 i përkthyer në anglisht do të pranohen si prova materiale.

11 Trupi Gjykses i kërkon Sekretares së seancës që të  
12 ndryshojë statusin e materialit dhe t'i caktojë një numër P  
13 këtij materiali.

14 Znj. Asistente e Seancës, ju lutem silleni dëshmitaren në  
15 sallë.

16 [Dëshmitarja vijon dëshminë]

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull  
18 Dëshmitare, do vazhdojmë tani me pyetjet e Prokurorisë. Jeni  
19 nën betim për të treguar të vërtetën, sikurse u tha më herët  
20 në betimin tuaj.

21 Znj. Prokurore, e keni ju fjalën.

22 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.  
23 PY. Mirëdita, Dëshmitare. Para se sa të ndaheshim për  
24 pushimin e drekës, po diskutonim për periudhën përpara marsit  
25 dhe pastaj pas qershorit. A mund t'i tregoni Trupit Gjykses se

1 çfarë ka ndodhur në mars të 1999 te grupi tuaj, domethënë te e  
2 gjithë MVK-ja, vetëm te Divizioni ose Departamenti i të  
3 Drejtave të Njeriut, çfarë ju ndodhi ju të gjithëve që u  
4 vendosët në Kosovë?

5 PË. Situata e sigurisë u përkeqësua në mënyrë thelbësore pas  
6 dështimit të marrëveshjes në Rambuje në fund të shkurtit të  
7 1999. Kështu që në mars ne pamë që kishte rritje të numrit të  
8 forcave serbe që erdhën në Kosovë dhe që u përfshinë në  
9 luftime. Kjo çoi në tërheqjen e MVK-së sepse situata ishte e  
10 pasigurt, duke marrë parasysh nivelin e dhunës dhe masën e  
11 konflikteve të armatosura, për këtë arsye ne u tërhoqëm.

12 PY. Kur u larguat, a ju dha ndonjë lajmërim se kur do  
13 largoheshit dhe a kishit ndonjë lloj plani se si të tërhiqnit  
14 forcat tuaja?

15 PË. Për rreth nja një javë ka pasur shumë diskutime për  
16 faktin nëse do të tërhiqeshim apo jo, dhe një javë pak a shumë  
17 para tërheqjes ishte shumë e qartë për ne që do të  
18 tërhiqeshim. Nuk e dinim kohën konkrete megjithëse kishte  
19 diskutime së bashku me autoritetet serbe të cilat në atë kohë  
20 ishin përgjegjëse për sigurinë tonë, për të siguruar që ne të  
21 ishim të mbrojtur gjatë largimit, gjatë tërheqjes.

22 Gjatë ditëve të fundit kemi shkatërruar shumë dokumente,  
23 kemi djegur shumë dokumente, për shkak të hapësirave të  
24 kufizuara në automjete për të marrë gjithçka me vete gjatë  
25 tërheqjes. Sa i takon Departamentit të të Drejtave të Njeriut,

1 ne patëm mundësi që të merrnim me vete pjesën kryesore ose  
2 pjesën më të madhe të dokumenteve tona, kështu që e morëm edhe  
3 pjesët përbërëse, hard-drive-t nga kompjuterët tonë.

4 PY. Këto hard-drive i keni marrë me vete, po thoni, kur u  
5 tërhoqët nga Kosova?

6 PË. Po, kanë qenë në makinën ku isha unë vetë. Nuk e mbaj  
7 mend saktësisht se kush tjetër ishte me mua në makinën tonë,  
8 por përveç meje ka pasur një ose dy kolegë të tjerë të  
9 Departamentit të të Drejtave të Njeriut. Aty i kemi tërhequr  
10 dokumentet dhe së bashku me këta kolegë, pra këta kolegë më  
11 kanë shoqëruar deri në momentin kur këto dokumente janë  
12 dorëzuar në një pjesë tjetër të OSBE-së, domethënë që kanë  
13 qëndruar ose në apartamentet që kishim marrë me qira, ose në  
14 ambientet e zyrës që kemi përdorur gjatë asaj kohe.

15 PY. A mund t'i tregoni Trupit Gjykses se vazhduat që të bënit  
16 punë që lidhej me të drejtat e njeriut kur u larguat nga  
17 Kosova?

18 PË. Kur u tërhoqëm nga Kosova, misioni, domethënë MVK-ja së  
19 pari shkoi në Shkup, në Maqedoni. Prej aty pjesa dërrmuese e  
20 stafit rreth 1000, apo 800, janë rikthyer në vendet e tyre.  
21 Ndërkohë që pjesa tjetër e stafit u bënë task-forca për të  
22 ndihmuar për krizat humanitare që po zhvilloheshin pas  
23 zhvendosjes kryesore të shqiptarëve të Kosovës në pjesët e  
24 Shqipërisë, ndërkohë që në Maqedoni ndodhi më vonë, domethënë  
25 krijimi i kampeve atje ndodhi më vonë. Kështu që edhe atje ne

1 patëm të zhvendosur, kishim edhe ndihmën e UNHCR-së. Gjatë  
2 asaj periudhe ne filluam që të merrnim gjithashtu edhe  
3 deklaratata nga refugjatët të cilët ishin viktima ose ishin  
4 persona që kishin parë me sytë e tyre raste të dhunës që  
5 kishin ndodhur në Kosovë, apo në fshatrat ndërkohë që ato  
6 largoheshin.

7 PY. Ju përmendët refugjatët ose kampet, e keni fjalën këtu  
8 edhe për kampe refugjatësh?

9 PË. Po. Këto ishin kampe refugjatësh që zakonisht  
10 menaxhoheshin nga qeveritë pritëse, ose UNHCR-ja, ose për  
11 shembull përveç kampeve kishin, kishte edhe shumë familje  
12 shqiptare të cilat hapën dyert e shtëpive të tyre për  
13 kosovarët.

14 PY. Ju përshkruat një pjesë të madhe të MVK-së, që u kthyen  
15 në vendet e tyre, në shtëpitë e tyre, por gjithsesi kishte  
16 edhe departamente të drejtave të njeriut të cilët vazhduan,  
17 domethënë persona të tjerë brenda organizatës që e vazhduan  
18 punën e tyre. Sa vendime janë marrë sa i takon pjesës tjetër  
19 të stafit që ka punuar që mund të ketë qenë për shembull në  
20 Maqedoni ose në Shqipëri?

21 PË. Kur u larguam nga Kosova, kemi qenë rreth 75 oficerë të  
22 të drejtave të njeriut. Pjesa më e madhe e tyre u zhvendosën  
23 ose në Shqipëri ose në Maqedoni, në mënyrë të tillë që të mund  
24 të vazhdonin punën për të drejtat e njeriut duke folur, duke  
25 bashkëbiseduar me refugjatët ose në kampet e refugjatëve ose

1 në familjet që mbanin refugjatë.

2 PY. Pjesa kryesore e punës tuaj, duke filluar nga marsi,  
3 prilli sa i takon të folurit me refugjatët, a ka filluar  
4 atëherë, domethënë në mars, në prill?

5 PË. Në këtë pikë po, ne lidheshim shumë ngushtë me hetuesit  
6 nga TPNJ-ja. Unë personalisht kisha ca përvojë sa i takon  
7 menaxhimit të informacionit masiv në punët e mia të më  
8 përparshme para sesa të përdorshmit versionet në *widespread*  
9 kompjuterike, kështu që ne krijuam disa formularë standardë  
10 për sa i takon mbledhjes së informacionit, organizuam ekipet  
11 të cilat më pas u zhvendosën në kampet dhe jetonin në  
12 komunitete.

13 PY. Sa i takon raportimit tuaj, të njëjtat raportime ditore  
14 dhe javore bënit dhe në atë kohë? Të njëjta si ato që na  
15 përshkruat më herët kur shkuat në Kosovë, apo mënyra e  
16 dokumentimit të atyre çfarë ju shihnit, ndryshoi?

17 PË. Pjesa dërrmuese e raportimit ka ndryshuar thelbësisht,  
18 raportet që shkonin në Vjenë kishin të bënin kryesisht me  
19 faktin se si, se ku ishin të shpërndarë refugjatët në Shqipëri  
20 dhe në Maqedoni, situatës së tyre, ose për shembull raportohej  
21 për mbërritjen e UNHCR-së apo agjencive të tjera të Kombeve të  
22 Bashkuara.

23 Ne në atë kohë nuk ndanim informacione që merrnim nga  
24 deklaratat e dëshmitarëve sa i takon gjërave që ata kishin  
25 parë kur ishin nisur nga Kosova.

1 PY. A erdhi një kohë ku organizimi jua ndryshoi  
2 brendapërbrenda OSBE-së ku ju nga MVK u bëtë një organizatë  
3 tjetër?  
4 PË. Pas tërheqjes, përderisa ne nuk ishim më në Kosovë, u mor  
5 një vendim i OSBE-së nga organi menaxhues atje në Vjenë që të  
6 krijohej një task-forcë për Shqipërinë. Nuk më kujtohet se si  
7 quhen në Maqedoni, mendoj që ka qenë një task-forcë ose grup  
8 pune analog dhe atje. Këto ishin task forca të cilat kishin  
9 kompetenca në aspektet humanitare edhe që ishin të veshur me  
10 përgjegjësinë për të monitoruar situatën për të drejtat e  
11 njeriut dhe për të raportuar nga Kosova në, dhe për sa i takon  
12 refugjatëve në kampe ose në familjet pritëse.

13 PY. A erdhi një moment kur juve u bëtë Misioni i OSBE-së në  
14 Kosovë, i quajtur ndryshe si OMiK?

15 PË. OMiK ishte krijim i Këshillit të Sigurisë së Kombeve të  
16 Bashkuara, i rezolutës së Këshillit të Kombeve të Bashkuara i  
17 cili u ndoq nga përfundimi i luftimeve në Kosovë nën  
18 administratën e Kombeve të Bashkuar dhe kishte katër shtylla  
19 kryesore. Njëra shtylla ishte shtylla humanitare që drejtohej  
20 nga UNHCR-ja dhe shefi kishte një zëvendëssekretar ose, nuk e  
21 di, përfaqësues i posaçëm i sigurisë, ose i Sekretarit të  
22 Përgjithshëm. Ndërkohë kishte një tjetër shtyllë që ishte  
23 shtylla e Bashkimit Evropian që ishte përgjegjës për  
24 rindërtimin e Kosovës, që të rimëkëmbte bizneset dhe  
25 ekonominë. Pastaj kishim Administratën Civile të Kombeve të

1 Bashkuara që ishte një autoritet i përkohshëm derisa të  
2 bëheshin zgjedhjet. Dhe pastaj kishim shtyllën e OSBE-së, që  
3 kishte të bënte me të drejtat e njeriut, me zhvillimin e një  
4 shkolle policie, shtetin e së drejtës, dhe këto lloj  
5 aktiviteteve. Ky ishte OMiK-u.

6 PY. Dhe kush u caktua si drejtues i OMiK-ut?

7 PË. Kore Altervag [fonetiki] fillimisht, që ishte  
8 diplomat, për disa javë ishte ky emërim. Pastaj u caktua  
9 ambasadori Daan Everts, nga Holanda, ai u caktua shef i  
10 misionit.

11 PY. A ju kujtohet se kur ka ndodhur kjo? Kur u caktua  
12 ambasadori Daan Edwards [Sipas përkthimit]?

13 PË. Nuk më kujtohet se kur është emëruar ai, besoj që ka  
14 mbërritur në Kosovë në fund të korrikut, kah fillimi i  
15 gushtit.

16 PY. Kur nuk keni qenë në Kosovë, a ka ndodhur që të jeni  
17 takuar me ambasadorin Everts kur u tërhoqët nga Kosova?

18 PË. Po, ambasadori Everts ishte shefi i misionit të OSBE-së  
19 në Shqipëri. Shqipëria është kufi me Kosovën. Dhe aty ka një  
20 mision, pra në Shqipëri ka një mision më tradicional për të  
21 ndihmuar qeverinë në aktivitetet që kanë të bëjnë me shtetin e  
22 së drejtës.

23 PY. Nuk e di na thatë apo jo, se ju thatë fillimisht shkuat  
24 në Maqedoni, nëse s'gabohem? Domethënë juve a keni udhëtuar në  
25 Shqipëri në atë kohë?

1 PË. Unë u caktova si zëvendëse e task-forcës në Shqipëri ku -  
2 - sepse e dimë që në Shqipëri u vendosën pjesa dërrmuese e  
3 refugjatëve, në veçanti ata të cilët i përkisnin pjesës  
4 perëndimore të vendit. Dhe në të njëjtën kohë lëvizja dhe në  
5 Maqedoni dhe në selinë kryesore të OSBE-së në Vjenë, por  
6 ndodhte që të isha dhe për javë të tëra në Shqipëri.

7 PY. A u takuat me ambasadorin Everts përpara sesa të krijohet  
8 UNMIK-u, dhe përpara se sa ai të caktohet në atë detyrë, kur  
9 shkuat në Shqipëri, a jeni takuar me ambasadorin?

10 PË. Po. Shefi i misionit ishte Michel Maisonneuve që ishte  
11 shefi i zyrës në Prizren. Dhe me udhëzimet e tij ne u  
12 zhvendosëm, u vendosëm në Tiranë dhe aty menjëherë u takuam me  
13 ambasadorin Edwards [Sipas përkthimit].

14 PY. Kur ka ndodhur kjo?

15 PË. Do ketë qenë diku nga fundi i marsit, mbase. Ose fillimi  
16 i prillit, nuk jam shumë e sigurt. Nuk më kujtohet dita  
17 e saktë. 1999.

18 PY. Na përshkruat, na thatë se çfarë bëtë në atë kohë kur u  
19 tërhoq ekipi juaj. Por, a e erdhi një moment kur ju edhe ekipi  
20 juaj u kthyet përsëri në Kosovë?

21 PË. Po. Kur filluan fushatat ajrore të NATO-s, bombardimet e  
22 NATO-s, kur ata filluan që të ngadalësoheshin dhe filluan që  
23 të intensifikoheshin më tepër bisedat e paqes, unë  
24 personalisht kam qenë e përfshirë për ca planifikime të  
25 Misionit të Kosovës dhe se çfarë pamje do të kishin ata në

1 kuadrin e kësaj strukturës së përgjithshme të Kombeve të  
2 Bashkuara që përshkrova pak më sipër. Pra, unë kam organizuar  
3 takime në Vjenë, dhe zakonisht Departamenti i të Drejtave të  
4 Njeriut tregon këtë pjesën e butë të strukturës.

5 PY. Cili ishte plani, si mendohej, kur do ktheheshit ju dhe  
6 ekipi juaj në Kosovë?

7 PË. U ra dakord që ne do të futeshim përsëri në Kosovë si  
8 pjesë e ekipit të avancuar. Kishim një ekip të vogël, gjashtë  
9 a tetë veta, të cilët u kthyen menjëherë pas hyrjes të forcës  
10 shumëkombëshe në Kosovë. Në atë kohë, ne ishim pjesë e Kombeve  
11 të Bashkuara, të Sergio de Mellos, të SRSG-së së tij.

12 PY. A u mor vendimi që të ktheheshin më shumë persona të të  
13 drejtave të njeriut pasi u fut ky ekipi i vogël?

14 PË. Po, OSBE-ja kishte një angazhim të fortë të të drejtave  
15 të njeriut dhe një pjesë e misionëve të veta kishte të bënte  
16 me aktivitetet e të drejtave të njeriut, trajtimin e  
17 autoriteteve, organet qeverisëse, etj. në drejtim të  
18 popullsisë civile. Ishte e qartë që OSBE-ja do të vazhdonte  
19 këtë mandat. Këtë mandat në fakt e kishte edhe në vende të  
20 tjera ballkanike pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë. Kështu  
21 që plani ishte që ata të riktheheshin në Kosovë.

22 Mua më kujtohet që thuajse i gjithë stafi u kthye,  
23 ndoshta disa veta nuk erdhën për shkak të arsyeve personale,  
24 por pjesa dërrmuese e stafit u kthyen përsëri në Kosovë.

25 PY. Kur ka ndodhur kjo? Kur është kthyer pjesa dërrmuese e

1 stafit për të vazhduar me punët e lidhura me të drejtat e  
2 njeriut?

3 PË. Marrëveshjet për paqen kanë qenë nga mesi i qershorit. Ne  
4 jemi futur në Kosovë disa ditë përpara KFOR-it, pra forcës  
5 shumëkombëshe, përpara se sa u futën ata. Kur unë u futa në  
6 Kosovë, armata jugosllave dhe MUP-i ishin akoma në Prishtinë,  
7 që po shkatërronin dhe po vidhnin çdo gjë që mundnin. Një,  
8 pra, megjithëse zyrtarisht ishin tërhequr, ndoshta ka qenë  
9 java e tretë e qershorit, qershorit të 1999, ne, sapo u futëm,  
10 u munduam që të gjenim strehim dhe në momentin që gjetëm  
11 strehim po mundoheshim që të sillnim sa më shumë staf që të  
12 ishte e mundur.

13 Kështu që prej momentit kur ne u futëm, thujse përditë  
14 vinin persona nga radhët tanë.

15 PY. Kur u kthyet në Kosovë në fillim të qershorit 1999, a e  
16 rifilluat punën për të drejtat e njeriut, sa i takon personave  
17 që raportoheshin si të zhdukur ose të ndaluar?

18 PË. Kur u rikthyem në Kosovë, ne ishim kryesisht të  
19 përqendruar që të shkonim shpejt në vendet e varreve masive që  
20 kishim identifikuar gjatë muajve të verës, kur po  
21 intervistonim refugjatët, pra në ato vendet që ne mendonim që  
22 mund të ishin varre masive, dhe kur vende të tilla ishin  
23 identifikuar nga forcat e koalicionit dhe TPNJ-ja.

24 Pra, së pari jemi përpjekur që të dokumentojmë se ku  
25 ishin varret masive, që ishte shumë e vështirë në fakt, sepse

1 duke u kthyer, shqiptarët që po ktheheshin dëshironin që të  
2 gjenin dhe të krijonin, të kishin një varr për të dashurit e  
3 tyre. Dhe përveç kësaj ne mundoheshim që të krijonim përsëri  
4 kushtet për refugjatët që do të ktheheshin në shtëpitë e tyre.  
5 PY. Pra, kishte qëllim të dyfishtë, pra, mbështeteshit tek  
6 raportet për varreza masive që ishin raportuar nga persona të  
7 caktuar, dhe në të njëjtën kohë përqendroheshit tek  
8 refugjatët, kështu, apo jo?

9 PË. Po, e saktë.

10 PY. Kur u kthyet së pari në Kosovë, pra në periudhën e  
11 hershme nga qershori në korrik 1999, çfarë gjetët atje, pra si  
12 ishte situata e të drejtave të njeriut në Kosovë kur u kthyet?

13 PË. Kosova, situata ishte e ndryshme në vende të ndryshme.  
14 Tek pjesa perëndimore kishte pasur luftime të ashpra. E kam  
15 fjalën këtu për Pejën, për Gjakovën, për këto zona. Pra kishte  
16 pasur luftime shumë të ashpra dhe një pjesë e mirë e fshatrave  
17 ishin shkatërruar. Refugjatët po vinin në turma nga zonat  
18 shqiptare dhe, siç mund të mendohet, ishin shumë të zemëruar,  
19 shumë të shkatërruar, kështu që situata ishte e tillë që  
20 kishte një vuajtje shumë të madhe. Kjo ishte pak a shumë  
21 situata e refugjatëve të kthyer. Ndërkohë që në pjesë të  
22 caktuara të Kosovës situata ishte tërësisht e pacenuar, e  
23 paprekur. Pra, ka pasur zona në të cilat luftimet nuk kanë  
24 qenë shumë të pranishme, kështu që vendasit e kthyer në këto  
25 zona filluan pak më normalisht punën e tyre dhe jetën e tyre.

1 Ndërkohë që në Prishtinë kishte pasur ca plaçkitje,  
2 vjedhje, edhe ata po ktheheshin në Prishtinë dhe ata kishin  
3 vende ku të ktheheshin. Kështu që, në përmbledhje, situata ka  
4 qenë e ndryshme në pjesë të ndryshme të Kosovës. Megjithatë  
5 nuk kishte organe të zbatimit të ligjit, nuk kishte polici.  
6 Qeveria ishte shpërbërë, kishte kolapsuar, nuk kishte shërbime  
7 funksionale. Pra, personat që ishin punësuar më përpara në  
8 ndërmarrjet e energjisë elektrike ose në ndërmarrjet e tjera  
9 të shërbimeve, si për shembull ujësjellësi, etj. u munduan që  
10 të ktheheshin në punë sepse ato ishin, ishin larguar gjatë  
11 periudhës së serbëve.

12 Kishte shumë kaos në spitale. Shumë nga mjekët ishin  
13 serbë, dhe ishin të frikësuar, lidhur me atë se çfarë mund të  
14 ndodhte. Shqiptarët kishin frikë që të shkonin në spitale për  
15 shkak të mjekëve serbë, e të tjerë. Pra, kishte shumë  
16 tensione, kishte një situatë të vështirë dhe ne po mundoheshim  
17 së bashku me donatorët e tjerë që të mund të krijojmë një  
18 strehë që njerëzit të kishin vend ku të ktheheshin ku të  
19 fusnin kokën kur të ktheheshin.

20 PY. Ju thoni që në fakt nuk kishim të bënim me të njëjtën  
21 infrastrukturë që kishte ekzistuar në vend më herët, OMIK-u a  
22 kishte bashkëbisedues me të cilët të fliste dhe që të  
23 organizonte që të mbushte këtë vakumin e krijuar të menaxhimit  
24 të gjërave?

25 PË. Sërish varej se ku ishe në Kosovë, dhe për cilën zonë

1 flisje për Kosovën. Më kujtohet që kur shkuam në udhëtimin e  
2 parë në Pejë, në zonën e Gjakovës, ndoshta ka qenë pesë apo  
3 gjashtë ditë pra përpara kthimit, ndoshta nga fundi i  
4 qershorit, ose mesi i qershorit. Vakumi i sigurisë po mbushej  
5 me shpejtësi nga i vetmi autoritet që ishte i pranishëm atje,  
6 që ishte UÇK-ja. Ata po udhëzonin trafikun në pjesën  
7 perëndimore të vendit ku ishin kryesisht të vendosur dhe ishin  
8 më të pranishëm.

9 Po ashtu, mundoheshin që t'i jepnin udhëzimet e tyre për  
10 sa i takon shërbimeve bazë, sepse thashë dhe më herët që pjesa  
11 dërrmuese e shqiptarëve i kishin humbur vendet e punës si  
12 rezultat i okupacionit serb. Pra, me fjalë të tjera, kishte  
13 përpjekje që gjërat të ktheheshin në një farë normaliteti.

14 Ndërkohë që në pjesë të tjera të vendit, prania e UÇK-së  
15 ishte më pak e sigurt, apo ishte më e ngadaltë, megjithatë  
16 pavarësisht kësaj kishte vakum sigurie. Forcat shumëkombëshe,  
17 për shembull, forcat e NATO-s në Kosovë nuk e shikonin  
18 policimin si një prej funksioneve të tyre. Në fillim ishin  
19 hezitues, më pas filluan që ta bënë dhe këtë punë, por ata  
20 nuk kishin kapacitet në mënyrë të tillë që të menaxhoheshin  
21 stacionet e policisë apo burgjet, kështu që këto ishin detyra  
22 që kryesisht u kryhen nga UÇK-ja apo nga shqiptarë që  
23 caktoheshin nga UÇK-ja pasi kishin qenë pjesëtarë të  
24 organizatës.

25 PY. Dua që të përqendrohemi tek periudha kur ju u kthyet

1 përsëri në Kosovë -- kur ju e vazhduat punën tuaj, nëse mund  
2 të shprehem kështu. Pra në fund të qershorit, në korrik, në  
3 gusht, për këtë periudhë kohe e kam fjalën. Për qershor,  
4 korrik, gusht.

5 A filluat të dallonit ndonjë tendencë apo ndonjë  
6 shqetësim që lidhej me trajtimin e popullatave të ndryshme?  
7 PË. Kur u kthyem në Kosovë, sikur e thashë dhe më herët, ne  
8 kishim si prioritet që të identifikonim varret masive dhe të  
9 bënim zhvarrime. Më pas, ne ndiqnim situatën e të kthyerve në  
10 mënyrë të tillë që t'i vinim në ndihmë UNHCR-së që me thënë të  
11 drejtën ishte e mbingarkuar sepse refugjatët po ktheheshin në  
12 mënyrë spontane, jo detyrimisht me ndihmën e UNHCR-së.

13 Kishte mosmarrëveshje, kishte shpagime, kishte frikësime,  
14 për shembull, kemi parë, i kemi parë këto në trajtën e serbëve  
15 të vrarë që shfaqeshin këtu-aty, ose të romëve të vrarë, që  
16 besohej që kishin bashkëpunuar me autoritetet serbe nga  
17 popullsia civile. Kështu që ne filluam që të rrisnim  
18 monitorimin tonë, në mënyrë organike dhe të natyrshme, lidhur  
19 me pakicat. Kishte dhe një eksod gjatë periudhës që po  
20 diskutoni, dhe që vazhdoi më tej deri në shtator dhe në tetor  
21 të shumë pakicave në Kosovë të cilat u larguan në drejtim të  
22 Maqedonisë, të Serbisë, e të tjerë.

23 Më pas pamë që dhuna të bëhej më shumë brendapërbrenda  
24 shqiptarëve, domethënë dhunë shqiptar me shqiptar. Pamë raste  
25 të tilla të cilat filluan që të rriteshin.

1 PY. Organizata juaj, përsëri po përqendrohej tek marrja e  
2 raporteve nga individët për llojet e tilla hakmarrjesh dhe  
3 frikësimesh që ju përmendni? Dhe a vazhduat që të merrnit  
4 raporte dhe të dokumentonit gjithashtu dhe rastet e raportimit  
5 të hakmarrjeve dhe frikësimeve shqiptar me shqiptar?

6 PË. Po. Sapo u kthyem në Kosovë, ne filluam që të  
7 dokumentonim çdo gjë. Ne ishim nën ombrellën e madhe të  
8 Kombeve të Bashkuara në atë kohë, domethënë me fjalë të tjera  
9 Kombet e Bashkuara ishin i vetmi autoritet në Kosovë që kishte  
10 mundësi që të mbante një lloj historiku ose një lloj regjistri  
11 të asaj çfarë po ndodhte, sepse nuk kishte polici, nuk kishte  
12 funksionim në aspektin gjyqësor. Nuk kishte gjyqësor  
13 funksional. Kishte gjykatës, por gjyqësori nuk funksiononte.  
14 Kështu që në këtë kuptim ne merreshim me shumë dokumentim të  
15 situatës, pra kishim raporte të përditshme të situatës, një  
16 punë që është shumë e ngjashme me atë çfarë kishim bërë dhe  
17 paraprakisht. Ndoshta ishte pak më e gjerë, sepse po merreshim  
18 me raportim më të gjerë për Kombet e Bashkuara, kështu që  
19 dokumentonim shumë takime që bënim me shërbimet, me  
20 ndërmarrjet e shërbimeve bazë, për shembull me bordin e  
21 furnizimit me ujë, gjëra të cilat jo domosdoshmërisht i bënim  
22 përpara luftës.

23 PY. Prej raportimeve ditore që bëtë a ju ra në sy në qoftë se  
24 përndjekja apo dhuna ishte e organizuar apo të paktën dukej se  
25 ishte sistematike?

1 Z. KEHOE: [Përkthim] Kam kundërshtim, nuk ka bazë për  
2 këtë pyetje.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet  
4 kundërshtimi.

5 Vazhdoni.

6 DËSHMITARJA: [Përkthim] Fillimisht ishte një kaos i  
7 përgjithshëm. Është e vetmja mënyrë se si mund të përshkruhet  
8 situata. Shumë gjëra ndodhnin në të njëjtën kohë. Njerëzit po  
9 ktheheshin nëpër shtëpitë e tyre, ishin të shqetësuar, të  
10 zemëruar. Ishte shumë e vështirë që të dallohej se çfarë ishte  
11 krim dhe çfarë mund të ishte pjesë e një qasje më të  
12 organizuar apo më sistematike në ato ditë të para.

13 Ne filluam të marrim gjithnjë e më shumë, e më shumë  
14 raporte dhe filluam të dallonim edhe disa modele.

15 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

16 PY. Çfarë modelesh sjelljesh apo veprimesh patë?

17 PË. Po filluam të merrnim raporte të shumta për njerëz të  
18 veshur me rroba të zeza me shenja të UÇK-së, apo për njerëz që  
19 prezantoheshin si anëtarë të UÇK-së që bënë detyra policore,  
20 që po caktonin njerëz në vende të punës, që merrnin prona  
21 private, gjëra të tilla të kësaj natyre.

22 PY. Po a morët gjatë kësaj periudhe dhe raporte për rrëmbim  
23 të njerëzve nga ana e UÇK-së?

24 PË. Po, kishte raporte të tilla që UÇK-ja po rrëmbente  
25 njerëz, arrestonte njerëz, po i merrte në biseda informative,

1 që përfshiheshin në aktivitete të shumta që nga vënia e  
2 zjarrit, djegie shtëpish, deri në kërcënimin e njerëzve,  
3 përkatësisht serbëve, romëve, dhe kështu me radhë, që të  
4 largoheshin nga krahina. Dhe këto raporte vinin nga të gjitha  
5 pjesët e Kosovës me kalimin e kohës.

6 PY. Domethënë, nuk ishin të përqendruara vetëm në një zonë?

7 PË. Jo. Raportet e para erdhën nga perëndimi, ku raportoheshin  
8 se UÇK-ja po jepte targat për automjetet dhe se po kryente  
9 funksione dhe detyra të ndryshme që zakonisht i bëjnë  
10 qeveritë. Dhe më pas raporte të tilla u paraqitën edhe në  
11 lidhur me zonën e Gjilanit.

12 PY. Gjatë kësaj kohe kur u kthytë aty në vend, a kishit  
13 mundësi për të vendosë kontakt apo për t'u lidhur me UÇK-në  
14 për t'i diskutuar këto çështje?

15 PË. Shumica e perfektëve u emëruan nga Qeveria e Përkohshme  
16 dhe ata ishin kryesisht, që në fakt ishte udhëheqësia e UÇK-  
17 së. Dhe filluam që të kemi kontakte të rregullta me zyrtarë të  
18 tillë që u emëruan.

19 PY. Jemi ende duke folur për periudhën kohore qershor,  
20 korrik, gusht 1999. Ju vetë, e ngritët ndonjëherë çështjen e  
21 të drejtave të njeriut me udhëheqësinë e UÇK-së?

22 PË. Po mendohem, sepse në atë kohë ishte e vështirë që të  
23 kesh qasje të udhëheqësia, por këto gjëra raportoheshin në  
24 nivel lokal. Unë personalisht gjatë asaj kohe në qoftë se kam  
25 qenë e përfshirë në diskutime të nivelit më të lartë, do të

1 duhet një herë të konsultohesha me dokumente në lidhje me ato.  
2 Mirëpo, ka pasë takime në nivel të terrenit, ndërveprime  
3 ditore.

4 PY. Atëherë, do të qëndrojmë këtu tek niveli në terren. Kur  
5 ngritët këtë çështje, për shembull, me këta njerëz, çfarë  
6 përgjigje merrnit nga udhëheqësit lokalë të UÇK-së?

7 Z. KEHOE: [Përkthim] Edhe një herë, për cilët udhëheqës  
8 lokalë e kemi fjalën, i nderuar Gjykatës?

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

10 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

11 PY. Mund të përgjigjeni, Dëshmitare.

12 Z. KEHOE: [Përkthim] A hidhet poshtë kundërshtimi im?

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

14 DËSHMITARJA: [Përkthim] Përgjigja ishte konsistente.

15 Mohimi nga ana e përfaqësuesve lokalë të UÇK-së apo  
16 përfaqësuesve me të cilën ne bisedonim, ata thonin që këta  
17 janë mashtrues. Njerëz që thjesht veshin uniformën e UÇK-së.

18 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

19 PY. A ju kujtohet të keni marrë ndonjëherë raporte nga stafi  
20 lokal ku ju keni përcaktu se me të vërtetë është fjala për  
21 mashtrues, dhe a keni bërë një hetim të mëtejshëm në lidhje me  
22 këtë?

23 PË. Nuk më kujtohet ndonjë hetim i mëtejshëm konkret, mirëpo  
24 ndonjëherë bashkëbiseduesit nga ana e UÇK-së na thonin që do  
25 t'i hetonin këto raporte, dhe ne pastaj nuk dëgjonim prej tyre

1 më asgjë. Dhe, u bë e dukshme që OSBE-ja do të duhej të  
2 dokumentonte atë që po ndodhte dhe ta publikonte atë  
3 dokumentacion.

4 PY. Po ishte ky i vetmi shpjegim që morët se këta ishin  
5 mashtrues apo morët edhe ndonjë shpjegim tjetër?

6 PË. Po, thonin se këta janë kriminelë, banda kriminale,  
7 shqiptarë të Kosovës që në mënyrë si të thuash natyrore,  
8 njerëzore i janë përgjigj vuajtjeve dhe dhunës që kishin  
9 përjetuar. Se ne duhet të përqendronim punën tonë në  
10 zhvarrimet, në varrezat masive dhe në krime që kishte kryer,  
11 që i kishin kryer forcat serbe.

12 PY. Ju thatë që këto gjëra po ndodhnin anembanë Kosovës, që  
13 nuk ishin të përqendrime vetëm në një pjesë të Kosovës. A  
14 mbaheshin takime me komandantë lokalë të UÇK-së në gjithë  
15 pjesët e Kosovës, apo vetëm në një pjesë të caktuar?

16 PË. Jo. Sikurse thashë, qeveria e përkohshme, që në fakt në  
17 këtë kohë ishte UÇK-ja, sepse LDK-ja ishte tërhequr nga kjo  
18 qeveri, i caktonte njerëzit në pozita udhëheqëse në spitale,  
19 dhe kështu me radhë, shërbime bazë. Domethënë ishte shumë e  
20 lehtë që t'i çohesh mesazhi UÇK-së duke i vizituar këta  
21 zyrtarë.

22 Dhe në atë kohë ende ishin me uniforma, shumë të zënë,  
23 dhe mendoj që në atë kohë ata sinqerisht përpiqeshin që të  
24 fillonin të rindërtonin Kosovën, të mëkëmbnin Kosovën.

25 PY. Ju kuptova. E kisha fjalën më shumë për biseda që kishit

1 me komandantët lokalë gjatë atyre takimeve në qoftë se ju  
2 përmendnin raste të tilla kur njerëz të veshur me uniformë të  
3 UÇK-së që merrnin njerëzit, këto takime a kufizoheshin në një  
4 zonë konkrete apo anembanë Kosovës?

5 PË. Jo, çdokund në Kosovë. Nuk ishte asnjë zonë e vetme prej  
6 të cilës nuk kishim dëgjju për një lloj të tillë sjelljeje.

7 PY. Atëherë, a do të ishte e drejtë të thuhej se ishte kjo e  
8 koordinuar apo e ngjashme në të gjitha zonat që nuk  
9 përqendrohej vetëm në një grup njerëzish apo individësh që  
10 jepnin atë shpjegim në një zonë të caktuar?

11 PË. Po. Dhe këto praktika sjellje janë dokumentuar nga OMIK-  
12 u. Pra pretendime që njerëz të UÇK-së të veshur me uniforma  
13 kanë bërë këtë e këtë.

14 PY. A e keni takuar ndonjëherë Hashim Thaçin?

15 PË. Po.

16 PY. A mund të na thoni kur dhe në çfarë konteksti?

17 PË. Mendoj se për herë të parë e kam takuar z. Thaçi me  
18 ambasadorin Walker para evakuimit. Dhe pastaj e kam takuar  
19 përsëri në zyrën e ambasadorit Everts apo në dhomën e  
20 konferencave, dhe mendoj që kam qenë e pranishme dhe në disa  
21 takime që janë mbajtur në zyrat e OKB-së në të cilat ka marrë  
22 pjesë edhe z. Thaçi, në kohën kur UNMIK-u drejtohej prej  
23 Kouchner.

24 PY. Tani do të flasim për herën e parë që e keni takuar me  
25 ambasadorin Walker. Ishte kjo hera e parë që e kishit takuar

1 para qershorit të 1999?

2 PË. Po.

3 PY. A mund të na i përshkruani rrethanat e këtij takimi?

4 PË. Ishte rreth, mendoj, tërheqjes së misionit të MVK-së.

5 PY. Po patët ndonjë bisedë me z. Thaçi në atë moment?

6 PË. Jo. Unë merrja shënime për ambasadorin Walker.

7 PY. Tani, periudhën qershor 1999, tetor 1999. Gjatë kësaj

8 periudhe, a patët rastin të takoheshit me z. Thaçi?

9 PË. Mendoj që kam qenë në takime, mendoj me zotën,  
10 ambasadorin Everts, dhe z. Thaçi mu përpara lëshimit të  
11 raportit publik gjatë kësaj periudhe. I bëmë një demarsh, i  
12 treguam se çfarë do të ketë në raport, se çfarë akuzash apo  
13 pretendimesh do të paraqiteshin aty.

14 PY. Përpara se të kalojmë te kjo pjesë. Kur u takuat për herë  
15 të parë me z. Thaçi, dhe e kam të qartë se nuk ishte takim  
16 personal i juaji me z. Thaçi, por se ju ishit me ambasadorin  
17 Everts. A mund të na thoni konkretisht se çfarë periudhe  
18 kohore ka ndodhë ky takim, a ka qenë mu sa u kthytë në atë  
19 periudhë apo pak më vonë?

20 PË. Mendoj që nuk ka qenë aty në fillim pas kthimit, por  
21 dikund nga tetori apo nëntori, gjatë asaj periudhe.

22 PY. Dhe a e dinit në atë kohë se çfarë posti apo pozite  
23 kishte z. Thaçi?

24 PË. Z. Thaçi ishte kreu i Qeverisë së Përkohshme.

25 PY. Dhe a e dinit në atë kohë në qoftë se ai kishte pasur një

1 pozitë me UÇK-në?

2 PË. Po.

3 PY. Po e dini se çfarë pozite?

4 PË. Jo, nuk më kujtohet. Nuk e di nëse ishte komandant zone  
5 apo çfarë ishte. Por e di që ai u kontaktua menjëherë pas  
6 masakrës së Reçakut për të mundësuar lëvizjen e kufomave  
7 nëpërmjet zonave të ndryshme të UÇK-së.

8 PY. Kjo ishte në janar të 1999?

9 PË. Diku nga fundi i janarit, apo fillimi i shkurtit. Mendoj  
10 që kufomat u liruan dikund nga fundi i janarit.

11 PY. Na thoni për këtë kontakt me z. Thaçi, çfarë ju kërkua  
12 atij dhe çfarë bëri ai?

13 PË. Unë isha aty, kërkesën e bëri ambasadori Walker me sa më  
14 kujtohet. Kufomat ishin çuar në Prishtinë, nga autoritetet  
15 serbe, dhe kishin kaluar një zonë dhe mendoj që ishte  
16 përfshirë një komandant zone. Dhe prej atij u kërkua që të  
17 siguronte se nuk do të kishte kurrfarë problemi me kthimin e  
18 kufomave në fshat dhe mandej mendoj që u bënë edhe diskutime  
19 në lidhje me varrimin.

20 PY. Po përfshirja e tij a kishte të bëjë me faktin që kufomat  
21 do të kalonin nëpër disa zona?

22 PË. Po.

23 PY. A mund t'i shpjegoni Trupit Gjykses se çfarë doni të  
24 thoni me këtë?

25 PË. Me sa e kuptoj, mënyra sesi ishte krijuar UÇK-ja në atë

1 kohë, ajo përfshinte gjashtë apo shtatë zona të ndara nga  
2 aspekti gjeografik dhe kishte një farë ndërveprimi midis  
3 zonave. Domethënë kur duheshe të kaloje prej një zone në  
4 tjetrën, për shembull në këtë rast për t'i transportuar  
5 kufomat, duhej të shkoje mbi komandantët e zonës dhe z. Thaçi  
6 ishte ai që e mundësoi këtë.

7 PY. Tani do të flas për tetorin, nëntorin, për këtë periudhë,  
8 të 1998, kur ju thatë që kishit takime të tjera me z. Thaçi.  
9 Pikërisht takimet midis ambasadorit Everts dhe z. Thaçi. Gjatë  
10 këtyre takimeve a u prek tema e të drejtave të njeriut apo  
11 trajtimit të të ndaluarve apo individëve që ishin në  
12 kontrollin e UÇK-së?

13 PË. Po. kishim pasur një takim në lidhje me një incident të  
14 sigurisë më herët, por gjithashtu kishim edhe takime, në  
15 lidhje me përfundimet prej raportimeve që na boheshin.

16 PY. Të fillojmë një herë me takimin që keni pasur me të në  
17 lidhje me incidentin e sigurisë.

18 PË. Mendoj që kjo ishte dikund në tetor, ndoshta dhe në  
19 nëntor. Ne dhe kur them "ne" e kam fjalën për veten dhe kolegë  
20 të tjerë që ishin të përfshirë në redaktimin e raportit. Pjesa  
21 më e madhe kësaj pune rreth raportit bëhej natën, unë të  
22 paktën ashtu punoja.

23 Dikund nga ora 7.00 apo 8.00 e natës kur u ktheva në  
24 apartament e pashë që dikush kishte hyrë me forcë aty. Dera  
25 ishte e hapur, dhe pashë dy ushtarë të UÇK-së që ishin ulur

1 aty tek tavolina ime që po ma kontrollojin laptopin.

2 Vrapova, u ktheva tek selia e misionit. Kontaktova  
3 sigurinë. Dhe kjo është një, ky është një incident që Daan  
4 Everts ngriti me udhëheqësinë e UÇK-së e cila sigurisht që  
5 mohoi se këta ishin ushtarë të UÇK-së. Por thanë që thjesht  
6 ishin njerëz të veshur si UÇK-ja. Dhe me kaq përfundoi ky  
7 incident.

8 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Tani të vendosim në ekran  
9 dokumentin 013312 deri në 34 RED, i njëjti numër për versionin  
10 në shqip. Ku vazhdon deri në faqen 013324. Ju lutem, shikoni  
11 paragrafët 36 dhe 37.

12 PY. Në paragrafin 36 shkruhet se -- incidenti kur UÇK-ja  
13 kishin thyer me dhunë apartamentin tuaj sepse ju po qëndronit  
14 në një apartament që ishte pronë e një serbi.

15 PË. Po.

16 PY. Dhe në përgjigje ju keni vendur një shenjë të OSBE-së në  
17 derë.

18 PË. Po.

19 PY. A mund të na thoni, ju thoni që problemi u ngrit në UÇK.  
20 Çfarë ndodhi?

21 PË. Gjetja e strehimit ishte mjaft e vështirë. Siç thashë,  
22 kishte shumë apartamente dhe shumë serbë donin që t'i jepnin  
23 me qira në mënyrë që t'i ruanin apartamentet e tyre. Dhe unë  
24 isha në një prej këtyre apartamenteve.

25 Nuk ishte e pazakontë sepse UÇK-ja kishte në posedim

1 letrat apo dokumentacionin e pronës. Pastaj kishte shpërngulje  
2 me dhunë prej apartamenteve, raste të tilla. Dhe ne si staf i  
3 OSBE-së morëm udhëzime që të vendosnim shenja dalluese në  
4 dyert e apartamenteve tona dhe mendoj që të njëjtën gjë e bënë  
5 edhe stafi i organizatave të tjera ndërkombëtare.

6 Kjo çështje u ngrit edhe nga diplomati norvegjez i cili  
7 kishte diskutuar këtë me UÇK-në sepse kjo nuk më kishte  
8 ndodhur vetëm mua, por ishte një farë praktike që ish  
9 përsëritur me disa anëtarë të stafit.

10 PY. Dhe gjatë atij incidenti, kur shkutë në apartament dhe  
11 gjetët aty dy individë të UÇK-së duke parë kompjuterin tuaj,  
12 dhe ju na treguat që po përgatitnit këtë raport që do të bëhej  
13 publik më vonë. Me sa e kuptuat ju, a u ngrit ky problem edhe  
14 me z. Thaçi vetë?

15 PË. po.

16 PY. Dhe cila ish përgjigjja e tij?

17 PË. Se kjo nuk ishte UÇK-ja, por njerëz që bëheshin sikur  
18 janë UÇK.

19 PY. Po cilat ishin vëzhgimet juaja në lidhje me kontrollin e  
20 UÇK-së në atë kohë? Domethënë, periudha kur ju hynë me dhunë  
21 në apartament?

22 PË. Nga momenti kur përfunduan luftimet, UÇK-ja po fitonte  
23 gjithnjë e më shumë autoritet, sepse po e mbushnin vakumin e  
24 sigurisë edhe pse kishte prani të NATO-së aty, kishte një  
25 vakum të madh politik, nuk kish një autoritet që ishte

1 zgjedhur nga populli.

2 Dhe unë kisha përshtypjen se UÇK-ja po e mbushte këtë  
3 vakum të sigurisë dhe të gjitha atyreve që i përmenda,  
4 shërbimeve të tjera dhe këtë e bënin përmes emërimeve të  
5 drejtpërdrejta të njerëzve të tyre. Dhe kur prezantoheshe, kur  
6 takoheshe në një fshat me kryetarë të fshatit, të komunës dhe  
7 kështu me radhë, ata prezantoheshin edhe vetë se ishin emëruar  
8 nga z. Thaçi.

9 Kështu që përshtypja ime për UÇK-në për kohën që po  
10 flasim ishte se ajo po e mbushte atë vakumin që ish krijua nga  
11 tërheqja e forcave serbe dhe në mungesë të pranisë  
12 ndërkombëtare.

13 PY. Nga ajo që patë ju, nga vëzhgimet juaja, si zgjidhej një  
14 situatë e një mashtruesi?

15 PË. Ishte një gjë e vështirë për t'u pranuar sepse UÇK-ja  
16 ishte një organizatë mjaft krenare. Ata e ndienin veten se  
17 kishin kontribuar në masë të konsiderueshme për lirin e  
18 Kosovës, çlirimin e Kosovës. Se ishin forca kryesore që solli  
19 forcat e NATO-s në Kosovë, dhe se përshtypja ime ishte që po i  
20 mbushnin këto zbrazëti që ndiheshin në Kosovë në atë kohë.

21 Dhe e kisha pak të vështirë ta besoja që do ta toleronin  
22 ndonjë farë bande kriminale apo dikë tjetër të këtij lloji të  
23 veshur si ata, duke kryer krime në emër të tyre. Pa dyshim që  
24 kjo ndodhte ndonjëherë, dhe këtë them që nuk ka dyshim që ka  
25 ndodhë. Sigurisht që ka ndodhë. Mirëpo praktikën që ne i pamë

1 gjatë periudhës për të cilën është raportuar ishte mjaft e  
2 vështirë të besohet që çdo herë ish kështu.  
3 PY. Do të vazhdoj në lidhje me takimet me z. Thaçi. Pas  
4 takimit në lidhje me incidentin që përmendët, kur u takuat  
5 përsëri me z. Thaçi? Dhe pyetja ime është, çfarë diskutuat në  
6 lidhje me të drejtat e njeriut me të?

7 PË. Kur Daan Everts takohej me udhëheqësinë e UÇK-së, duke  
8 përfshirë edhe me z. Thaçi, unë isha e pranishme me të kur  
9 diskutoheshin të drejtat e njeriut. Domethënë, ai ishte mjaft  
10 sistematik në mënyrë që të gjitha temat thelbësore që kishin  
11 të bëjmë me të drejtave të njeriut të mbuloreshin siç duhet në  
12 këto takime.

13 Takimet të tjera, dhe mund të ketë pasë takime të tjera,  
14 por ajo që më kujtohet janë takimi përpara lëshimit, të bërjes  
15 publike të raportit, ku i dhamë njoftim z. Thaçi dhe e  
16 informuam atë për raportin, se do të publikohet raport dhe ia  
17 bëmë të ditura disa nga konstatimet dhe shqetësimet tona. Dhe  
18 këtu u mbuluan pothuajse të gjitha, i gjithë spektri i të  
19 drejtave të njeriut, nga vrasjet deri në qasjen në spitale,  
20 lëvizjet për liri në veri të Mitrovicës, dhe kështu me radhë.

21 PY. Dhe pas këtij raportimi të z. Thaçi, cili ishte  
22 përgjigjja e tij?

23 PË. Ai e kishte pak të dyshimtë këtë punon e pretendimeve për  
24 njerëz që po vishnin uniforma të UÇK-së, domethënë pretendimin  
25 tonë se po kryheshin krime nga njerëz të veshur me uniforma të

1 UÇK-së. Tha që do të hetoheshin më tej këto incidente.

2 Mirëpo ne nuk morëm informacion mbrapsht, se kjo më nuk  
3 ish përgjegjësi e UÇK-së, por ishte përgjegjësi e KFOR-it që  
4 ishte misioni shumëkombësh, forcat shumëkombëshe në Kosovë,  
5 apo UNMIK-u që ishte misioni në Kosovë. Dhe gjithashtu se  
6 bëhej fjalë për kriminalitet dhe kështu me radhë. Mendoj  
7 përsëri se ishte mjaft frustruese për UÇK-në sepse kjo sjellje  
8 po shikohej nga të gjitha aspektet e shkeljeve të të drejtave  
9 të njeriut.

10 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Të vendosim në ekran 076826 deri  
11 në 076840, është numri i njëjtë në versionin shqip. Na duhet  
12 konkretisht faqja 076831. Shohim paragrafin 21, veçse të  
13 sigurohemi që i gjithë paragrafi të shfaqet në ekran.

14 PY. Kur shohim këtë paragraf, shohim që flitet për takimet që  
15 keni pasur me ambasadorin Everts, pra ju, ambasadori Everts,  
16 z. Thaçi dhe dikush tjetër me emrin, ose mbiemrin, Çeku. Na  
17 thoni kush është ky person?

18 PË. Agim Çeku ka qenë komandanti i forcave të armatosura të  
19 UÇK-së.

20 PY. Këtu jep dhe një periudhë kohore në këtë takim, dikund  
21 nga mesi i paragrafit thuhet që është gushti i 1999, kur ju  
22 keni parashtruar disa problema bashkë me një person tjetër që  
23 e ka emrin Craig Jenness. Kush është Craig Jenness?

24 PË. Craig Jenness ishte një diplomat kanadez që ka qenë  
25 zëvendësi i Daan Everts.

1 PY. Në këtë takim flitet se ju e keni parashtruar këtë  
2 problematikën e të drejtave të njeriut, por jo z. Everts. Dhe  
3 thuhet që ai po shihte një kafaz zogu, thuhet këtu, teksa po  
4 diskutoheshin këto aspekte. A mund t'ia shpjegoni Trupit  
5 Gjykues si e kujtoni ju këtë takim?

6 PË. Ai sapo kishte ardhur në mision atë kohë, ose nuk kishte  
7 shumë kohë që kishte ardhur në këtë vend, kështu që unë  
8 merresha kryesisht me takime të këtij lloji.

9 PY. E kuptoj. Ju thoni që, e thoni që në fillim që ai nuk  
10 ishte komod që t'i parashtronte këto aspekte. Ende i qëndroni  
11 kësaj që keni thënë?

12 PË. Daan Everts kishte një punë gati të pamundur, sepse ishte  
13 përgjegjës për rindërtimin e forcës policore përmes akademisë  
14 policore, zgjedhjet, formimin e qeverisë, edhe plus aspektit  
15 të të drejtave të njeriut. Ishte pjesë e strukturës që po  
16 përpiqej të kthente, ta bënte sërish qeverinë funksionale dhe  
17 që shqiptarët të punonin me njëri-tjetrin.

18 Dhe UÇK-ja në këtë pikë kohore, në këtë moment kohor  
19 ishte forca dominuese në terren, dhe parashtrimi i  
20 problematikave, sjelljeve të tyre, krimeve që ishin kryer,  
21 çështjet e zhdukjes së personave, nuk ishin shumë të lehta  
22 veçanërisht kur e ke ditur, kur e di çfarë përgjigje do  
23 marrësh, që do të thonin që "nuk dimë asgjë". Ishte e vështirë  
24 pra për ambasadorin Everts kjo gjë.

25 PY. Thuhet këtu që kanë qenë pesë a gjashtë raste, ende tani

1 mendoni që nuk ka qenë një bisedë e vetme kur keni qenë atje  
2 me ambasadorin Everts dhe Hashim Thaçin dhe Agim Çekun?

3 PË. Nuk jam i sigurt a kanë qenë z. Thaçi dhe Çeku gjithmonë  
4 bashkë në këto takime, do ishte diçka e pazakontë në fakt,  
5 sepse ishin të dy, kishin funksione të larta në atë kohë, në  
6 atë moment kohor. Por po, jam takuar disa herë me ta, bashkë  
7 me ambasadorin Everts.

8 PY. Përgjigja në përgjithësi çdo rast ishte e njëjta?

9 PË. Po. Frustrim, pse ngriheshin këto problematika ndërkohë  
10 që kishte probleme shumë më të mëdha, pse të çonim kohën dëm.  
11 Këto ishin persona që shfrytëzonin UÇK-në, që ishin banda  
12 kriminale, e kështu me radhë.

13 PY. A ju kujtohet të keni mbajtur, të ketë pasur ndonjë masë  
14 vijuese nga z. Thaçi apo nga z. Çeku pasi i keni ngritur këto  
15 problematika?

16 Z. KEHOE: [Përkthim] Mbase do të ishte mirë që të lexoni  
17 atë që ka thënë Thaçi këtu që thotë:

18 "Pse do t'ua bënim këtë njerëzve tanë?"

19 Se këtë Prokurorja nuk e përmendi.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po trajtojeni  
21 kur të keni kundërpyetjet tuaja këtë pjesë.

22 Vazhdoni, Prokurore.

23 DËSHMITARJA: [Përkthim] Jo, nuk më kujtohet të na kenë  
24 dhënë informata më pas, që të kenë mbyllur një rast të këtij  
25 lloji. Vetëm retorika më kujtohet që, "Këta nuk janë personat

1 tanë, nuk janë njerëzit tanë”.

2 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

3 PY. Të flasim sërish për raportin që ju vazhdoni të  
4 përmendni. A ndodhi ndonjë moment në fund të vitit 1999 kur  
5 OMiK-u apo OSBE-ja të kenë nxjerrë një raport me konstatime  
6 dhe informacione që kishin grumbulluar gjatë kohës që kishin  
7 qëndruar në Kosovë?

8 PË. OSBE-ja më duket se në dhjetor 1999 ka nxjerrë dy  
9 raporte. I pari mbulonte periudhën kohore nga tetori 1998 deri  
10 kur u tërhoq misioni, kjo ka qenë një pjesë e raportit. Ndërsa  
11 pjesa e dytë e raportit mbulonte atë që u zbulua dhe iu  
12 raportua OSBE-së nga refugjatët. Janë këto dy periudha kohore  
13 që ishin mbuluar në vëllimin 1.

14 Kur u rikthyem në Kosovë, asnjëherë s’e kisha menduar që  
15 do përgatisnim një raport të dytë. Raporti i dytë u bë për  
16 shkak të përkeqësimit të situatës lidhur me pakicat. Që do të  
17 thotë ishin serbët, myslimanët, sllavët, goranët, edhe romët.  
18 Raporti, ky raport mbulonte periudhën qershor deri në  
19 demilitarizimin, periudhën deri në demilitarizimin e UÇK-së që  
20 ka qenë dikund nga shtatori, tetor, më duket se tetor.  
21 Mbulonte këtë periudhë kohore. Të dyja raportet janë nxjerrë  
22 njëherazi në disa vende. Prishtina ishte një prej këtyre  
23 vendeve.

24 PY. Para se të nxirreshin këto raporte, a është ky raporti që  
25 ju përmendni dhe për të cilin jeni takuar me ambasadorin

1 Everts dhe z. Thaçi për t'i treguar konstatimet e raportit,  
2 gjetjet e raportit?

3 PË. Po.

4 PY. A ishte ndonjë vëllim specifik, a ndonjë pjesë specifike  
5 e vëllimit sikurse e përshkruat?

6 PË. Po i diskutuam të dy raportet, sepse të dy raportet  
7 përfshinin, përmbanin deklarata që i ishin dhënë OSBE-së për  
8 UÇK-në, pra u parashtruan të gjitha këto aspekte. Por,  
9 shqetësimi dhe fokusi i UÇK-së ishte veçanërisht tek raporti i  
10 dytë.

11 PY. A mund t'i thoni si ka qenë emri i raportit Trupit  
12 Gjykues?

13 PË. Raporti i parë, "Sikurse është parë, sikurse është  
14 dëgjuar", vëllimi 1. Edhe i dyti është "Sikurse është parë,  
15 sikurse është rrëfyer", vëllimi 2, ose "treguar".

16 PY. Kështu e keni vëllimi 1 dhe vëllimi 2?

17 PË. Po, vëllimi 1 dhe vëllimi 2.

18 PY. A keni qenë ju e përfshirë në hartimin e këtyre dy  
19 vëllimeve?

20 PË. Po, për vëllimin e parë të raportit, të gjitha të dhënat  
21 janë dërguar në Varshavë tek zyra ku punoja unë, disa nga  
22 anëtarët e ekipit tim, anëtari i të drejtave të njeriut u  
23 dislokuan në Varshavë për të ndihmuar me hartimin e raportit.  
24 Unë bëra dhe përfundimin, përmbylljen e secilit prej krerëve,  
25 edhe redaktimin e secilit prej krerëve të raportit. Kam

1 shkruar një a dy pjesë të raportit të parë kryesisht ku  
2 tregova metodologjinë dhe mënyrën sesi ishte mbledhur  
3 informacioni.

4 Raportin e dytë, raporti i dytë është hartuar fillimisht  
5 nga pesë zyrat rajonale dhe nuk ishin të gjithë anglishtfolës.  
6 Kështu që Alison Jolly që është një ushtrues i të drejtave të  
7 njeriut, mbresëlënës, i spikatur, erdhi dhe na ndihmoi që të  
8 rishkruhej raporti, veçanërisht vëllimi i dytë. Kryesisht  
9 kishte të bënte me nivelin e anglishtes. Dhe unë bëra, kam  
10 bërë edhe rishikimin e fundit të këtij raporti. Dhe u fokusova  
11 në metodologjinë dhe mënyrën sesi u hartua apo si u përgatit  
12 ky raport.

13 PY. A mund t'i thoni Trupit Gjykues çfarë metodologjie ndoqi  
14 ky raport edhe si u hartua ky raport? Dhe na e tregoni vëllim  
15 për vëllim.

16 PË. Po. Vëllimi i parë mbulonte dy periudha kohore, një kur  
17 filluam punën në tetor të vitit 1998, deri në mars, dhe këto  
18 ishin raportet që merrnim nga oficerët e të drejtave të  
19 njeriut në Kosovë, lidhur me situatën. Fokusoheshin kryesisht  
20 me sulmet serbe, ndonëse kishte dokumentacione edhe përmendej  
21 UÇK-ja, por kryesisht për ambiente ndalimi, arrestime  
22 arbitrare dhe gjëra të kësaj natyre.

23 Në këtë raport hodhëm, pra, të gjithë informacionin që  
24 kishim grumbulluar. Ishin i mbështetur në dokumentacione  
25 konkrete që i kishim marrë nga Kosova. Ndërsa vëllimi i dytë i

1 raportit ishte bazuar në 1700, a 2700, duhet ta shoh. Por  
2 ishte mbështetur në 1700 a 2700 deklarata që na dhanë  
3 refugjatët. Raporti i parë është, përcakton shkeljet e të  
4 drejtave të njeriut flet për komunitetet që patën, të cilat u  
5 ndikuan, grupet e prekshme, pakicat, femrat, dhe pastaj bëhet  
6 një zbërthim gjeografik mbështetur në atë që na thanë  
7 refugjatët fshat për fshat. Ky është raporti i parë.

8 Metodologjia është e njëjtë në të dy. Është një standard  
9 që fokusoheshim tek standardet ndërkombëtar të të drejtave të  
10 njeriut që detyron të gjithë anëtarët e OSBE-së, e njëjta gjë  
11 ndodh edhe me dokumentet të OKB-së, të TNK-së, dokumentet  
12 evropiane. Edhe gjithashtu mbështetur në atë që parashikonin  
13 ligjet jugosllave.

14 Është Okej për të parën?

15 PY. Po, vazhdoni.

16 PË. Raporti i dytë mbështetej, pra, kur u kthym në Kosovë,  
17 dhe raportimin po e merrnim nga pesë rajonet. Unë isha më e  
18 përfshirë në këtë moment dhe jetoja në Kosovë, isha vetë në  
19 terren, isha vetë në rajon. I shihja me sytë e mi bashkë me  
20 oficerët e tjerë të të drejtave të njeriut çfarë ndodhte. Dhe  
21 ky raport është i zbërthyer gjeografikisht, mbështetur në pesë  
22 zonat ku punonte OSBE-ja edhe ku bashkëpunonte me forcat  
23 shumëkombëshe ndonëse ato kishin politikat dhe procedurat e  
24 veta dhe me OKB-në.

25 Ky raport, pra, thashë, është i përgatitur në bazë të

1 zonave gjeografike. Ka disa shtojca, një shtojcë është një  
2 zbërthim i përditshëm i raporteve që kishim marrë sepse nuk  
3 kishte autoritete në Kosovë kur ne u kthyem. OSBE-ja beson se  
4 ne ishim të vetmit, ishim organizata e vetme që dokumentonim  
5 situatën dhe donim që të sigurohemi që kjo të hidhej dikund në  
6 letër. Pastaj është një, ishte një shtojcë që fokusohet në  
7 vrasjet dhe ndalimet arbitrare që ishin te cenimi më i  
8 skajshëm i të drejtave të njeriut gjatë kësaj periudhe kohore.  
9 Si dhe kishte edhe një shtojcë për zhvarrimet të cilat i  
10 përmenda pak më herët, për zhvarrosjet.

11 E njëjta metodologji. Instrumentat ndërkombëtarë.  
12 Përgjegjësitë. Duke qenë se UÇK-ja e konsideronte veten  
13 qeveri, sillej sikur të ishte qeveri, kishte territorin në  
14 kontroll, ndonëse nuk ishin shtet anëtar *per se*, në vetvete,  
15 duhet të ndiqnin të njëjtat standarde që janë krejt normale të  
16 ndiqen në një situatë të tillë.

17 PY. Dua të sigurohemi që e kuptojmë bazën, faktet e këtij  
18 raporti, nga i merrnit këto informacione, ku i dokumentonit?

19 PË. Dokumenti i dytë?

20 PY. Jo, për të dy raportet e kam fjalën, m'i thoni njëri pas  
21 tjetrit. Secili prej vëllimeve.

22 PË. Vëllimi i parë mbështet në raportimet që bënin anëtarët  
23 e OSBE-së brenda Kosovës. I morëm me vete dokumentet kur u  
24 evakuam, aq sa mund të merrnim. Dhe po ashtu mbështet në  
25 mijëra deklaratata që u morën në kampet e refugjatëve në

1 Shqipëri dhe Maqedoni. Të gjitha këto dokumente u transferuan  
2 në Poloni dhe atje u përgatit raporti bazuar në këto dokumente  
3 dhe vetëm në këto dokumente.

4 Raporti i dytë ishte mbështetur në raportet që kishim  
5 brendapërbrenda Kosovës që i merrnim nga oficerët e të  
6 drejtave të njeriut që kishim atje si dhe bazuar në takimet ku  
7 kishin marrë pjesë me OKB-në dhe me KFOR-in.  
8 PY. Është e drejtë që të themi që baza e informacionit vinte  
9 nga vetë OSBE-ja, pra, nga punonjësit e OSBE-së që kishin  
10 grumbulluar dhe ndërsa informacioni në vëllimin 2 vinte edhe  
11 nga organizata të tjera ndërkombëtare që punonin në të njëjtën  
12 periudhë kohore.

13 PË. Po për vëllimin 2 patëm më shumë kohë. Ishim nën trysni  
14 të jashtëzakonshme dhe kuptohet dhe me të drejtë që ishim në  
15 një situatë të tillë, ne përpiqeshim të kuptonim për  
16 pretendimet e përfshira në UÇK, në raport, sidomos për UÇK-në  
17 për shkak të pozitës së tyre se nuk kishim qëndrimet që mbanin  
18 ata, që nuk jemi ne të përshirë në këtë gjëra, ne siguroheshim  
19 që të ishin të pabazuara [Sipas përkthimit].

20 Dhe po. Pretendimet të mirëbazuara ishin diku në formë  
21 trekëndore, domethënë, siç mund të ndodhë zakonisht.  
22 Megjithatë ne shkonim dhe tek KFOR-i për shembull, edhe  
23 siguroheshim që edhe KFOR-i të kishte të njëjtin raport.  
24 Pastaj shkonim tek Kryqi i Kuq Ndërkombëtar, drejtoheshim tek,  
25 shkonim tek disa burime, te kisha, te organizatat e ndryshme,

1 tek --

2 Nuk ishte thjesht që shkruanim ato që na thanë.

3 Përpiqeshim t'i verifikonim nga disa burime, pra, të gjitha  
4 informacionet që merrnim.

5 Tek vëllimi i dytë, pra, tek raporti i dytë, ne ishim në  
6 gjendje dhe të dërgonim informacion në terren dhe t'u kërkonim  
7 atyre ta verifikonin atë informacion. Pra, shtojca që përmenda  
8 unë, që ka dhe rendin kronologjik, i dërgohej terrenit që ta  
9 verifikonin gjithë informacionin, të verifikonin datat, të  
10 siguroheshin që të gjitha pretendimet ishin të bazuara mirë,  
11 aq sa mundeshin.

12 ZNJ. MAYER: [Përkthim] A mund të shohim provën materiale  
13 P00006 në lidhje me këtë që sapo --

14 PY. E kemi vetëm në anglisht këtë. Ju lutem, shih këtë që  
15 thuhet, "Memorandum brenda zyrës", që e keni dërguar ju. Dhe  
16 ia keni dërguar Ekipit të të Drejtave të Njeriut në Gjilan në  
17 mes të shtatorit 1999. A mund të na thoni çfarë është kjo?

18 PË. Po, është diçka që unë e kam dërguar. Është kronologjia e  
19 ngjarjeve pasi i kishim hartuar, përpiluar, në momentin që  
20 kishim filluar, pra, përgatitjen e raportit të dytë, në mënyrë  
21 që të verifikonim informacionin. Si dhe të merrnim informacion  
22 shtesë në pjesën e parë për këto zona specifike konkrete.

23 PY. A e shihni shkrimin e dorës fillimisht thuhet -- tetor,  
24 thuhet "versioni i parë", shkrimi juaj është?

25 PË. Jo, nuk është shkrimi im.

1 PY. Çfarë kanë dashë të thonë me "versionin e parë"?

2 PË. Po versioni i parë i seksionit për Gjilanin të këtij  
3 raporti.

4 PY. Kur thoni "raport" e keni fjalën për fjalën për raportin  
5 "Siç kemi parë dhe dëgjuar", vëllimi 2?

6 PË. Saktë.

7 PY. Pra, shembulli që na thatë ju, ju dërgonit informacion në  
8 terren që të verifikohet?

9 PË. Po.

10 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin. Dhe do  
11 kërkoja që të shfaqej dokumenti, pra dokumenti SITF00001529  
12 deri në 00001871. Do ta marrim faqe për faqe në ekran.

13 PY. Nuk është nevoja që t'i shohim të gjitha faqet këtu, por  
14 të shohim pasqyrën e lëndës. Shkojmë nga faqja e parë tek  
15 faqja e dytë. Këtu renditen të gjitha këto pjesë të raportit  
16 që ju përmendët edhe shtojcat përkatëse, me kronologjinë e  
17 shkeljes së të drejtave të njeriut dhe zhvarrimet që ju  
18 përmendët.

19 Ky është -- pasqyra e lëndës e vëllimit 2 që ju  
20 përshkruat, kështu?

21 PË. Po.

22 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Shfaqim në ekran vëllimin 1, që  
23 është i ndarë në dy pjesë. SPOE00198098 deri në SPOE00198366.  
24 Të shikojmë tani pasqyrën e lëndës, dhe për këtë të shkojmë në  
25 faqen e dytë. Kjo vazhdon dhe në faqen e tretë, po.

1 PY. Gjithmonë ta kemi të qartë që po shohim pasqyrën e  
2 lëndës. Kjo është pjesa 1 e vëllimit 1, kështu?

3 PË. Ky është vëllimi 1, po.

4 PY. Kjo është pasqyra e lëndës, e të gjithë vëllimit 1?

5 PË. Saktë.

6 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Do ju lutesha dhe ju kërktoj  
7 ndjesë, do ju lutesha të shfaqej dhe njëherë vëllimi 2,  
8 SITF00001529 deri në SITF00001871. Do të doja që të shkonim  
9 tek faqja 00001579 -- 171 [Sipas përkthimit].

10 PY. Në këtë faqe, në paragrafin nën titullin, titulli C, mund  
11 të shohim këtë paragraf. Përshkruhet:

12 "Në dallim të dukshëm të periudhës nga periudha përpara  
13 konfliktit kishte prani të fuqishme të fortë dhe të dukshme të  
14 UÇK-së në zonën e Gjilanit."

15 Besoj se dhe ju e përmendët më herët, thatë që ka një  
16 ndryshim krahasuar me periudhën e mëparshme, pra, periudhën  
17 kur u tërhoqët dhe kur u rikthyet në qershor të 1999?

18 PË. Saktë.

19 PY. Më konkretisht këtu flitet, jepet dhe një shembull i  
20 faktit që janë marrë disa ndërtesa publike, dhe flet që është  
21 marrë edhe një ish-konvikt, që njihej si Internat, një  
22 ndërtesë që thuhej se përdorej si objekt ndalimi nga ana e  
23 UÇK-së.

24 A ju kujtohet që të keni ndonjë informacion që UÇK-ja të  
25 ketë përdorur ndonjë konvikt me emrin Internat si objekt

1 ndalimi?

2 PË. Po, Alison Jolly ose Claudia Moser -- nuk ju them  
3 konkretisht datat, ose Alison Jolly, ose Claudia, kanë qenë në  
4 këtë kohën në Gjilan dhe të dyja janë profesioniste të të  
5 drejtave të njeriut, të nivelit shumë të lartë, dhe ato e kanë  
6 përmendur këtë gjë. Më kujtohet kjo.

7 PY. E keni përmendur dhe më para Alison Jolly. Por, emrin e  
8 dytë e keni përmendur për herë të parë tani. Kur ka qenë kjo  
9 person atje?

10 PË. Claudia Moser ka qenë koordinatore terreni dhe ka qenë  
11 zëvendësuese kur nuk ishte Susanne Ringgaard atje. Ka qenë  
12 pjesë e MVK-së kishte qenë edhe më përpara në Gjilan, përpara  
13 fushatës së NATO-së, përpara konfliktit, edhe pas fushatës së  
14 NATO-s. Ishte zvicerane.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.  
16 Prokurore, mbase kemi një paqartësi këtu. Dokumenti SITF që  
17 mbaron me 1871, një herë thatë është një përmbledhje, një herë  
18 thatë është pasqyrë lënde, kur i bëtë pyetje dëshmitares.  
19 Çfarë është, çfarë është, çfarë keni dashë të thoni?

20 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Asnjë nuk është në fakt. Vëllimi  
21 2, faqet e para janë pasqyra e lëndës. Por dokumenti në  
22 vetvete është vëllimi 2.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sepse na ka  
24 dalë në transkript një herë pasqyrë e lëndës, një herë na ka  
25 dalë një përmbledhje.

1 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Jo, jo. Është pasqyra e lëndës.

2 Faqet e para që unë i tregova janë pasqyra e lëndës.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe vëllimi 1  
4 është dokumenti i, është një nga dokumentet e SPOE-së? Këtë  
5 doni të thoni?

6 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Po, ju kërkoj ndjesë se e  
7 ngatërrova pak.

8 Të shohim dokumentin SITF0001581 deri në -- 1581, tek  
9 dokumenti që e kemi tashmë në ekran. Të fillojmë në fund të  
10 faqes.

11 PY. Ju lutem të shihni paragrafin e fundit ku flitet për  
12 "Integritetin fizik" te titulli dhe në mes të paragrafit  
13 thuhet:

14 "Sërisht tendenca ishte e qartë menjëherë pas 19  
15 qershorit", që besoj se është fillimi kur jeni rikthyer në  
16 Kosovë, "një mashkull serb i Kosovës u keqtrajtua gjatë  
17 ndalimit të paligjshëm nga katër a pesë anëtarë të pretenduar  
18 të UÇK-së. Viktima u lirua më 22 qershor me të prera në fytyrë  
19 dhe me dhëmbë të thyer."

20 Ka dhe një poshtëshënim aty. A mund të na tregoni çfarë  
21 nënkupton ky poshtëshënim?

22 PË. Është citimi GN/GN/, që është numri i dosjes. Në Gjilan,  
23 është zona e Gjilanit, nënkupton. Qyteti i Gjilanit. Numri i  
24 dosjes 13, viti 1999. Është dosja që u çel, çelet një dosje,  
25 edhe ka emra në të. Edhe hollësira.

1 PY. Në rregull. Dhe pastaj vazhdon, thotë:

2 "Po më 19 qershor, pesë civilë shqiptarë të Kosovës me  
3 uniforma të gjelbërta kamuflazhi me emblemat e UÇK-së ndaluan  
4 një serb të Kosovës në mes të ditës në rrugë..."

5 Dhe pastaj vazhdon në faqen tjetër, thotë:

6 "... në mesin e ditës dhe e detyruan që t'ju jepte para."

7 Edhe një herë nuk do ju kërkoj që të na lexoni çdo  
8 poshtëshënim. Por vazhdon, ka një incident tjetër:

9 "Më 28 qershor, një emblemë e UÇK-së u vendos në një  
10 shitore të një serbi të Kosovës: shitorja u plaçkit edhe  
11 pronari u keqtrajtua nga kryesit që mbanin uniforma të UÇK-  
12 së."

13 Dhe në fjalinë e fundit thuhet:

14 "Përfshirja e UÇK-së në qershor ishte shumë e dukshme:  
15 çdo raport keqtrajtimi nga 19 qershor deri më 1 korrik  
16 pretendohej, në të gjitha këto raste pretendohej se kryesit  
17 ishin të UÇK-së."

18 Pra, sa i takon kësaj periudhe kohore, dhe këtyre  
19 raporteve poshtëshënimet, të gjitha këto të dhëna i kishit  
20 bazuar në raportet që merrnit nga këto zonat dhe që na e  
21 shpjeguat përpara që përpigëshit të verifikonit burimin  
22 përpara se t'i hidhnit në këtë raport?

23 PË. Besoj se ky ka qenë, në fillimin e kësaj kohe. Besoj se  
24 Claudia Moser vinte me mua gjatë ditëve pas fushatës së NATO-  
25 s. Pastaj ajo menjëherë shkoi në Gjilan. Ajo kishte qenë atje

1 dhe përpara fushatës së NATO-s. Ishte një proces -- një  
2 procesmbajtëse shumë e zonja, shumë e mirë. Kisha shumë besim  
3 tek ajo, i përgatiste, çelte dosje, verifikonte burimet.

4 Në fillimin e, në periudhën e parë ishte shumë e vështirë  
5 të gjeje persona që të verifikonin burimin. Sigurisht që KFOR-  
6 i mund ta bënte këtë, mund ta bënte autoritetet vendore, mund  
7 ta bënte kryetari i komunës.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prokurore,  
9 duhet të mbyllni ditën për sot.

10 Dëshmitare, faleminderit për sot. Duhet të ktheheni nesër  
11 do të fillojmë në orën 9.00. Ju faleminderit për pjesëmarrjen  
12 tuaj.

13 Asistentja do ju shoqërojë jashtë sallës së gjyqit.

14 Mos harroni deklaratën solemne që morët, bëtë këtë  
15 mëngjes, dhe mos folni me asnjë për çështjen.

16 [Dëshmitarja përfundon dëshminë]

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni diçka  
18 për të thënë?

19 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Po, kisha një pyetje. Duam të  
20 dimë edhe sa mendoni Prokuroria që do të zgjasin pyetjet e  
21 veta?

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Edhe sa kohë  
23 ju nevojitet?

24 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Mbase dhe 45 minuta, pak a shumë.  
25 jemi fokusuar te dokumentet tani, te këto dokumente, por dhe

1 disa raporte të tjera.

2 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Edhe unë besoj që do jem pala e  
3 fundit që do të bëj pyetje dhe ne mendojmë që do të kemi rreth  
4 45 minuta pyetje për këtë dëshmitar.

5 Z. KEHOE: [Përkthim] Unë kam kënaqësinë që do filloj i  
6 pari.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do kemi  
8 rendin e zakonshëm.

9 Z. Roberts?

10 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk kam asnjë përditësim, kam  
11 thënë një orë e gjysmë përpara. S'kam ndonjë ndryshim, por të  
12 shohim.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Kehoe,  
14 s'ju pyeta ju sa kohë parashikoni?

15 Z. KEHOE: [Përkthim] Shumë, plot. Gjithë kohën.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,  
17 faleminderit.

18 Z. Ellis?

19 Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mendoj se ne  
20 kishim thënë një orë, dy orë. Besoj se rreth dy orë.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
22 Shihemi nesër në orën 9.00.

23 --- Seanca mbyllet në orën 16.03

24

25